



# Mbikëqyrja e auditimit në Bashkimin European dhe në Ballkanin Perëndimor

**prill 2025**

© 2025 Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore

1818 H Street NW

Uashington, D.K. 20433

Telefon: 202-473-1000

Internet: [www.worldbank.org](http://www.worldbank.org)

Ky dokument është produkt i stafit të Bankës Botërore, me kontribute të jashtme. Konstatimet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Bankës Botërore, Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të saj apo të qeverive që përfaqësojnë.

Banka Botërore nuk garanton saktësinë, plotësinë apo aktualitetin e të dhënave të përfshira në këtë punim dhe nuk merr përgjegjësi për gabime, mosparaqitje apo mospërputhje të informacioneve apo në lidhje me përdorimin apo mospërdorimin e informacioneve, metodave, proceseve apo përfundimeve të paraqitura në të. Kufijtë, ngjyrat, emërtimet dhe çdo informacion tjetër që paraqitet në hartat e këtij dokumenti nuk nënkuptojnë nga ana e Bankës Botërore asnjë gjykim për statusin juridik të asnjë territori dhe nuk përbëjnë ndonjë mbështetje apo pranim të kufijve të paraqitur.

Asgjë në këtë punim nuk mund të përbëjë apo të interpretohet apo të konsiderohet si kufizim apo heqje dorë nga privilegjet dhe imunitetet e Bankës Botërore, të cilat mbeten veçanërisht të rezervuara.

## **Të drejtat dhe lejet**

Materialet e këtij dokumenti janë objekt i të drejtës së autorit. Duke qenë se Banka Botërore nxit shpërndarjen e njohurive të saj, ky dokument mund të riprodhohet, tërësisht ose pjesërisht, për qëllime jo komerciale, për sa kohë që është përmendur plotësisht titulli i këtij dokumenti.

Çdo kërkesë për të drejta dhe leje, përfshirë të drejtat dytësore, duhet t'i drejtohet Zyrës së Botimeve të Bankës Botërore, Banka Botërore, 1818 H Street NW, Uashington, D.K. 20433, SHBA; faks: 202-522-2625; postë elektronike: [pubrights@worldbank.org](mailto:pubrights@worldbank.org).

Grafika e kopertinës: Kora Reichardt



|                                                                                                                        |           |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Shkurtime</b>                                                                                                       | <b>3</b>  |
| <b>Parathënie</b>                                                                                                      | <b>4</b>  |
| <b>Përmbledhje e dokumentit</b>                                                                                        | <b>5</b>  |
| <b>HYRJE</b>                                                                                                           | <b>8</b>  |
| <b>1. KUADRI RREGULLATOR I BE-SË PËR MBIKËQYRJEN PUBLIKE TË AUDITUESVE DHE SHOQËRIVE TË AUDITIMIT</b>                  | <b>9</b>  |
| 1.1. Zhvillimi në kohë të legjislacionit të BE-së për mbikëqyrjen publike të auditimit                                 | 9         |
| 1.2. Kërkesat e legjislacionit të BE-së për mbikëqyrjen publike                                                        | 10        |
| <i>Kapitulli VIII i Direktivës për Auditimin: parimet e mbikëqyrjes publike</i>                                        | 11        |
| <i>Kapitujt II - VII të Direktivës për Auditimin</i>                                                                   | 12        |
| <i>Aspektet kryesore të Rregullores për Auditimin</i>                                                                  | 14        |
| 1.3. Dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe mbikëqyrja e dhënies së sigurisë                           | 15        |
| <i>Raportimi i qëndrueshmërisë</i>                                                                                     | 15        |
| <i>Dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë</i>                                                              | 15        |
| <i>Mbikëqyrja e dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë</i>                                               | 16        |
| <b>2. STUDIME TË KOHËVE TË FUNDIT PËR MBIKËQYRJEN E AUDITIMIT NGA BE-JA DHE RRJEDHOJAT E TYRE PËR SMP-TË ASPIRUESE</b> | <b>18</b> |
| 2.1. Studimi i BE-së për ndikimin e reformës së auditimit në BE                                                        | 18        |
| <i>Ndikimi i përgjithshëm i reformave të vitit 2013</i>                                                                | 18        |
| <i>Auditimi i NJEIP-ve</i>                                                                                             | 19        |
| <i>Transparenca, pavarësia dhe konkurrenca</i>                                                                         | 19        |
| <i>Bashkëpunimi ndërkufitar me vendet e treta</i>                                                                      | 19        |
| 2.2. Raporti i KOEMA-s për zhvillimet në tregun e auditimit të NJEIP-ve në BE                                          | 20        |

|                                                                                                               |           |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| 2.3. Anketa e IFIAR-it për regjimet ndërkombëtare të zbatimit me forcë .....                                  | 21        |
| <i>Pikat më kryesore nga konstatimet e anketës .....</i>                                                      | <i>21</i> |
| <i>Vendet e përdorura për krahasim me vendet e REPARIS-it .....</i>                                           | <i>23</i> |
| <b>3. SISTEMET E MBIKËQYRJES PUBLIKE NË DISA SHTETE ANËTARE TË BE-SË .....</b>                                | <b>23</b> |
| 3.1. Përgjegjësia për legjislacionin .....                                                                    | 27        |
| 3.2. Vendndodhja e sistemeve të mbikëqyrjes publike .....                                                     | 28        |
| 3.3. Drejtimi i brendshëm i OMA-s .....                                                                       | 28        |
| 3.4. Burimet dhe financimi .....                                                                              | 29        |
| 3.5. Delegimi i detyrave .....                                                                                | 30        |
| <b>4. SISTEMET E MBIKËQYRJES PUBLIKE NË VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR .....</b>                               | <b>31</b> |
| 4.1. Ecuria e ngritjes së sistemeve të mbikëqyrjes publike .....                                              | 31        |
| <b>5. SFIDA TË PËRBASHKËTA DHE ZGJIDHJE TË SUGJERUARA NË VËNIEN NË ZBATIM TË SMP-VE NË BE .....</b>           | <b>35</b> |
| 5.1. Emërimi i anëtarëve të bordit .....                                                                      | 35        |
| 5.2. Emërimi (dhe mbajtja) e personelit .....                                                                 | 36        |
| 5.3. Nivelet e pagave për punonjësit më të mirë .....                                                         | 36        |
| 5.4. Inspektimet e vlerësimit .....                                                                           | 37        |
| 5.5. Konstatimet nga inspektimet e para .....                                                                 | 37        |
| 5.6. Proces ligjor i ngarkuar .....                                                                           | 38        |
| <b>6. MATERIALET MBËSHTETËSE .....</b>                                                                        | <b>39</b> |
| <b>Shtojca 1. Përmbledhje e pjesëve përkatëse të Direktivës dhe të Rregullores për Auditimin Ligjor .....</b> | <b>41</b> |
| <b>Shtojca 2. Sistemet e mbikëqyrjes publike në disa Shtete Anëtare të BE-së .....</b>                        | <b>44</b> |
| <b>Shtojca 3. Profilet e sistemeve të mbikëqyrjes publike në vendet e Ballkanit Perëndimor .....</b>          | <b>55</b> |



|                |                                                                                                           |
|----------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>AAAPVIM</b> | Autoriteti Lituanëz i Auditimit, Kontabilitetit, Vlerësimit të Pasurive dhe Administrimit të Falimentimit |
| <b>AAMA</b>    | Autoriteti i Mbikëqyrjes së Auditimit, Austri                                                             |
| <b>AJN</b>     | Bordi Mbikëqyrës i Auditimit, Estoni                                                                      |
| <b>AMF</b>     | Enti Rregullator i Tregut të Letrave me Vlerë, Francë                                                     |
| <b>AOAS</b>    | Organi Gjerman i Mbikëqyrjes së Auditimit                                                                 |
| <b>APOA</b>    | Agjencia për Mbikëqyrjen Publike të Auditimit, Slloveni                                                   |
| <b>APOB</b>    | Organi i Mbikëqyrjes Publike të Auditimit, Ukrainë                                                        |
| <b>AVP</b>     | Arsimi i vazhduar profesional                                                                             |
| <b>CAOAC</b>   | Këshilli i Maqedonisë së Veriut për Avancimin dhe Mbikëqyrjen e Auditimit                                 |
| <b>CFRR</b>    | Qendra e Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar dhe të Qëndrueshmërisë                       |
| <b>DRQSHT</b>  | Direktiva për raportimin e qëndrueshmërisë të shoqërive tregtare                                          |
| <b>ELTE</b>    | Bordi i Mbikëqyrjes së Standardeve të Kontabilitetit dhe Auditimit, Greqi                                 |
| <b>H2A</b>     | Organi i Mbikëqyrjes së Auditimit, Francë                                                                 |
| <b>IAASA</b>   | Autoriteti Mbikëqyrës i Auditimit & Kontabilitetit, Irlandë                                               |
| <b>IFIAR</b>   | Forumi Ndërkombëtar i Rregullatorëve të Pavarur të Auditimit                                              |
| <b>IOSCO</b>   | Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë                                                |
| <b>KC</b>      | Kontrolli i cilësisë                                                                                      |
| <b>KE</b>      | Komisioni Europian                                                                                        |
| <b>KKRF</b>    | Këshilli për Raportimin Financiar, Kosovë                                                                 |
| <b>KOEMA</b>   | Komiteti i Organeve Europiane të Mbikëqyrjes së Auditimit, BE                                             |
| <b>MM</b>      | Memorandum mirëkuptimi                                                                                    |
| <b>NJEIP</b>   | Njësi ekonomike me interes publik                                                                         |
| <b>OMA</b>     | Bordi i Mbikëqyrjes së Auditimit                                                                          |
| <b>PANA</b>    | Agjencia për Mbikëqyrjen e Auditimit, Poloni                                                              |
| <b>PUHE</b>    | Pika Unike Hyrjeje Europiane                                                                              |
| <b>SERQ</b>    | Standardet Europiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë                                                     |
| <b>SMP</b>     | Sistemi i mbikëqyrjes publike                                                                             |
| <b>SNA</b>     | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit                                                                     |
| <b>ZHVP</b>    | Zhvillimi i vazhduar profesional                                                                          |



**Një mbikëqyrje efektive e auditimit ndihmon në rritjen e cilësisë së informacioneve financiare, çka është thelbësore për një qeverisje të mirë dhe për rritjen ekonomike.**

Ky dokument synon të ndihmojë vendet candidate dhe vendet candidate të mundshme për anëtarësim në Bashkimin Europian (BE), sidomos vendet e Ballkanit Perëndimor, për të ngritur mbikëqyrje efektive të auditimit të shoqërive tregtare. Materiali është përgatitur në kuadër të programit “Ruga drejt Europës: Programi i Reformës së Kontabilitetit dhe Fuqizimit Institucional për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme” (REPARIS për NVM-të), një program rajonal i cili mbështet gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe i cili zbatohet nga Qendra e Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar dhe të Qëndrueshmërisë (CFRR).

Materiali është shkruar nga konsulentët Jon Hooper dhe Sumita Shah (ICAEW), udhëhequr nga Andrei Busuioc dhe Iwona Warzecha, Specialistë të Lartë të Menaxhimit Financiar, Banka Botërore, nën udhëheqjen e Fabian Seiderer, Menaxher i Praktikës, Departamenti Global i Institucioneve, Banka Botërore. Susan Schroeder ka dhënë ndihmë me redaktimin ndërsa faqosja e këtij produkti është bërë nga Kora Reichardt (konsulentë e Bankës Botërore).

## Informacion për CFRR-në

CFRR, me qendër në Vjenë, Austri, mbështet vendet e rajonit të Europës dhe Azisë Qendrore për të fuqizuar raportimin dhe auditimin financiar dhe të qëndrueshmërisë në sektorin privat dhe publik. Si pjesë e Departamentit Global të Institucioneve të Bankës Botërore, CFRR ndihmon vendet pjesëmarrëse të ngrenë praktika të forta kontabiliteti, raportimi dhe auditimi të cilat sjellin rritje të qëndrueshme dhe barazivënese të udhëhequr nga sektori privat, fuqizim të drejtimit të brendshëm dhe të llogaridhënies.

CFRR ofron shërbime të shpërndarjes së dijeve, përfshirë shërbime analitike dhe këshillimore; mësim dhe zhvillim të aftësive; transferim të aftësive dhe njohurie; dhe asistencë teknike dhe forcim institucional. Veprimtaritë përqendrohen në katër fusha të njohurive: i) ndërgjegjësim për rëndësinë e programit të reformës së raportimit financiar dhe të qëndrueshmërisë dhe dhënie kontributi në reformën legislative; ii) ngritje e kapaciteteve institucionale në përgjigje të boshllëqeve në njohuri, duke ofruar këshilla të përshtatura në fusha të tilla si mbikëqyrja publike dhe standardet; iii) nxitje e organizatave të forta dhe të angazhuara të profesionit kontabël; dhe iv) nxitje e zhvillimit të arsimit kontabël në përputhje me praktikatat ndërkombëtare. Në instrumentet që CFRR përdor për të informuar dhe mbështetur reformat e vendeve përfituese përfshihen raportet për respektimin e standardeve dhe kodeve për kontabilitetin dhe auditimin. Këto raporte japin një analizë të hollësishme se deri ku sistemet kombëtare të kontabilitetit, raportimit dhe auditimit përputhen me praktikatat e mira ndërkombëtare, krahas analizës së kapacitetit të institucioneve për të vënë në jetë dhe siguruar zbatimin e sistemeve të tilla. Raportet japin rekomandime të cilat qeveritë në nivel qendror mund t'i përdorin në ndihmë të zhvillimit dhe vlerësimit të reformës legislative dhe të cilat orientojnë edhe angazhimin e CFRR-së.

CFRR administron edhe një sërë programesh në nivel rajoni dhe në nivel vendi, të përqendruara në përmirësimin e raportimit financiar dhe të qëndrueshmërisë, përfshirë programin REPARIS për NJVM-të. I financuar nga BE-ja në kuadër të Instrumentit për Zhvillimin dhe Novacionin e Ndërmarrjeve në Ballkanin Perëndimor, ky program synon të mbështesë: i) rritjen e mëtejshme të mundësisë së NMV-ve të Ballkanit Perëndimor për të marrë shërbime profesionale të kontabilitetit dhe menaxhimit financiar dhe ii) harmonizimin e kornizave të raportimit financiar për sektorin privat në Ballkanin Perëndimor me direktivat dhe rregulloret përkatëse të BE-së.



## Përmbledhje e dokumentit

Sigurimi i informacioneve financiare cilësore nga njësitë ekonomike private dhe shtetërore, mbështetur me një auditim efektiv, përbën bazën e zhvillimit ekonomik të sektorit privat, lehtëson investimet e drejtpërdrejta të brendshme dhe të huaja, mundëson drejtimin e brendshëm dhe transparencën e duhur të shoqërive tregtare dhe rrit bazën fiskale për qeveritë. Reforma, zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve të raportimit financiar, kontabilitetit dhe auditimit të sektorit privat dhe shtetëror ndihmon dhe mbështet stabilitetin financiar dhe rritjen ekonomike.

Ky dokument synon të ndihmojë vendet kandidate dhe vendet kandidate të mundshme për anëtarësim në Bashkimin Europian (BE), sidomos vendet e Ballkanit Perëndimor, për të ngritur mbikëqyrje efektive të auditimit të shoqërive tregtare. Ai:

- ✦ jep një përmbledhje të legjislacionit përkatës të BE-së,
- ✦ sheh ndikimin e reformave të fundit të BE-së,
- ✦ evidenton zhvillimet e fundit në lidhje me mbikëqyrjen e auditimit,
- ✦ përshkruan karakteristikat e sistemeve të mbikëqyrjes publike (SMP) të BE-së në vende të vogla, të mesme dhe të mëdha,
- ✦ përshkruan ecurinë e ngritjes së mbikëqyrjes së auditimit në vendet e Ballkanit Perëndimor,
- ✦ evidenton zgjidhjet për sfidat e zakonshme me të cilat përballen organet e mbikëqyrjes së auditimit (OMA) dhe
- ✦ identifikon rrjedhojat e këtyre për shtetet që aspirojnë të anëtarësohen në BE lidhur me ngritjen e SMP-së si pjesë të procesit të harmonizimit.

## Kuadri rregullator i BE-së për mbikëqyrjen publike të auditimit

Shumë vende në mbarë botën kanë miratuar reforma për përmirësimin e mbikëqyrjes së auditimit. BE-ja kërkon mbikëqyrje publike (të pavarur) të ofrimit të shërbimeve të auditimit të sektorit privat në të gjitha Shtetet Anëtare. Vendet që aspirojnë të anëtarësohen në BE duhet t'i zbatojnë këto reforma dhe kërkesa në territorin e tyre, në kuadër të përgatitjes për anëtarësim në BE.

Direktiva e BE-së 2006/43/KE së për Auditimin Ligjor (Direktiva për Auditimin) përcakton kërkesat për mbikëqyrjen publike të auditimit ligjor dhe audituesve në Shtetet Anëtare. Direktiva pësoi ndryshime të konsiderueshme në vitin 2014 me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe pavarësisë së auditimit. Në vitin 2014, janë shtuar kërkesa të mëtejshme për mbikëqyrjen publike të auditimit ligjor me Rregulloren e BE-së 537/2014 për Auditimin Ligjor (Rregullorja për Auditimin). Rregullorja përcakton detyrime specifike në lidhje me auditimin ligjor të njësive ekonomike me interes publik (NJEIP).

Direktiva dhe Rregullorja për Auditimin janë ndryshuar në vitin 2022 me Direktivën për raportimin e qëndrueshmërisë të shoqërive tregtare (DRQSHT) 2022/2464 (BE). Kjo direktivë parashikon kompetenca mbikëqyrjeje dhe kontrolli të audituesve dhe shoqërive të auditimit kur këta japin siguri për raportimin e qëndrueshmërisë.



## Mësimet e nxjerra nga vënia në zbatim e mbikëqyrjes publike të auditimit në BE

Një numër studimesh të kohëve të fundit ofrojnë analiza të vënies në zbatim të mbikëqyrjes publike në BE. Sa më poshtë jepet ajo që mund të mësojnë nga këto studime dhe përvojë vendet të cilat aspirojnë të ngrenë sisteme mbikëqyrjeje të auditimit, të ngjashme me ato të BE-së:

### Duket se ia vlen...

- ✦ Ngritja e mbikëqyrjes së auditimit duket se ka rritur pavarësinë e audituesve (dhe me gjasë, edhe cilësinë e auditimit). Përqendrimi i tregut në BE ka rënë pak, por mbetet i lartë, çka ngjan me tregjet e auditimit në mbarë botën.

### ... por është e vështirë...

- ✦ Shtetet të cilat aspirojnë nuk janë të vetmet që përballen me vështirësi në ngritjen e sistemeve të mbikëqyrjes së auditimit. Shtetet Anëtare të BE-së e kanë konsideruar të vështirë vënien në zbatim të kërkesave të auditimit të BE-së dhe ka "pabarazi" mes Shteteve Anëtare sa i takon mënyrës se si zbatohet dhe kontrollohet legjislacioni.
- ✦ Rreziqet e sistemit në të gjitha auditimet duket se janë të rralla, por në të gjitha shtetet anëtare të BE-së shihen shumë mangësi në cilësinë e auditimit.
- ✦ Shtetet Anëtare të BE-së janë ende në proces të vënies në zbatim të kërkesave shpesh të përfshira në DRQSHT për mbikëqyrjen e dhënësve të sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, proces ky që ka dalë i vështirë. Megjithatë vendet të cilat aspirojnë të ngrenë mbikëqyrje të auditimit të ngjashme me BE-në duhet të shohin si janë vënë në zbatim këto kërkesave të reja, kjo nevojë nuk është ende urgjente.

### ... dhe bashkëpunimi ndërkombëtar ndihmon.

- ✦ Diskutimi dhe bashkërendimi me organet mbikëqyrëse të auditimit (OMA) të BE-së ndihmon në përballimin e vështirësisë në inspektim dhe hetim të rrjeteve ndërkombëtare të auditimit.
- ✦ Bashkëpunimi ndërkombëtar ndihmon në lidhje me auditimet e NJEIP-ve shumëkombëshe dhe

rrjeteve globale të auditimit që ofrojnë shërbime ndërkufitare auditimi.

- ✦ Megjithatë mund të jetë i kufizuar për shkak të konfidencialitetit dhe kufizimeve ligjore, shkëmbimi i informacioneve mundësohet përmes lidhjes së aktmarrëveshjeve të veçanta ose shumëpalëshe për mbarë BE-në me OBA-të e tjera. Shembuj aktmarrëveshjesh të tilla gjenden në organizata ndërkombëtare si Forumi Ndërkombëtar i Rregullatorëve të Pavarur të Auditimit (IFIAR) dhe Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO).

## Vënia në zbatim e kërkesave të BE-së për mbikëqyrjen e auditimit

Mësimi i qartë që mund të marrin organet e mbikëqyrjes së auditimit të cilat aspirojnë të ngrenë mbikëqyrje të auditimit të ngjashme me të BE-së është se nuk ka një recetë të njëjtë për të gjithë. Direktiva për Auditimin vihen në zbatim nga Shtetet Anëtare të BE-së nëpërmjet legjislacionit të brendshëm, që do të thotë se janë ndjekur një sërë qasjesh. Edhe kërkesat e Rregullores për Auditimin, të cilat zbatohen drejtpërdrejt, lejojnë modele të ndryshme zbatimi.

Vendet aspiruese, siç janë vendet e Ballkanit Perëndimor, duhet të shohin larminë dhe karakteristikat e modeleve të BE-së të mbikëqyrjes së auditimit si shembuj të praktikave të mira, por në fund të fundit sistemi më i mirë për t'u vënë në zbatim varet nga kushtet e veçanta të vendit. Për shembull, disa vende mund ta kenë relativisht të lehtë të marrin fonde nga buxheti i shtetit dhe ta vendosin funksionin e mbikëqyrjes brenda një ministrie. Në kushte të tjera, mund të jetë më i përshtatshëm një organ i pavarur, i financuar me tarifa të audituesve.

## Statusi i vënies në zbatim, në vendet e Ballkanit Perëndimor

Secili prej vendeve të Ballkanit Perëndimor ka filluar procesin e ngritjes së një SMP-je në përputhje me kuadrin legjislativ të BE-së. Dy vende, Shqipëria



dhe Serbia, kanë punuar thellësisht me Bankën Botërore dhe kanë ecur dukshëm më përpara sa i takon vënies në zbatim të mbikëqyrjes së auditimit dhe inspektimeve të kontrollit të cilësisë, në raport me vende homologe. Vende të tjera, si Mali i Zi dhe territori i Republikës Serbe, kanë filluar një program inspektimesh të shoqërive të auditimit. Disa vende janë në proces të përgatitjes për inspektime të tilla. Në vështirësitë të cilat janë duke marrë zgjidhje aktualisht në vendet e Ballkanit Perëndimor përfshihen: ngritja e një autoriteti kompetent unik në nivel vendi në Bosnjë-Hercegovinë, siç e kërkon legjislacioni i BE-së; dhënia mundësi OMA-së në Maqedoninë e Veriut për të kryer inspektime të kontrollit të cilësisë (KC) drejtpërdrejt, përfshirë auditimet e njësive ekonomike me interes publik (NJEIP); dhe ngritja e strukturës dhe financimit të duhur institucional për OMA-së në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut, për të përmbushur në mënyrë efektive funksionin e inspektimit të kontrollit të cilësisë.

## Vështirësitë e përbashkëta dhe zgjidhjet e mundshme


Disa vështirësi të përbashkëta me të cilat përballen OMA-t në fazat e para dhe zgjidhjet e mundshme përfshijnë:

- ✦ Vështirësitë në vendosjen e drejtpeshimit mes pavarësisë dhe aftësisë profesionale për anëtarët e bordit dhe personelit mund të marrin zgjidhje nëpërmjet emërimit të një ndërthurjeje audituesish me përvojë, jo ushtrues të profesionit, pas një “periudhe pushimi” të përshtatshme, së bashku me profesionistë të aftë nga fusha të tjera dhe nëpërmjet shmangies së çdo konflikti të mundshëm interesi.
- ✦ Vështirësitë për shpërblimin adekuat të inspektorëve që mund të kenë pasur paga të larta në ushtrimin e auditimit mund të marrin zgjidhje, për shembull, nëpërmjet një pakete tërheqëse ku paga është vetëm njëri komponent, me numër më të madh ditësh leje vjetore, orar jo fiks pune dhe një qasje të arsyeshme ndaj orarit të punës.

- ✦ Vështirësitë në konstatimin e cilësisë së përgjithshme të auditimit brenda një shoqërie auditimi duke u vënë shoqërive të auditimit një vlerësim të përgjithshëm unik pas inspektimeve mund të marrin zgjidhje nëpërmjet ndjekjes së një qasjeje fleksibël për vlerësimet dhe duke u lejuar inspektorëve me përvojë të gjykojnë cilësinë bazuar në përvojë e të mos numërojnë shkeljet.
- ✦ Vështirësitë e lidhura me shumë probleme të cilësisë së auditimit të cilat identifikohen nga inspektimet e herës së parë mund të marrin zgjidhje duke i mbështetur audituesit që konsiderohen se mund të përmirësohen me anë të formimit, me qëllim rritjen e cilësisë së auditimit, në vend të ndëshkimit të audituesve me gjoba a vërejtje.
- ✦ Vështirësitë e proceseve me barrë të rëndë ligjore mund të marrin zgjidhje nëpërmjet përmirësimit të komunikimit mes audituesve dhe inspektorëve për të sqaruar se cilat përmirësime janë të nevojshme dhe brenda cilit afat.

## Përfundime

Ja vlen të vihet në zbatim mbikëqyrja e auditimit: kjo sjell rritje të cilësisë dhe pavarësisë së auditimit, çka rrit cilësinë e informacioneve financiare, gjë që është thelbësore për qeverisjen e mirë dhe rritjen ekonomike. Vendet të cilat aspirojnë të vënë në zbatim mbikëqyrjen e auditimit sipas mënyrës së BE-së mund të nxjerrin mësim nga përvojat e Shteteve Anëtare të BE-së sa i takon krijimit dhe funksionimit të sistemeve të tyre dhe të kërkojnë të bashkëpunojnë me organet mbikëqyrëse të auditimit të BE-së në dobi të të gjithëve. Megjithatë, larmia e modeleve që shihen në Shtetet Anëtare të BE-së tregon se, tekefundit, sistemi më i mirë i mbikëqyrjes së auditimit varet nga karakteristikat e vendit.




## Hyrje

Vënia në dispozicion e informacioneve financiare cilësore nga njësitë ekonomike kontribuon në stabilitetin financiar dhe në rritjen ekonomike. Kjo përbën bazën e zhvillimit ekonomik të sektorit privat, lehtëson investimet e drejtpërdrejta të brendshme dhe të huaja, mundëson drejtimin e brendshëm dhe transparencën e duhur të shoqërive tregtare dhe rrit bazën fiskale për qeveritë. Auditimi siguron që informacionet e deklaruarat financiare të jenë të drejta dhe të sakta. Auditimet rritin besimin, identifikojnë problemet e mundshme dhe përmirësojnë llogaridhënien në raportimin financiar të shoqërive tregtare.

Në përgjigje të një vargu skandalesh në fushën e raportimit financiar dhe auditimit, vende nga mbarë bota kanë miratuar reforma që kërkojnë mbikëqyrje të pavarur të auditimit.<sup>1</sup> Si pjesë e reformave më të gjera të auditimit në vitin 2014, BE-ja fuqizoi kërkesat për rregullim dhe mbikëqyrje të pavarur të auditimit dhe të audituesve të shoqërive tregtare. U rrit mbikëqyrja (e pavarur) publike e ofrimit të shërbimeve të auditimit në sektorin privat dhe u futën kërkesa më të rrepta. Vendet që aspirojnë të anëtarësohen në BE duhet t'i zbatojnë këto reforma dhe kërkesa në territorin e tyre, në kuadër të përgatitjes për anëtarësim.

<sup>1</sup> Për informacione shtesë për qëllimin dhe karakteristikat e sistemeve të mbikëqyrjes publike shih: Banka Botërore. 2017. Public Oversight Systems for Statutory Audit in the EU (Sistemet e mbikëqyrjes publike të auditimit ligjor në BE). <https://documents1.worldbank.org/curated/ar/566531534767662438/pdf/Public-Oversight-Systems-for-Statutory-Audit-in-the-EU.pdf>



# Kuadri rregullator i BE-së për mbikëqyrjen publike të audituesve dhe shoqërive të auditimit


## 1.1. Zhvillimi në kohë i legjislacionit të BE-së për mbikëqyrjen publike të auditimit

Direktiva e BE-së 2006/43/KE<sup>2</sup> së për auditimin ligjor (Direktiva për Auditimin) përcakton kërkesat për mbikëqyrjen publike të auditimit ligjor dhe audituesve në Shtetet Anëtare. Në Direktivën për Auditimin janë bërë ndryshime të ndjeshme në vitin 2014 me

Direktivën e BE-së 2014/56<sup>3</sup> me të cilën zbatoheshin reforma që synonin përmirësimin e cilësisë dhe pavarësisë së auditimit.

Në vitin 2014, janë shtuar kërkesa të mëtejshme për mbikëqyrjen publike të auditimit ligjor me Rregulloren e BE-së 537/2014<sup>4</sup> për Auditimin Ligjor (Rregullorja për Auditimin). Rregullorja për Auditimin përcakton detyrime specifike në lidhje me auditimin ligjor të njësive ekonomike me interes publik (NJEIP).

**Figura 1.** Zhvillimi në kohë i legjislacionit të BE-së për mbikëqyrjen publike të auditimit



<sup>2</sup> Shih <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2006/43/oj/eng>

<sup>3</sup> Shih <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2014/56/oj/eng>

<sup>4</sup> Shih <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32014R0537&qid=1723568140116>

Direktiva dhe Rregullorja për Auditimin janë ndryshuar në vitin 2022 me Direktivën për raportimin e qëndrueshmërisë të shoqërive tregtare (DRQSHT) 2022/2464 (BE).<sup>5</sup> Me këtë shtoheshin detyra për OMA-të në fushën e dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë. Direktiva për Auditimin është ndryshuar më pas me Direktivën 2023/2864 (BE) për pikën unike europiane të hyrjes (PUEH).<sup>6</sup> Direktiva për PUEH-në nuk ndikoi në mbikëqyrjen publike të auditimit ose dhënies së sigurisë.


Teksti i konsoliduar i Direktivës së ndryshuar për Auditimin<sup>7</sup> gjendet në faqen EU-Lex, si edhe Rregullorja e ndryshuar për Auditimin. Pas DRQSHT-

së.<sup>8</sup> instrumentet legislative mund të përshkruhen më mirë si Direktiva dhe Rregullorja “Për auditimin ligjor dhe dhënien e sigurisë”.

## 1.2. Kërkesat e legjislacionit të BE-së për mbikëqyrjen publike

Direktiva për Auditimin përmban kërkesat bazë për mbikëqyrjen publike të auditimit dhe audituesve. Rregullorja për Auditimin shton hollësi të tjera në kërkesat për mbikëqyrje publike, konkretisht në lidhje me audituesit e NJEIP-ve.

**Figura 2.** Elementet e mbikëqyrjes së auditimit në Direktivën për Auditimin



<sup>5</sup> Shih <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32022L2464>

<sup>6</sup> Shih <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32023L2864>

<sup>7</sup> Shih <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A02006L0043-20240109>

<sup>8</sup> Shih <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A02014R0537-20240109>

## Kapitulli VIII i Direktivës për Auditimin: parimet e mbikëqyrjes publike

Parimet e mbikëqyrjes së auditimit, të parashikuara në Kapitullin VIII të Direktivës për Auditimin, kërkojnë që OMA-ja e caktuar nga Shteti Anëtar:



të ketë kontroll mbikëqyrës mbi të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit



të drejtohet nga persona të cilët nuk e ushtrojnë profesionin e të cilët kanë njohuri në fushat e lidhura me auditimin ligjor dhe, sipas rastit, dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë. Këta duhet të zgjidhen me procedurë të pavarur dhe transparente emërimi<sup>9</sup>



të ketë përgjegjësinë e fundme për mbikëqyrjen e miratimit, arsimit të vazhdueshëm, regjistrimit, kontrollit të cilësisë dhe hetimit të audituesve dhe për miratimin e standardeve



të organizohet në atë mënyrë që shmang konfliktin e interesit



të ketë mundësinë të çelë dhe zhvillojë hetime ndaj audituesve dhe shoqërive të auditimit dhe të marrë masat e duhura



të ketë kompetencat e nevojshme për të ushtruar kontrollin mbikëqyrës



të jetë transparent



të ketë fonde të mjaftueshme, me financim të sigurt dhe të çliruar nga çdo ndikim të parregullt nga ana e audituesve ligjorë ose shoqërive të auditimit

### Fushat që janë objekt i kontrollit mbikëqyrës:

OMA-s i kërkohet të mbikëqyrë një listë fushash dhe funksionesh të përcaktuara. Ndërkohë që kërkohet vetëm mbikëqyrja e funksioneve, nënkuptohet që

OMA-ja të kryejë detyrat e realizimit të funksioneve, përpos kur këto detyra delegohen.

Këto fusha janë:

- aprovimi dhe regjistrimi i audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit;
- miratimi i standardeve të etikës profesionale, kontrollit të brendshëm të cilësisë së shoqërive të auditimit dhe auditimit, me përjashtim të rasteve kur këto standarde miratohen nga autoritete të tjera të Shtetit Anëtar;
- arsimi i vazhdueshëm profesional (AVP);
- sistemet e sigurimit të cilësisë;
- sistemet disiplinore hetimore dhe administrative.

**Delegimi:** Direktiva për Auditimin thotë, kur flet për parimet, se Shtetet Anëtare mund të delegojnë ose t'ia lejojnë OMA-së të delegojë çdo detyrë të tij te autoritete ose organe të tjera të cilat duhet të organizohen në atë mënyrë që të shmangët konflikti i interesit. Neni 24 i Rregullores për Auditimin thotë<sup>10</sup> se **nuk mund të delegohet kontrolli i cilësisë, hetimet dhe ndëshkimi i audituesve të NJEIP-ve** (përpos delegimit të ndëshkimit te një organ ku shumica e personave të përfshirë në drejtimin e organit në fjalë ku bëhet delegimi janë të pavarur nga profesioni i auditimit).

**Mbikëqyrja e audituesve dhe shoqërive të auditimit të cilat bëjnë dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë:** Shtesat dhe ndryshime në DRQSHT kërkojnë që mbikëqyrja publike e audituesve ligjorë dhe e shoqërive të auditimit të bëhet jo vetëm kur ata kryejnë shërbime të auditimit ligjor, por edhe kur kryejnë shërbime të dhënies së sigurisë për qëndrueshmërinë.

**Bashkëpunimi midis SMP-ve në nivel të BE-së:** Shteteve Anëtare u kërkohet të sigurojnë që organizimi rregullator për SMP-në të përfshijë bashkëpunim efektiv në nivel të BE-së në lidhje me veprimtaritë mbikëqyrëse, në mënyrë që vetëm një OMA të ketë përgjegjësinë e përgjithshme për sigurimin e këtij bashkëpunimi. Neni 30 i Rregullores për Auditimin kërkon që të gjithë OMA-t e BE-së të jenë anëtarë të Komitetit të Organeve Europiane të Mbikëqyrjes së Auditimit (KOEMA).

<sup>9</sup> Rregullorja për Auditimin vendos kërkesa më të hollësishme dhe më të rrepta lidhur me pavarësinë e anëtarëve të organeve drejtuese të OMA-ve për mbikëqyrjen e audituesve të NJEIP-ve.

<sup>10</sup> Rregullorja: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A02014R0537-20240109>

KOEMA përbëhet nga përfaqësues të organeve kombëtare të mbikëqyrjes së auditimit në BE dhe të Autoritetit European të Letrave me Vlerë dhe Tregjeve.<sup>11</sup> KOEMA kryesohet nga një përfaqësues i njërit prej OMA-ve, ndërsa Komisioni European (KE)<sup>12</sup> ka zëvendëskryetarin.

Autoriteti Bankar European,<sup>13</sup> Autoriteti European për Sigurimet dhe Pensionet nga Marrëdhëniet e Punës,<sup>14</sup> përfaqësues të autoriteteve kombëtare të auditimit të Zonës Ekonomike Europiane nga Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia dhe Organi i Mbikëqyrjes Publike të Auditimit të Ukrainës<sup>15</sup> (APOB) marrin pjesë si vëzhgues.

Nëngrupet dhe task-forcat e KOEMA-s paraqiten në **Figurën 3** më poshtë.

## Kapitujt II - VII të Direktivës për Auditimin


Kapitulli VIII i Direktivës për Auditimin lidhet konkretisht me mbikëqyrjen publike, por kapitujt të tjerë përfshijnë hollësi mbi funksionet e miratimit, regjistrimit, arsimit të vazhdueshëm profesional, sistemit të sigurimit të pavarur të cilësisë dhe hetimit dhe disiplinës të audituesve. Kërkesat për rregullimin e auditimit në secilin prej këtyre kapitujve janë me rëndësi për OMA-të, pasi këto duhet t'i zbatojnë

drejtpërdrejt (p.sh., kontrolli i cilësisë së audituesve të NJEIP-ve) ose të mbikëqyrin në mënyrë aktive organizatën së cilës ia kanë deleguar funksionet (p.sh., shpesh kualifikimi i audituesve është funksion i deleguar).

## Kapitulli II – Miratimi i audituesve

OMA-t duhet të bëjnë ose të mbikëqyrin miratimin e audituesve. Kriteret për miratimin jepen në Kapitullin II dhe përfshijnë **drejtimin e brendshëm** (shoqëritë e auditimit duhet të kontrollohen nga një shumicë audituesish); reputacionin e mirë (personat ose shoqëritë duhet të kenë reputacion të mirë); **kualifikimet arsimore** (që të miratohen, audituesit duhet të kenë nivelin arsimor të përcaktuar në Direktivë; në këto kriteret përfshihen kriteret e pranimit, një listë të lëndëve që duhen trajtuar dhe faktin që dijet teorike të testohen deri në nivelin e diplomës universitare); **provimin e aftësisë profesionale** (që të miratohen, audituesit duhet të marrin provimin e aftësisë profesionale); **formimin praktik** (kriteri që kërkon tre vjet formim praktik, nga të cilët dy të tretat të jenë pranë një audituesi të kualifikuar); **njohjen e ndërsjelltë** (Shtetet Anëtare duhet të njohin audituesit e miratuar në Shtetet Anëtare të tjera, në varësi të provimeve për legjislacionin dhe tatim-taksat e vendit); **arsimin e vazhdueshëm profesional** (audituesit duhet të ruajnë nivelin e dijeve teorike, aftësitë profesionale

**Figura 3.** Nëngrupet dhe task-forcat e KOEMA-s



<sup>11</sup> Shih <https://www.esma.europa.eu/>

<sup>12</sup> Drejtoria e Përgjithshme për Stabilitetin Financiar, Shërbimet Financiare dhe Bashkimin e Tregjeve të Kapitalit

<sup>13</sup> Shih <https://www.eba.europa.eu/homepage>

<sup>14</sup> Shih [https://www.eiopa.europa.eu/index\\_en](https://www.eiopa.europa.eu/index_en)

<sup>15</sup> Shih [https://www.apob.org.ua/?page\\_id=17&lang=en](https://www.apob.org.ua/?page_id=17&lang=en)



dhe vlerat në një nivel mjaftueshëm të lartë për të qenë të miratuar).

### Kapitulli III – Regjistrimi i audituesve

OMA-t mbajnë ose mbikëqyrin regjistrimin e audituesve të miratuar. Kriteret për procesin e regjistrimit dhe karakteristikat e regjistrimit jepen në Kapitullin III dhe përfshijnë: **regjistrin publik** (kriteret për karakteristikat e regjistrimit publik të audituesve të miratuar); **kërkesat për audituesit** (informacionet e nevojshme në regjistrin për audituesit individualë); **kërkesat për shoqëritë e auditimit** (informacionet e nevojshme në regjistrin për shoqëritë e auditimit); dhe **pikën unike të hyrjes në BE** (që kërkon që informacionet për regjistrin e audituesve të dorëzohen me një format prej të cilit mund të nxirren të dhënat).

### Kapitulli V - Miratimi i standardeve

Kapitulli V përcakton kërkesat për **standartet** që duhet të përdorin audituesit gjatë kryerjes së auditimeve. Ky kapitull kërkon përdorimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Administrimit të Cilësisë 1 dhe 2, të miratuar nga Komisioni Europian. Mbikëqyrja e përdorimit të standardeve të etikës profesionale, kontrollit të brendshëm të cilësisë së shoqërive të auditimit, të auditimit dhe të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë është një funksion i kërkuar në Kapitullin VIII. Por në qoftë se standartet marrin mbështetje në nivel të Komisionit Europian, atëherë në fakt nuk nevojitet mbikëqyrje nga OMA-t.

Lidhur me standartet e dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, Komisioni do të miratojë standartet në lidhje me dhënien e sigurisë së kufizuar në vitin 2026. Deri atëherë, OMA-t kanë detyrën e përcaktimit të standardeve për dhënien e sigurisë. KOEMA ka nxjerrë udhëzues në lidhje me këto standarde.

### Kapitulli VI - Sistemet e sigurimit të cilësisë

Kapitulli VI kërkon që sistemi i sigurimit të cilësisë i shfrytëzuar a i mbikëqyrur nga OMA të jetë **i paanshëm** (i pavarur prej atyre që shqyrtohen, pa konflikt interesi nga shqyrtuesit, pa ndikim të padrejtë

nga ata që shqyrtohen); **kompetent dhe i pajisur me burime** (i kryer nga individë të formuar dhe të aftë me përvojën përkatëse dhe me fonde të mjaftueshme); **proporcional** (i përshtatshëm dhe proporcional sipas shkallës dhe kompleksitetit të audituesit ligjor/ shoqërisë së auditimit); dhe **i gjithanshëm** (që përfshin shqyrtime që vlerësojnë përputhshmërinë me standardet e auditimit, kriteret e pavarësisë, testimet adekuate, sistemet e brendshme të kontrollit të cilësisë, burimet dhe tarifat e faturuara).

Sistemi duhet të përfshijë raportet vjetore që duhen publikuar me rezultatet e përgjithshme të shqyrtimeve, krahas masave pasuese.

### Kapitulli VII – Hetimet dhe sanksionet

Kapitulli VII kërkon që sistemet e hetimit dhe disiplinimit të shfrytëzuar a mbikëqyrur nga OMA të jenë **efektive** dhe të përfshijnë ndëshkime dhe gjopa në funksion të **zbulimit dhe parandalimit** të problemeve të konstatuara në kryerjen e auditimeve ligjore. Sanksionet dhe masat korrigjuese të vendosura kundër audituesve ligjorë/shoqërive të auditimit duhet **t'i raportohen rregullisht** publikut.

Kompetencat e vendosjes së sanksioneve përfshijnë shqyrtimin e **rëndësisë dhe kohëzgjatjes së shkeljes** (aktuale dhe të mëparshme), përgjegjësinë e mundshme financiare, çdo fitim ose humbje të realizuar, nivelin e bashkëpunimit me OMA-n, përpara vendosjes së sanksionit.

Në sanksionet që ka dispozicion OMA do të duhej të përfshiheshin: tërheqja e miratimit të statusit të audituesit ligjor ose të shoqërisë së auditimit; tërheqje vëmendjeje (paralajmërimi) për shkelje të legjislacionit ose të rregullave; deklarata publike (në faqet zyrtare në internet) me përshkrime të shkeljeve përkatëse; ndalim i përkohshëm i kryerjes së auditimeve ligjore dhe të nënshkrimit të raporteve të auditimit; deklarata se raporti i auditimit nuk përmbush nenin 28 të Direktivës për Auditimin / nenin 10 të Rregullores për Auditimin 537/2014; dhe ndëshkime monetare (gjopa). Deklaratat publike duhet të jenë anonime në qoftë se publikimi mund të cenojë stabilitetin e tregjeve financiare ose të shkaktojë dëm jo proporcional ndaj individëve ose organizatave. Periudha kohore e të qenit publik të sanksionit duhet të jetë pesë vjet, me të drejtë ankimi.

## Aspektet kryesore të Rregullores për Auditimin

Rregullorja për Auditimin parashikon kërkesa shtesë në lidhje me auditimin ligjor (dhe dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë) të NJEIP-ve:


- ✦ kushtet për kryerjen e auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë të NJEIP-ve (nenet 4-15);
- ✦ emërimin e audituesve ligjorë të NJEIP-ve, shoqërive të auditimit dhe dhënësve të sigurisë (nenet 16-19);
- ✦ mbikëqyrjen e aktiviteteve të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit që kryejnë auditimet ligjore të NJEIP-ve (nenet 20-35); dhe

- ✦ bashkëpunimin me autoritetet e vendeve të treta (nenet 36-40).

### Raporti vjetor për monitorimi i tregut

Sipas nenit 28 të Rregullores për Auditimin, OMA-ve u kërkohet të raportojnë çdo vit për aktivitetin rregullator, planin vjetor të punës, rezultatet e përgjithshme të sistemit të kontrollit të cilësisë dhe përmbledhje të gjetjeve dhe përfundimeve të inspektimeve. Neni 27 kërkon që OMA-t të mbajnë në ndjekje zhvillimet e tregut për ofrimin e shërbimeve të auditimit ligjor NJEIP-ve në territorin e kompetencës dhe të publikojnë rezultatet një herë në tre vjet.

**Figura 4.** Funksionet e një OMA në BE



### 1.3. Dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe mbikëqyrja e dhënies së sigurisë

DRQSHT-ja është miratuar më 14 dhjetor 2022. Kjo direktivë ndryshonte Direktivën për Auditimin, Rregulloren për Auditimin dhe 2 direktiva të tjera:

- ✦ Direktiva 2013/34/BE (Direktiva për Kontabilitetin) për pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet e lidhura të disa llojeve të caktuara ndërmarrjesh.
- ✦ Direktiva 2004/109/KE Për harmonizimin e kërkesave për transparencën në lidhje me informacionin për emetuesit letrat me vlerë të cilëve pranohen për tregtim në një treg të rregulluar.

Në janar 2025, KE publikoi Busullën e Aftësisë Konkurruese, që përfshin një udhërrëfyes të ri për të rivendosur dinamizmin e Europës dhe për të nxitur rritjen ekonomike të saj. Busulla synonte thjeshtimin dhe uljen e barrës së raportimit.<sup>16</sup> Më 26 shkurt 2025, KE-ja miratoi një paketë të re propozimesh të hollësishme për të thjeshtuar rregullat dhe kërkesat për raportimin e financave të qëndrueshme dhe Taksonominë e BE-së, për t'u shqyrtuar nga Parlamenti Europian dhe Këshilli.<sup>17</sup>

#### Raportimi i qëndrueshmërisë

DRQSHT synon të forcojë kërkesat e raportimit të qëndrueshmërisë për shoqëritë e mëdha, shoqëritë e listuara në bursë dhe shoqëritë me interes publik, siç përkufizohen me anë të zbatimit të Standardeve të harmonizuara Europiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (SERQ) të përgatitura nga EFRAG (i njohur më parë si Grupi Këshillimor Europian për Raportimin Financiar)<sup>18</sup> dhe të miratuara nga Komisioni Europian. Kërkesat për raportimin po futen gradualisht në zbatim; Grupit të parë të shoqërive tregtare u është kërkuar fillimi i zbatimit të SERQ-ve

prej janarit 2024 për raportimin e informacioneve për qëndrueshmërinë që mbulon temën mjedisore, temën sociale dhe temën e drejtimit të brendshëm (të qeverisjes). Propozimet për thjeshtim, të shpallura në shkurt 2024, në qoftë se miratohen, do të zvogëlonin me 80% numrin e ndërmarrjeve prej të cilave kërkohet të raportojnë për çështjet e qëndrueshmërisë. Kërkesat e raportimit do të zbatoheshin vetëm për ndërmarrjet e mëdha me mbi 1000 punonjës dhe me qarkullim afarist mbi 50 milionë euro ose totalin e aktiveve mbi 25 milionë euro. Thjeshtime të tjera kanë të bëjnë me përdorimin e raportimit vullnetar mbështetur në standardin për NVM-të të hartuar nga EFRAG-u, raportimin e zvogëluar në zinxhirin e vlerës, standardet sektoriale që nuk zbatohen dhe zvogëlimin e numrit të të dhënave të përcaktuara për Taksonominë.

#### Dhënia e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë

DRQSHT kërkon edhe dhënie të sigurisë së kufizuar për raportimin e qëndrueshmërisë nga dhënësit e sigurisë (neni 34 i Direktivës për Kontabilitetin, të ndryshuar), duke filluar afërsisht dy vjet pas afatit të raportimit. Neni 34 kërkon dhënien e një opinionit sigurie për përputhshmërinë me SERQ-të në bazë të një angazhimi sigurie të kufizuar, që duhet të jepet nga një auditues ligjor ose shoqëri auditimi. Parashikohet një mundësi alternative për një ofrues të pavarur të shërbimeve të dhënies së sigurisë (domethënë jo auditues) i cili duhet të jetë në gjendje të japë opinionin e kërkuar, por vetëm në qoftë se dhënësi i sigurisë është objekt i kërkesave të ngjashme me ato që zbatohen për audituesit që ofrojnë shërbimin e dhënies së sigurisë, të parashikuara në Direktivën për Auditimin. Këtu përfshihen kërkesat për formimin dhe arsimin, arsimin e vazhdueshëm profesional (AVP), kontrollin e cilësisë, etikën dhe pavarësinë, emërimin dhe shkarkimin, hetimet dhe sanksionet, organizimin e punës dhe raportimin e parregullive.

Një sërë shtetesh anëtare kanë vendosur t'ua lejojnë vetëm audituesve ligjorë ofrimin e shërbimeve të tilla të dhënies së sigurisë. Këto shtete kanë shtuar

<sup>16</sup> Shih njoftimin për shtyp mbi Busullën Konkurruese të BE-së [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_25\\_339](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_25_339)

<sup>17</sup> Shih njoftimin për shtyp të KE-së [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip\\_25\\_614](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_25_614)

<sup>18</sup> Shih <https://efrag.org/>

kërkesa për arsim dhe formim shtesë për audituesit, në mënyrë që këta të mund të ofrojnë shërbimin e dhënies së sigurisë dhe kanë bërë që rregullat dhe mbikëqyrja e zbatueshme për auditimin ligjor të zbatohen edhe për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, siç përcaktohet në Direktivën për Auditimin. Thjeshtimet e propozuara përfshijnë heqjen e një kërkesë ekzistuese për dhënie sigurie të arsyeshme. Kjo do të siguronte qartësi se nuk do të ketë rritje të ardhshme të kostove për ndërmarrjet të cilat bien brenda objektivit, të lidhura me dhënien e sigurisë.

## Mbikëqyrja e dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë

Ndryshimet që DRQSHT i bën Direktivës për Auditimin u ngarkojnë dhënësve të sigurisë detyra të ngjashme me detyrat që OMA-t u ngarkojnë audituesve. OMA-t bëjnë mbikëqyrjen e audituesve dhe shoqërive të auditimit kur bëjnë dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë. Thjeshtimet e propozuara zëvendësojnë detyrimin e vendosur mbi KE-në për të miratuar standarde për dhënien e sigurisë për qëndrueshmërinë brenda vitit 2026. Kjo do t'i japë mundësi Komisionit t'u japë më shpejt përgjigje problemeve të reja në fushën e dhënies së sigurisë për qëndrueshmërinë, prej të cilave mund të lindte një barrë e panevojshme mbi ndërmarrjet objekt i kërkesave të raportimit.

Kërkesat kryesore shtesë për audituesit që bëjnë dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë përfshihen në Direktivën e ndryshuar për Auditimin:

### Kapitulli II – Miratimi, AVP-ja dhe njohja e

**ndërsjelltë:** Neni 6 i ndryshuar thotë se nevojiten kualifikime arsimore shtesë për marrë miratimin për kryerjen e shërbimeve të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë. Neni 8 shton lëndë të dijeve teorike që lidhen me raportimin e qëndrueshmërisë, të cilat duhet t'i mbulojnë ofruesit e shërbimit të dhënies së sigurisë, krahas temave të lidhura me auditimin. Neni 10 thotë se të paktën tetë muaj nga tri vitet e kërkuara të përvojës praktike duhet të lidhen me dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

**Kapitulli III – Regjistrimi:** Neni 16 është ndryshuar në mënyrë që regjistri i audituesve të tregojë nëse audituesit ligjorë/shoqëritë e auditimit kanë marrë miratimin vetëm për auditim, vetëm shërbime të dhënies së sigurisë ose të dyja.

### Kapitulli IV – Etika profesionale, pavarësia, objektiviteti, konfidencialiteti dhe sekreti

**profesional:** Nenet 24b, 25b dhe 25c shtojnë kërkesa për mënyrën se si angazhimet e dhënies së sigurisë të kryhen në mënyrë etike dhe me pavarësinë, objektivitetin dhe konfidencialitetin e duhur. Neni 25 trajton tarifat e auditimit dhe të dhënies së sigurisë.

### Kapitulli V – Standardet e auditimit dhe raportimi

**i auditimit:** një nen i ri (26a) kërkon që ofruesit e dhënies së sigurisë të zbatojnë standardet e dhënies së sigurisë të miratuara nga Komisioni European. Neni i ri 27a përcakton kërkesat që duhet të përmbushë audituesi i grupit gjatë kryerjes së shërbimit të dhënies së sigurisë për raportimin e konsoliduar të qëndrueshmërisë. Neni i ri 28a detajon kërkesat për raportin e sigurisë.

**Kapitulli VI – Kontrolli i cilësisë:** Shtesat dhe ndryshimet në nenin 29 shtojnë kërkesat për kontrollin e cilësisë së raportimit të qëndrueshmërisë në aspektet e sigurimit të cilësisë për auditimin ligjor, duke përdorur frazën "dhe, sipas rastit, dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë" ose diçka të ngjashme.

**Kapitulli VII – Hetimet dhe sanksionet:** Si edhe me kontrollin e cilësisë, ndryshimet në nenin 30 shtojnë dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë në kërkesat për funksionet e hetimit dhe sanksionimit për auditimin ligjor.

### Kapitulli VIII – Mbikëqyrja publike dhe organizimi rregullator mes Shteteve Anëtare:

**Ndryshimet** në nenin 32 shtojnë dijet për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë në kërkesat për drejtimin e brendshëm të autoriteteve kompetente (OMA) dhe shtojnë detyrimin për t'u mbështetur në standardet e raportimit të qëndrueshmërisë. Neni i ri 36a trajton kërkesat për marrëdhëniet rregullatore mes Shteteve Anëtare në lidhje me dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.

**Kapitulli IX – Emërimi dhe shkarkimi:** Nenet 37 dhe 38 janë ndryshuar për të mbuluar emërimin dhe shkarkimin e ofruesve të shërbimit të dhënies së sigurisë dhe të audituesve ligjorë.

**Kapitulli X – Komitetet e auditimit:** Neni 39 është ndryshuar për të përfshirë dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë në objektin e punës të komiteteve të auditimit.

**Kapitulli XI – Aspektet ndërkombëtare:** Ndryshimet në nenet 45 dhe 48a shtojnë kërkesa në lidhje me subjektet e auditimit të vendeve të treta që ofrojnë shërbimin e dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe në lidhje me vlerësimet e barasvlershmërisë së vendeve të treta, ndër të tjera.

Për më shumë informacion për legjislacionin e BE-së për mbikëqyrjen publike të audituesve dhe shoqërive të auditimit, shih **Shtojcën 1**.

**Këto janë disa nga rrjedhojat kryesore të DRQSHT-së për vendet që krijojnë një SMP të ngjashëm në natyrë me BE-në:**

- ✦ Marrja e detyrës së mbikëqyrjes së ofruesve të shërbimit të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë është një sfidë e konsiderueshme OMA-t ekzistuese. Do të nevojiten njohuri të reja teknika dhe përvojë e re në dhënien e sigurisë dhe raportimin e qëndrueshmërisë, në nivel bordi dhe personeli.
- ✦ Shtetet Anëtare të BE-së janë në fazat e para fare të mbikëqyrjes së dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë. Vendet jo-anëtare të BE-së që kërkojnë të zbatojnë kërkesa të ngjashme me ato në DRQSHT-së mund ta bëjnë këtë me maturi, duke mësuar nga përvoja e vendeve të BE-së dhe duke ua përshtatur këto mësimet rrethanave të vendit.



## Studime të kohëve të fundit për mbikëqyrjen e auditimit nga BE-ja dhe rrjedhojat e tyre për SMP-të aspiruese

### 2.1. Studimi i BE-së për ndikimin e reformës së auditimit në BE

Në tetor 2022 është botuar një studim për Direktivën e Auditimit dhe Rregulloren e Auditimit<sup>19</sup> i kryer nga KE-ja. Në të analizohet ndikimi që ka Direktiva dhe Rregullorja për Auditimin në arritjen e objektivave të reformës së auditimit, të zbatuar në vitin 2013.

Reforma e tregut të auditimit ligjor në BE kishte katër objektiva:

- ✦ rritja e transparencës për investorët nëpërmjet kërkesave minimale për përmbajtjen e raportit të auditimit dhe të raportit të komitetit të auditimit;
- ✦ rritja e pavarësisë së audituesve kundrejt klientëve, përfshirë rotacionin e detyrueshëm të shoqërive

të auditimit dhe ndalimin e realizimit të disa shërbimeve jo auditim;

- ✦ nxitja e konkurrencës në tregun e auditimit; dhe
- ✦ fuqizimi i mbikëqyrjes mbareuropiane nëpërmjet mbikëqyrjes publike.

Më poshtë jepet në formë të përmbledhur se çfarë evidentonte studimi:

### Ndikimi i përgjithshëm i reformave të vitit 2013

Pavarësisht nga disa përmirësime të qarta në harmonizimin e kornizave kombëtare, ka ende dallime të konsiderueshme mes vendeve sa i takon vënies

në zbatim dhe kontrollit të zbatimit të legjislacionit të BE-së për auditimin (p.sh., në lidhje me kërkesat për auditimin që zbatohen për lloje të ndryshme ndërmarrjesh, kërkesat për rotacionin, hetimet, regjimet e sanksioneve).

## Auditimi i NJEIP-ve

Shumica e raporteve të auditimit për NJEIP-të:

- ✦ udhëhiqen nga anëtarë të Katërshes së të Mëdhenjve,
- ✦ nuk përmbajnë të gjitha informacionet përkatëse për praktikën e drejtimit të brendshëm të shoqërisë që zbatohen përtej kërkesave të legjislacionit kombëtar,
- ✦ duket se nuk shkojnë përtej kërkesave ligjore të BE-së,
- ✦ shumë prej problemeve të përmbushjes të identifikuar kanë të bëjnë me kërkesat e lidhura me raportin e drejtimit dhe pasqyrën për drejtimin e brendshëm të shoqërisë.

## Transparenca, pavarësia dhe konkurrenca

Për emërimin e audituesve ligjorë:

- ✦ mbi një e dyta e shoqërive të kampionit e ndryshuan shoqërinë e auditimit ose audituesin ligjor gjatë periudhës 2016-2020,
- ✦ shumica dërrmuese e shoqërive parapëlqenin të kishin të njëjtën shoqëri auditimi për të gjitha shoqëritë e grupit.

Lidhur me pavarësinë dhe konkurrencën:

- ✦ reforma i kishte rritur nivelet e pavarësisë, por nuk kishte pasur ndikimin e synuar në konkurrencë,
- ✦ kalimi mes llojeve të ndryshme të audituesve ishte i kufizuar, ku një pjesë e tregut vijonte të mbahej nga Katërshja e të Mëdhenjve,
- ✦ shoqëritë e auditimit që nuk janë pjesë e Katërshes së të Mëdhenjve ftoheshin shpesh në procedura prokurimi, por sa më komplekse të ishte shoqëria tregtare në fjalë (madhësia, struktura,

mbulimi gjeografik etj.), aq më pak të ngjarë kishte të merrnin pjesë dhe të fitonin kontratën e angazhimit,

- ✦ megjithatë, rotacioni i detyrueshëm, sipas përfaqësuesve të komitetit të auditimit dhe, diçka më pak, sipas audituesve, kishte kontribuar për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të auditimit, pavarësinë e audituesve dhe konkurrencën mes shoqërive të auditimit.

Në lidhje me kufirin prej 70% të tarifave për ofrimin e shërbimeve jo auditim për NJEIP-të:

- ✦ nga 234 shoqëritë e auditimit që e tejkalonin kufirin maksimal në vitin 2015, më shumë se një e dyta i ulën tarifat e shërbimeve jo auditim nën kufirin maksimal brenda vitit 2018,
- ✦ 84 shoqëri auditimi të tjera e tejkalonin kufirin maksimal në vitin 2018,
- ✦ shumica e ndërmarrjeve kishin zbatuar kufizime të brendshme më të rrepta për përdorimin e shërbimeve jo auditim,
- ✦ sipas përfaqësuesve të komiteteve të auditimit, kjo kishte dhënë kontribut të rëndësishëm në pavarësinë e audituesve dhe, diçka më pak, në përmirësimin e cilësisë,
- ✦ kjo, për të paktën disa ndërmarrje, kishte sjellë ulje të konkurrencës.

Lidhur me tarifat e auditimit, analiza tregon:

- ✦ një gamë shumë të gjerë të kostove të auditimit, me dallime të konsiderueshme në varësi të sektorit.
- ✦ tarifa dukshëm më të larta për auditimin e NJEIP-ve në krahasim me auditimet e njësive ekonomike pa interes publik.
- ✦ tarifa më të ulëta kur nuk kryheshin procedura të rregullta prokurimi.

## Bashkëpunimi ndërkufitar me vendet e treta

Në lidhje me bashkëpunimin ndërkufitar mes Shteteve Anëtare të BE-së dhe me vendet jashtë BE-së (vende të treta), siç e kërkon Direktiva dhe Rregullorja për Auditimin:



- ✦ Çekia, Franca, Irlanda, Italia, Lituania, Polonia, Rumania dhe Norvegjia nuk vërenin ndonjë vështirësi madhore në lidhje me bashkëpunimin ndërkufitar me vendet e treta.
- ✦ Gjermania shprehej se bashkëpunimi me auditues të vendeve të treta do të përfitonte nga ndjekja e një procedure të thjeshtuar për shkëmbim të gjithanshëm informacionesh që trajton faktorët kufizues, siç janë vendimet për mjaftueshmërinë ose kërkesat për marrëveshje bashkëpunimi dhe marrëveshje për mbrojtjen e të dhënave.
- ✦ Spanja shprehej se duhej fuqizuar bashkëpunimi ndërkufitar duke i dhënë KOEMA-s statusin e autoritetit mbikëqyrës europian, me kompetencën dhe burimet përkatëse.
- ✦ Vendet e Ulëta shprehej se shkëmbimi i informacioneve përkatëse me entet rregullatore jashtë BE-së vuante nga kufizimet e nenit 47 të Direktivës për Auditimin dhe se bashkëpunimi pengohej nga fakti se merren pak vendime për mjaftueshmërinë dhe se fokusi vihej në vendimet e barasvlershmërisë të cilat nuk lejojnë shkëmbimin e informacionit konfidencial nga dosja e auditimit.
- ✦ Të gjitha vendet i trajtojnë informacionet ndërkufitare në mënyrë konfidenciale, me adresa të mbrojtura të postës elektronike, duke respektuar detyrimin e sekretit profesional të përcaktuar me legjislacion të brendshëm. Shumica e vendeve duket se nuk kanë kanale të veçanta për të shkëmbyer informacione të tilla konfidenciale.

**Këto janë disa nga rrjedhojat kryesore të studimit, për vendet që krijojnë një SMP të ngjashëm në natyrë me BE-në:**

- ✦ Disa shtete anëtare të BE-së duket se kanë hasur në vështirësi gjatë ngritjes së mbikëqyrjes efektive, pasi ka “mospërputhje” mes legjislacionit të BE-së për auditimin dhe mënyrës se si bëhet dhe kontrollon zbatimi i tij.
- ✦ Zbatimi i reformave të auditimit, përfshirë krijimin e një SMP-je, mund ta ketë rritur

pavarësinë e audituesve (ndoshta edhe cilësinë), por nuk ka ndikuar në konkurrencën mes shoqërive të auditimit.

- ✦ Ka një gamë shumë të gjerë tarifash auditimi mes vendeve dhe sektorëve. Kjo mund të përbëjë vështirësi për një SMP pasi një tarifë shumë e ulët auditimi është tregues i fortë i cilësisë së dobët.
- ✦ Bashkëpunimi ndërkufitar midis BE-së dhe OMA-ve të vendeve të treta mund të hasë në vështirësi të konsiderueshme, edhe kur SMP-ja e vendit të tretë vlerësohet si “i barasvlershëm” (por jo plotësisht “adekuat”). Studimi ka evidentuar vështirësitë në mbikëqyrjen e auditimeve të pjesëve përbërëse të grupeve të shoqërive tregtare të BE-së, çka lidhet me rregullatorët e vendeve të treta.

## 2.2. Raporti i KOEMA-s për zhvillimet në tregun e auditimit të NJEIP-ve në BE

KOEMA ka hartuar një raport të përbashkët për zhvillimet në tregun e BE-së për shërbimet e auditimit ligjor për njësitë ekonomike me interes publik nga viti 2019 deri në vitin 2021<sup>20</sup> për llogari të Komisionit European, Bankës Qendrore Europiane dhe Këshillit European për Rrezikun e Sistemit. Raporti është botuar në mars 2024. Ai mbështetet në raportet e tregut, që hartohen çdo tre vjet nga OMA-t në BE, siç e kërkon neni 27 i Rregullores për Auditimin.<sup>21</sup> Raporti trajton zhvillimet në tregun e BE-së për kryerjen e auditimeve ligjore të NJEIP-ve, nga viti 2019 deri në vitin 2021 dhe përqendrohet në sa vijon:

- ✦ përqendrimi në treg;
- ✦ rreziqet e lindura nga mangësitë në cilësinë e auditimit; dhe
- ✦ puna e komiteteve të auditimit.

<sup>20</sup> Shih <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-8738-2024-INIT/en/pdf>

<sup>21</sup> Shih <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:32014R0537&from=DE#d1e2376-77-1>

Në konstatimet kryesore janë:

- ✦ Kishte rënë numri i audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit.
- ✦ Shoqëritë e auditimit vijonin të përqendroheshin në shërbime jo auditimi krahas punës për auditimin ligjor).
- ✦ Katërshja e të Mëdhenjve zotëronte një shkallë të lartë përqendrimi në treg, por kishte pasur një kalim të lehtë drejt 10 shoqërive kryesore të mbetura të auditimit në tregun evropian të auditimit.
- ✦ OMA-t vijonin të zbulonin një shpeshtësi të lartë mangësish nëpër inspektime, megjithëse nuk ishte identifikuar ndonjë rrezik i sistemit.
- ✦ Në përgjithësi, komitetet e auditimit e kishin përmirësuar punën e tyre (në lidhje me detyrat mbikëqyrëse, përfshirë më shumë mbikëqyrje dhe shqyrtim të shërbimeve jo auditim).
- ✦ Ndikimi i inflacionit, rritja e normave të interesit, paqëndrueshmëria gjeopolitike dhe përdorimi në rritje i instrumenteve të analizës së të dhënave dhe inteligjencës artificiale në lidhje me auditimin mund të paraqesin sfida në vitet e ardhshme dhe duhet të mbahen në ndjekje.

**Këto janë disa nga rrjedhojat kryesore të raportit, për vendet që krijojnë një SMP të ngjashëm në natyrë me BE-në:**

- ✦ Përqendrimi i tregut ka rënë paksa në BE, por mbetet i lartë, diçka që mund të jetë e ngjashme në tregjet e tyre. Do t'ia vlente të bisedohej dhe bashkërendohej me OMA-t në BE se si të trajtohet më së miri inspektimi dhe hetimi i rrjeteve ndërkombëtare të auditimit.
- ✦ Rreziqet e sistemit në të gjitha auditimet duket se janë të rralla, por në të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së shihen shumë mangësi në cilësinë e auditimit. Kjo mund të jetë e ngjashme me vështirësitë e hasura në vendet e tyre.
- ✦ Sfidat kryesore të identifikuar duhet të marrin zgjidhje nëpërmjet përgatitjes së kundërpërgjigjeve zbutëse dhe nëpërmjet mbajtjes në ndjekje të vazhdueshme.

## 2.3. Anketa e IFIAR-it për regjimet ndërkombëtare të zbatimit me forcë

IFIAR është organizata ndërkombëtare e OMA-ve. Në të, janë anëtarësuar pothuajse të gjithë OMA-t e BE-së; nga vendet e Ballkanit Perëndimor, vetëm Shqipëria është aktualisht anëtare e IFIAR-it, megjithëse edhe vendet e tjera janë në bisedime për t'u anëtarësuar.

IFIAR ndihmon në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe bashkërendimin e inspektimeve dhe hetimeve të auditimit nëpërmjet grupeve të punës, mbledhjeve, raporteve dhe anketave. Kjo ka rëndësi sidomos për OMA-t që aspirojnë të anëtarësohen, sepse shohin si të punojnë dhe të ndajnë informacione me OMA-t në vende të tjera.

Në qershor 2023, IFIAR publikoi një anketë për regjimet e zbatimit me forcë,<sup>22</sup> ku vihej në dukje se:

*“Përhapja e NJEIP-ve shumëkombëshe dhe rrjeteve globale të auditimit që ofrojnë shërbime ndërkufitare auditimi ka çuar në rritje të veprimtarisë hetimore ndërkombëtare. Mundësia për të shkëmbyer informacione konfidenciale me rregullatorë të tjerë ka dalë në pah si shumë e rëndësishme për anëtarët e IFIAR-it. Megjithëse ka potencial për rritje të bashkëpunimit ndërkombëtar, ka ende pengesa në shkëmbimin e informacioneve.”*

## Pikat më kryesore nga konstatimet e anketës


Në përgjithësi, të anketuarit u përgjigjën se mund të ndanin informacione konfidenciale hetimore me autoritetet e huaja. Megjithatë, mundësia për të shkëmbyer të dhëna mund të jetë e kufizuar dhe ky shkëmbim me disa autoritete të huaja mund të kërkojë një letër bashkëpunimi, një aktmarrëveshje bashkëpunimi ose diçka të ngjashme. Disa shembuj janë aktmarrëveshja tip e IFIAR-it, aktmarrëveshja e IOSCO-s ose nëpërmjet direktivave ose rregulloreve të zbatueshme të BE-së për Shtetet Anëtare të BE-së.

Lidhur me kufizimet në shkëmbimin e informacioneve me autoritetet e huaja, të anketuarit me tagrin për të ndarë informacione konfidenciale hetimore me autoritetet e huaja u shprehën se:

- ✦ Ka kufizime mbi sasinë e informacioneve që mund të japin ose mbi rrethanat në të cilat mund t'i japin.
- ✦ Kufizime të tilla lindin nga ligjet a marrëveshjet bazë me autoritete të tjera dhe shpesh përfshijnë fshehtësinë e informacionit, njoftimin dhe miratimin, përdorimin e lejueshëm të informacionit dhe faktin nëse dhënia e një informacioni të tillë do të ishte me rëndësi për punën ose detyrat e organizatës tjetër.

**Këto janë disa nga rrjedhojat kryesore të anketës së IFIAR-it për vendet që krijojnë një SMP të ngjashëm në natyrë me BE-në:**

- ✦ OMA-t përfitojnë nga bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi i informacionit, sidomos në lidhje me auditimet e NJEIP-ve shumëkombëshe dhe rrjeteve globale të auditimit që ofrojnë shërbime ndërkufitare auditimi. Por shkëmbimi i informacioneve mund të jetë objekt kufizimi për shkak të konfidencialitetit dhe kufizimeve ligjore.
- ✦ Dhënia e informacioneve jashtë BE-së shpesh mundësohet nëpërmjet nënshkrimit të aktmarrëveshjeve me organe të tjera mbikëqyrëse. Aktmarrëveshje tip gjenden nga IFIAR dhe IOSCO.



## Sistemet e mbikëqyrjes publike në disa Shtete Anëtare të BE-së

Studimi i BE-së për ndikimin e reformave të auditimit (shih pikën 2.1) nxirrte në pah dallime të konsiderueshme në mënyrën se si vendet bëjnë dhe kontrollojnë zbatimin e legjislacionit për auditimin. Ndër fushat ku mund të shihen këto dallime janë:

1. Legjislacioni – nëse kërkesat janë në një ligj më vete apo përfshihen në një ligj ekzistues.
2. Vendndodhja e autoritetit kompetent/OMA-s.
3. Drejtimi i brendshëm i OMA-s.
4. Burimet dhe kapacitetet e SMP-së.
5. Delegimi i funksioneve nga OMA te organizata të tjera.

Në këtë pjesë, jepet një përmbledhje e qasjeve të ndjekura në këto fusha, për aq sa gjendet publikisht informacion, në një sërë vendesh të vogla dhe të mesme të BE-së. Vendet e përzgjedhura kanë numër të ngjashëm banorësh me vendet e Ballkanit Perëndimor, dhe disa prej tyre mund të kenë edhe karakteristika historike dhe juridike të përbashkëta.

### Vendet e përdorura për krahasim me vendet e REPARIS-it

Në tabelën e mëposhtme paraqiten vendet krahasuese të përdorura dhe numri i banorëve në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor.

| Vendi            | I VOGËL |        |         | I VOGËL / I MESËM |         |                        |           | I MESËM         |         |        |         |        |
|------------------|---------|--------|---------|-------------------|---------|------------------------|-----------|-----------------|---------|--------|---------|--------|
|                  | Estonia | Kosova | Letonia | Mali i Zi         | Albania | Bosnia and Herzegovina | Lithuania | North Macedonia | Austria | Greece | Ireland | Serbia |
| Banorë (milione) | 1,366   | 1,762  | 1,881   | 0,617             | 2,778   | 3,323                  | 2,872     | 2,058           | 9,132   | 10,361 | 5,262   | 6,664  |

Janë përfshirë edhe **Franca dhe Gjermania**, si shembuj të praktikës më të mirë.

Në tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje e karakteristikave për Shtetet Anëtare të BE-së të përzgjedhura. Një tabelë e ngjashme me karakteristikat e vendeve të Ballkanit Perëndimor gjendet në pjesën 4.

**Tabela 1.** Karakteristikat e Shteteve Anëtare të BE-së të përzgjedhura

| Austria                                                                            | Estonia                                                                      | Greqia                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Irlanda                                                                                                                               | Letonia                                                                                                                    | Lituania                                                                                                                               | Slovenia                                                       |
|------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------|
| Dikasteri përgjegjës për SMP-në                                                    |                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                       |                                                                                                                            |                                                                                                                                        |                                                                |
| Ministria Federale e Financave                                                     | Ministria e Financave                                                        | Ministria e Financave                                                                                                                                                                                                                                                                   | Drejtoria për Ndërmarrjen, Tregtinë dhe Punësimin                                                                                     | Sektori i Politikave dhe Mbikëqyrjes së Auditimit të Shoqërive Tregtare, Ministria e Financave                             | Ministria e Financave                                                                                                                  | Ministria e Financave                                          |
| Legjislacioni përkatës                                                             |                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                       |                                                                                                                            |                                                                                                                                        |                                                                |
| Ligji për mbikëqyrjen e audituesve <sup>23</sup> dhe Rregullorja (BE) Nr. 537/2014 | Ligji për veprimtarinë e audituesit, <sup>24</sup> Rregullorja <sup>25</sup> | Ligji 3148/2003, ndryshuar me Ligjin 4449/2017 dhe përmirësuar më tej në vitin 2008 me përfshirjen në legjislacionin grek të Direktivës së KE-së 2006/43/KE me Ligjin 3693/2008, të përshatuar me zbatimin e Rregullores 537/2014/BE, dhe të Direktivës 2014/56/BE me Ligjin 4449/2017. | Ligji për shoqëritë tregtare i vitit 2014 (ndryshuar në 2018) dhe Instrumenti Normativ Nr. 360 i vitit 2017 (SI Nr. 360 i vitit 2017) | Ligji për shërbimet e auditimit 2004 (i ndryshuar në 2019), neni 26 thotë se organi përgjegjës është Ministria e Financave | Ligji Nr. 458, datë 6.5.2015, dhe Ligji për Auditimin <sup>26</sup> Nr. XIII-96 i vitit 2017, dhe Rregullorja (BE) Nr. 537/2014        | Ligji për auditimin (ZRev-2) dhe Rregullorja (BE) Nr. 537/2014 |
| Emërtimi i organit të mbikëqyrjes publike                                          |                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                       |                                                                                                                            |                                                                                                                                        |                                                                |
| Autoriteti Austriak i Mbikëqyrjes së Auditimit (APAB)                              | Këshilli Mbikëqyrës i Aktiviteteve të Auditimit                              | Bordi Grek i Mbikëqyrjes së Standardeve të Kontabilitetit dhe Auditimit (ELTE)                                                                                                                                                                                                          | Autoriteti Mbikëqyrës Irlandez i Auditimit & Kontabilitetit (IAASA)                                                                   | Këshilli Konsultativ i Auditimit, themeluar nga Ministri i Financave si organ këshillimor                                  | Autoriteti i Auditimit, Kontabilitetit, Verësimit të Pasurive dhe Administrimit të Falimentimit (AAPVIM) pranë Ministrisë së Financave | Agjencia për Mbikëqyrjen Publike të Auditimit (APOA)           |

<sup>23</sup> Shih <https://www.ris.bka.gv.at/GeltendeFassung.wxe?Abfrage=Bundesnormen&Gesetzesnummer=20009615>

<sup>24</sup> Shih <https://www.rigiteataja.ee/akt/117032023006#para121lg3>

<sup>25</sup> Shih <https://www.rigiteataja.ee/akt/131102017003>

<sup>26</sup> Shih <https://e-seimas.lrs.lt/portal/legalAct/lt/TAD/40997e20566b11e78869ae36ddd5784f?jfwid=pfifeukkrm>

| Austria                                                                                                                                                                                                       | Estonia                                                                                                                                                                                 | Greqia                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Irlanda                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Letonia                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Lituania                                                                                                                                                                                                                                     | Slovenia                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Të dhëna për organin drejtues                                                                                                                                                                                 |                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| 6 anëtarë gjithsej. 2 anëtarë të këshillit të administrimit emërohen me mandat 5-vjeçar nga Qeveria Federale Austriake. Të dy anëtarët e këshillit janë të pavarur nga çdo anëtar tjetër i këshillit          | 7 anëtarë, përfshirë kryetarin. Mandati është 5 vjet. 3 anëtarë propozohen përkatësisht nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Ministria e Drejtësisë. | 7 anëtarë = kryetari, 2 zëvendëskryetarë, 4 anëtarë të tjerë: Përfaqësues nga Banka e Greqisë, Komisioni Grek i Tregjeve të Kapitalit, Federata e Industrive Greke dhe Dhoma Ekonomike e Greqisë                                                                                                                                                                                          | 9 Anëtarë të këshillit të administrimit - 1 është Drejtor Ekzekutiv, 8 janë anëtarë të jashtëm dhe emërohen nga Ministri me propozim nga: Drejtorja për Ndërmarrjen, Tregtinë dhe Punësimin - 2, Organet e përcaktuara kontabël - 2, Banka Qendrore e Irlandës -1, Autoriteti i Kontrollit Ligjor të Shoqërive Tregtare -1, Bursa Irlandeze - 1, Drejtorët e Administratës Fiskale - 1     | Ministria e Financave                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | 7 anëtarë (përfshirë kryetarin). Nga një anëtar secili emërohet nga Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë, Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Banka e Lituanisë, dhe dy anëtarë të emëruar nga Dhoma e Audituesve | 9 anëtarë të emëruar për 6 vjet me mundësi riemërimi - Kryetar është Presidenti i Këshillit të Ekspertëve, plus përfaqësues nga Agjencia e Tregjeve të Letrave me Vlerë, Instituti Sloven i Audituesve, Bursa e Lubjanës, Banka e Slovenisë, Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Universiteti i Lubjanës, Ministria e Ekonomisë, Turizmit dhe Sporteve, Ministria e Financave |
| Funksionet deleguar një organi tjetër                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Vendosja e standardeve të auditimit dhe etikës, arsimit dhe AVP-së dhe inspektimi i audituesve që nuk auditojnë NJEIP i është deleguar Dhomës Austriake të Kontabilitetëve Publikë dhe Këshilltarëve Fiskalë. | Arsimi i vazhdueshëm profesional i është deleguar Shoqatës së Audituesve të Estonisë, si edhe zhvillimi.                                                                                | Inspektimet e cilësisë së audituesve të njësive ekonomike pa interes publik dhe disa licencime, arsimi, AVP                                                                                                                                                                                                                                                                               | Auditimet e njësive ekonomike pa interes publik, inspektohen nga organet e njohura të kontabilitetit. Janë deleguar edhe licencimi, regjistrimi dhe arsimi/AVP.                                                                                                                                                                                                                            | i. Arsimi dhe provimi profesional; ii. licencat dhe regjistrimi i audituesve, objekt i mbikëqyrjes dhe miratimit të Sektorit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Auditimit të Shoqërive Tregtare; iii. arsimi i vazhduar profesional; iv. Regjistrimi i audituesve të vendeve të treta; v. shqyrtimet e kontrollit të cilësisë dhe procedurat hetimore dhe disiplinore për auditimet e njësive ekonomike pa interes publik. | Licencimi, regjistrimi, AVP                                                                                                                                                                                                                  | Nuk ka, APOA ka detyrën drejtpërdrejt për licencimin, regjistrimin, auditimin/etikën, arsimin/AVP-në, inspektimin dhe zbatimin me forcë.                                                                                                                                                                                                                                        |
| Burimi i financimit                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                                                                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Financimi jepet nga Ministria Federale e Financave, Dhoma e Konsulentëve Fiskalë dhe Audituesve, kooperativat e auditimit dhe bankat e kurseimeve.                                                            | Pjesërisht financiar nga shoqëritë e auditimit dhe pjesërisht nga buxheti i shtetit - sipas legjisllacionit, financimi nga buxheti i shtetit është deri në 50%                          | Financimi përfshin një taksë ligjore mbi të gjitha shoqëritë e auditimit, e llogaritur si përqindje fikse e shumës bruto të tarifave të auditimit - kjo përqindje është e përcaktuar me ligj dhe mund të ndryshohet vetëm me një ndryshim në ligj. Buxheti vjetor i ELTE-s miratohet nga Ministria e Financave dhe të gjitha pagesat ndjekin procedurat e zbatueshme për sektorin publik. | Financimi për mbikëqyrjen e organeve të profesionit kontabël vjen nga Thesari (40%) dhe nga organet e përcaktuara të profesionit kontabël (60%). Financimi për miratimin e standardeve të auditimit vjen nga Thesari (40%) dhe nga organet e njohura të profesionit kontabël (60%). Financimi për aktivitetet e inspektimit të auditimit vjen nga shoqëritë e auditimit me interes publik. | Me financim të plotë nga buxheti i shtetit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Me fonde të qeverisë së Republikës së Lituanisë (nëpërmjet Ministrisë së Financave)                                                                                                                                                          | Me fonde nga buxheti i shtetit dhe nga shoqëritë e auditimit për aktivitetet mbikëqyrëse të APOA-s (rreth 60% buxheti i shtetit, 40% shoqëritë e auditimit). Punonjësit e APOA-s janë nëpunës civilë dhe pagat e tyre përcaktohen me ligj. Shoqëritë e auditimit pagualjnë taksë në bazë vjetore në përputhje me tabelën e taksave, 0.9% të të ardhurave të tyre vjetore.       |

| Austria                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Estonia                                                     | Greqia                                                                                                              | Irlanda                                                                    | Letonia              | Lituania                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Sllovenia                                        |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------|----------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|
| Numri i punonjësve (përfshirë punonjësit profesionistë)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |                                                             |                                                                                                                     |                                                                            |                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                                                  |
| 8,7 ekuivalentë punonjës me orar të plotë. Grupi A (4 punonjës) - Inspektimet dhe hetimet me inspektorë me orar të plotë. Duhet të përbushin kriteret dhe të kenë përvojë në auditim dhe raportim financiar, si dhe formim të veçantë për shqyrtimet e kontrollit të cilësive. Grupi B (3 punonjës) - Çështje juridike, marrëdhënie me jashtë dhe kontroll i cilësive - këshilltar juridik dhe detyrën për zbatimin dhe shqyrtimin kolegjial të kontrollit të cilësive të shoqërive të auditimit të njësive ekonomike pa interes publik | 4 specialistë të kontrollit të cilësive dhe 1 administrator | 12 inspektorë                                                                                                       |                                                                            |                      | 49 punonjës gjithsej. Cilësia e auditimit - 1 drejtor drejtorie, 1 kryespecialist dhe 5 specialistë të lartë. Drejtorja e Licencimit - 1 drejtor drejtorie, 1 kryespecialist, 3 specialistë të lartë.<br><br>Drejtorja Juridike - 1 drejtor, 3 specialistë të lartë. Vlerësimi i kontrollit të cilësive - 1 drejtor, 3 specialistë të lartë. Qëndrueshmëria/ Llogaridhënia - 1 punonjës. Drejtori të tjera - 28 punonjës | 9 punonjës në fund të vitit 2023 - buxhet për 11 |
| Numri i shoqërive të auditimit, audituesve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                                                             |                                                                                                                     |                                                                            |                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                                                  |
| 288 shoqëri auditimi, 29 auditues                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | 114 shoqëri auditimi                                        | 67 shoqëri auditimi, 4 auditues ligjorë të cilët kryejnë auditime ligjore si individë, 1329 auditues ligjorë aktivë | 1 083 shoqëri auditimi, 45 896 anëtarë të organeve të përcaktuara kontabël | 167 shoqëri auditimi | 153 shoqëri auditimi, 314 auditues individual                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | 4 648 shoqëri auditimi, 168 auditues             |
| NNumri i shoqërive të auditimit të NJEIP-ve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |                                                             |                                                                                                                     |                                                                            |                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                                                  |
| 15                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Pa kategori më vete                                         | Pa kategori më vete                                                                                                 | 8                                                                          | Pa kategori më vete  | 6                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 10                                               |
| Numri i auditimeve ligjore të NJEIP-ve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                             |                                                                                                                     |                                                                            |                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                                                  |
| 264 (përfshirë auditimet e pasqyrave të konsoliduara), 176 NJEIP                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | n/a                                                         | 205                                                                                                                 | 502                                                                        | n/a                  | 182                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | 84                                               |
| Raporti vjetor publikohet                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                             |                                                                                                                     |                                                                            |                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |                                                  |
| Po                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Po                                                          | Po                                                                                                                  | Po                                                                         | Po                   | Po                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Po                                               |

I vogël

I vogël / I mesëm

I mesëm

I madh



### 3.1. Përgjegjësia për legjislacionin

Të gjitha Shtetet Anëtare kanë zbatuar kërkesat e BE-së për ngritjen e një SMP-je dhe të një OMA-je. Megjithatë, detyra për legjislacionin me të cilin ngrihet SMP-ja dhe për ligjin me të cilin miratohen ky legjislacion mund të ndryshojë nga vendi në vend. Kjo duket nga analiza e mëposhtme për vendet krahasuese të përzgjedhura, si dhe për Francën dhe Gjermaninë.

**Këto janë disa nga rrjedhojat kryesore për vendet që krijojnë një SMP të ngjashëm në natyrë me BE-në:**

- ✦ Në shumë vende të BE-së, Ministria e Financave është përgjegjëse për SMP-në, por ka edhe shembuj alternativë, përfshirë ministri të tjera dhe komisione të letrave me vlerë.
- ✦ Kur një vend ka ligj të veçantë për auditimin, në përgjithësi është ky ligj që ndryshohet.

**Tabela 2.** Përgjegjësia për legjislacionin me të cilin ngrihet SMP-ja dhe ligji përkatës

| Vendi                                  | Austria                                                                            | Estonia                                                                      | Franca                                                                                       | Gjermania                                                       | Greqia                                           |
|----------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|
| <b>Dikasteri përgjegjës për SMP-në</b> | Ministria Federale e Financave                                                     | Ministria e Financave                                                        | Ministria e Drejtësisë                                                                       | Zyra Federale për Çështje Ekonomike dhe Kontrollin e Eksporteve | Ministria e Financave                            |
| <b>Legjislacioni</b>                   | Ligji për mbikëqyrjen e audituesve <sup>27</sup> dhe Rregullorja (BE) Nr. 537/2014 | Ligji për veprimtarinë e audituesit, <sup>28</sup> Rregullorja <sup>29</sup> | Urdhri H2A nr. 2023-1142, datë 6.12.2002, (H3C) Ligji për Sigurinë Financiare, datë 1.8.2003 | Ligji për reformën e mbikëqyrjes së audituesve                  | Ligji 3148/2003, i ndryshuar me Ligjin 4449/2017 |

| Vendi                                  | Irlanda                                                                                                                               | Letonia                                                                                        | Lituania                                                                                                                       | Polonia                                                                                                  | Sllovenia                                                      |
|----------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------|
| <b>Dikasteri përgjegjës për SMP-në</b> | Drejtoria për Ndërmarrjen, Tregtinë dhe Punësimin                                                                                     | Sektori i Politikave dhe Mbikëqyrjes së Auditimit të Shoqërive Tregtare, Ministria e Financave | Ministria e Financave                                                                                                          | Ministria e Financave                                                                                    | Ministria e Financave                                          |
| <b>Legjislacioni</b>                   | Ligji për shoqëritë tregtare i vitit 2014 (ndryshuar në 2018) dhe Instrumenti Normativ Nr. 360 i vitit 2017 (SI Nr. 360 i vitit 2017) | Ligji për shërbimet e auditimit i vitit 2004 (i ndryshuar në 2019) neni 26                     | Ligji Nr. 458, datë 6.5.2015 dhe Ligji për Auditimin <sup>30</sup> Nr. XIII-96 i vitit 2017, dhe Rregullorja (BE) Nr. 537/2014 | Ligji i ndryshuar, datë 11.5.2017, për audituesit ligjorë, shoqëritë e auditimit dhe mbikëqyrjen publike | Ligji për auditimin (ZRev-2) dhe Rregullorja (BE) Nr. 537/2014 |

■ I vogël

■ I vogël / I mesëm

■ I mesëm

■ I madh

<sup>27</sup> Shih <https://www.ris.bka.gv.at/GeltendeFassung.wxe?Abfrage=Bundesnormen&Gesetzesnummer=20009615>

<sup>28</sup> Shih <https://www.riigiteataja.ee/akt/117032023006#para121lg3>

<sup>29</sup> Shih <https://www.riigiteataja.ee/akt/131102017003>

<sup>30</sup> Shih <https://e-seimas.lrs.lt/portal/legalAct/lt/TAD/40997e20566b11e78869ae36ddd5784f?jfwid=pflfeukkkm>

## 3.2. Vendndodhja e sistemeve të mbikëqyrjes publike

OMA-t në Shtetet Anëtare të BE-së ndodhen në dikastere të ndryshme, pranë një enti tjetër rregullator ose si organ mbikëqyrës i pavarur. Çdo vend ka vendosur vendndodhjen më të mirë për sistemin e mbikëqyrjes sipas rrethanave individuale kombëtare. OMA-t në BE i kanë zhvilluar ndjeshëm sistemet dhe strukturat e mbikëqyrjes, përfshirë edhe ndarjen e përvojave me organet e tjera të mbikëqyrjes, pas publikimit të fundit të Bankës Botërore mbi SMP-të në BE në vitin 2017,<sup>31</sup> por pak ndryshime kanë ndodhur sa i takon vendndodhjes së sistemeve të mbikëqyrjes publike.

**Këto janë disa nga rrjedhojat kryesore për vendet që krijojnë një SMP të ngjashëm në natyrë me BE-në:**

- ✦ Ekzistojnë precedentë të BE-së për një sërë mundësish alternative sa i takon vendndodhjes së OMA-s. Më së shumti, OMA është pjesë e një organi shtetëror ose është organizatë e pavarur (megjithëse një organ i pavarur ka të ngjarë të jetë pranë një ministrie mbështetëse).
- ✦ Vendndodhja më e mirë pasqyron kushtet politike të vendit. Faktor mund të jetë edhe modeli i financimit.

## 3.3. Drejtimi i brendshëm i OMA-s

Qeverisja e mirë mbështet besimin e publikut në procesin e mbikëqyrjes. Duhet të ekzistojnë sa vijon:

- ✦ Qartësi për rolin e OMA-s, përfshirë mundësinë për t'u marrë me çështjet e drejtimit strategjik, siç janë shqyrtimet e buxhetit dhe të ecurisë.
- ✦ Llogaridhënie përpara dikasterit mbështetës për mënyrën se si shpenzohen fondet dhe për të siguruar që funksioni rregullator të jetë solid dhe të sjellë vlerë kundrejt parasë,
- ✦ Shqyrtim periodik i mënyrës se si funksionon kuadri për të siguruar që vijon të jetë aktual dhe i përditësuar.

Në tabelën e mëposhtme tregohet struktura e drejtimit të brendshëm të OMA-s në vendet krahasuese.

**Këto janë disa nga rrjedhojat kryesore për vendet që krijojnë një SMP të ngjashëm në natyrë me BE-në:**

- ✦ OMA-t ose organet e barasvlershme me to kanë nga 3 deri në 14 anëtarë. Ekziston një gamë e gjerë formimi e anëtarëve të bordeve, çka pasqyron zhvillimin e auditimit dhe lidhjet e tij me profesione dhe palë të tjera interesi,

**Tabela 3.** Struktura dhe kriteret e organit drejtues

| Vendi            | Përbërja e organit drejtues                      | Nr. i anëtarëve | Kohëzgjatja e mandatit | Shumica e anëtarëve nuk e ushtrojnë profesionin | Objekt i kërkesave të pavarësisë sipas nenit 21 të Rregullores 537/2014 |
|------------------|--------------------------------------------------|-----------------|------------------------|-------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|
| <b>Austria</b>   | Këshilli i Administrimit dhe Këshilli Mbikëqyrës | 6               | 5 vjet                 | po                                              | po                                                                      |
| <b>Greqia</b>    | Këshilli i Administrimit                         | 5               | 3 vjet                 | po                                              | po                                                                      |
| <b>Irlanda</b>   | Këshilli i Administrimit                         | 9               | n/a                    | po                                              | po                                                                      |
| <b>Lituania</b>  | Komiteti i Mbikëqyrjes së Auditimit              | 7               | n/a                    | po                                              | po                                                                      |
| <b>Polonia</b>   | Këshilli                                         | 10              | 4 vjet                 | po                                              | po                                                                      |
| <b>Sllovenia</b> | Këshilli i Ekspertëve                            | 9               | 6 vjet                 | po                                              | po                                                                      |

■ I vogël ■ I vogël / I mesëm ■ I mesëm ■ I madh

<sup>31</sup> Banka Botërore. 2017. Public Oversight Systems for Statutory Audit in the EU (Sistemet e mbikëqyrjes publike të auditimit ligjor në BE).

p.sh. investitorët, donatorët dhe madje edhe sektorin publik brenda secilit vend.

- ✦ Nuk ka një model të vetëm të praktikës më të mirë. Megjithatë, kërkesa e BE-së për një raport publik vjetor mbulon transparencën e nevojshme. Krahas kësaj, profilet e anëtarëve në faqen e internetit të IFIAR-it për OMA-t anëtare të IFIAR-it ofrojnë të dhëna gjithanshme në dispozicion të publikut në lidhje me drejtimin e brendshëm të OMA-ve.

### 3.4. Burimet dhe financimi

Neni 32, pika 7, i Direktivës së BE-së për Auditimin thotë se:

*“Sistemi i mbikëqyrjes publike ka fonde dhe burime adekuate [...]. Fondet e sistemit të mbikëqyrjes publike janë të sigurta dhe të çliruara nga çdo ndikim i parregullt nga ana e audituesve ligjorë ose shoqërive të auditimit”.*

OMA-t duhet të mendojnë nivelin e burimeve (kapacitetin dhe aftësitë) që u nevojiten për të qenë në gjendje të bëjnë mbikëqyrje efektive. Lypsen identifikuar kërkesat aktuale dhe të ardhshme për aftësi. Politikat dhe proceset e burimeve njerëzore janë thelbësore për të siguruar pagë të përshtatshme, rekrutim efektiv dhe mbajtje të personelit.

Me rëndësi është që OMA-t të punojnë me politikëbërësit për t'u siguruar që të ketë fonde të

mjaftueshme për të qenë në gjendje të punojnë në mënyrë efikase dhe efektive. Është e rëndësishme të kenë drejtues të kualifikuar dhe me përvojë të përshtatshme që e drejtojnë organizatën nga lart poshtë.

Shpesh, OMA duhet të justifikojë kërkesën për buxhet para qeverisë ose ministrisë mbështetëse. Ky justifikim mund të realizohet përmes:

- ✦ Kryerjes së një analize të punës nga ana e personelit të OMA-s, për të arritur qëllimet dhe objektivat dhe, krahas kësaj, përmes identifikimit të aftësive dhe burimeve të nevojshme për ta kryer këtë punë me efektivitet.
- ✦ Kryerjes së një analize të boshllëqeve (që përfshin kapacitetin dhe aftësitë) për detyrat kryesore të OMA-s. Kjo do të analizonte njohuritë dhe aftësitë e personelit aktual dhe do të vlerësonte aftësitë shtesë të nevojshme që i duhen OMA-s për të përmbushur pritjet në të gjitha fushat, pra në kontrollin e cilësisë dhe inspektimet, raportimin, disiplinën dhe zbatimin me forcë, si dhe në raportimin publik.

Informacioni i disponueshëm publikisht për organikën e OMA-ve (numri, funksionet dhe pagat e punonjësve) është përgjithësisht i kufizuar. Burimet në dispozicion ndryshojnë në varësi, fjala vjen, të madhësisë së vendit dhe të niveleve mbizotëruese të pagave. Informacionet e mëposhtme gjenden publikisht dhe lehtësisht - duket se kjo tregon se numri i inspektorëve të kontrollit të cilësisë nga 4 në 12:

**Tabela 4.** Numri i personelit në OMA

| Vendi                                                          | Austria                                                                                                                                                                                                                                                    | Estonia                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Greqia                                           | Irlanda       |
|----------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|---------------|
| <b>Numri i punonjësve (përfshirë punonjësit profesionistë)</b> | 8,7 ekuivalentë punonjës me orar të plotë. Inspektimet dhe hetimet me inspektorë me orar të plotë – 4 punonjës. Çështjet juridike, marrëdhëniet me jashtë dhe kontrolli i cilësisë – 3 punonjës. Administrative 1,7 Ekuivalentë punonjës me orar të plotë. | 4 specialistë të kontrollit të cilësisë dhe 1 administrator                                                                                                                                                                                                                                           | n/a                                              | 12 inspektorë |
| Vendi                                                          | Letonia                                                                                                                                                                                                                                                    | Lituania                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Sllovenia                                        |               |
| <b>Numri i punonjësve (përfshirë punonjësit profesionistë)</b> | n/a                                                                                                                                                                                                                                                        | 49 punonjës gjithsej. Cilësia e auditimit – 7 punonjës. Drejtoria e Licencimit – 5 punonjës. Drejtoria Juridike – 4 punonjës. Vlerësimi i kontrollit të cilësisë – 4 punonjës, Llogaridhënia për Qëndrueshmërinë – 1 punonjës. 28 punonjës në fusha të tjera që nuk lidhen me mbikëqyrjen e auditimit | 9 punonjës në fund të vitit 2023 - buxhet për 11 |               |

■ I vogël

■ I vogël / I mesëm

■ I mesëm

■ I madh

### Këto janë disa nga rrjedhojat kryesore për vendet që krijojnë një SMP të ngjashëm në natyrë me BE-në:

- ✦ OMA-t duhet të kenë burimet dhe fondet e nevojshme për të kryer detyrat sipas legjislacionit përkatës.
- ✦ Në tregjet më pak të zhvilluara nuk gjen gjithmonë punonjës të kualifikuar dhe me përvojën e duhur.
- ✦ Arsytimi i kërkesave për fonde përbën gjithmonë sfidë për OMA-t. OMA-t aspiruese mund të bëjnë diskutime dypalëshe për të marrë informacione të krahasueshme për burimet, në mbështetje të kërkesave për fonde.

auditimesh ligjore, shoqërisht auditimi dhe audituesish të regjistruar. Zakonisht OMA-t mund t'ia delegojnë funksionet organit vendor të profesionit kontabël ose të auditimit, për shembull për kontrollin e cilësisë së auditimeve të njësive ekonomike pa interes publik. Në disa raste, një delegim i tillë mund të ndihmojë kur ka fonde shumë të kufizuara në dispozicion, duke ndarë një pjesë të barrës së burimeve me organizatat të cilave u delegohen funksionet.

Analiza e vendeve krahasuese tregon se më së shpeshti delegohen arsimit dhe AVP-ja. Ndonjëherë, por jo gjithmonë, delegohet inspektimi i audituesve të njësive ekonomike pa interes publik dhe regjistrimi i audituesve. Në një rast, nuk ka delegim të funksioneve. Tabela e mëposhtme ilustron gamën në të gjitha vendet krahasuese (profilet e SMP-ve në Shtetet Anëtare krahasuese të BE-së jepen në **Shtojcën 2**).

## 3.5. Delegimi i detyrave

Siç parashikohet në nenin 32, pika 4, shkronja “b”, të Direktivës për Auditimin, OMA-t mund të delegojnë disa funksione, rast pas rasti, me kusht që të mbajnë përgjegjësinë e fundme dhe të mund ta rimarrin funksionin.

Megjithatë, Rregullorja për Auditimin thotë se disa funksione të lidhura me auditimet e NJEIP-ve nuk mund të delegohen, përfshirë edhe kontrollin e cilësisë së audituesve të NJEIP-ve.

Në përgjithësi, delegimi i funksioneve ndodh në vende më të mëdha të BE-së, ku ka një numër të madh

### Këto janë disa nga rrjedhojat kryesore për vendet që krijojnë një SMP të ngjashëm në natyrë me BE-në:

- ✦ Delegimi mund të vlejë kur fondet janë të kufizuara, pasi ndan barrën e burimeve.
- ✦ Nuk ka konsensus nëse duhen deleguar dhe cilat funksione të delegohen.
- ✦ Kur është e mundur, legjislacioni është mirë të përcaktojë qartë bazën për delegim, si p.sh. duke e bërë të qartë se përgjegjësia përfundimtare i mbetet OMA-s dhe duke parashikuar mekanizmin që OMA të rimarrë funksionet e deleguara rast pas rasti.

**Tabela 5.** Funksionet e OMA-s që i delegohen një organi tjetër

| Vendi                                              | Austria                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | Estonia                                                                               | Greqia                                                                                                             | Irlanda                                                                                                                                                          |
|----------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Funksionet që i delegohen një organi tjetër</b> | Vendosja e standardeve të auditimit dhe etikës, arsimit/ AVP dhe inspektimi i audituesve që nuk auditojnë NJEIP i është deleguar Dhomës Austriake të Kontabilitetëve Publikë dhe Këshilltarëve Fiskalë.                                                                                                                                                                                                  | Arsimi i vazhdueshëm profesional i është deleguar Shoqatës së Audituesve të Estonisë. | Inspektimet e cilësisë së audituesve të njësive ekonomike pa interes publik dhe disa licencime, arsimit dhe AVP-ja | Auditimet e njësive ekonomike pa interes publik, inspektohen nga organet e njohura të kontabilitetit. Janë deleguar edhe licencimi, regjistrimi dhe arsimit/AVP. |
| Vendi                                              | Letonia                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                       | Lituania                                                                                                           | Sllovenia                                                                                                                                                        |
| <b>Funksionet që i delegohen një organi tjetër</b> | i. Arsimi fillestar profesional, provimi dhe AVP-ja; ii. licencat dhe regjistrimi i audituesve, objekt i mbikëqyrjes dhe miratimit të Sektorit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Auditimit të Shoqërive Tregtare; iii. regjistrimi i audituesve të vendeve të treta; iv. shqyrtimet e kontrollit të cilësisë dhe procedurat hetimore dhe disiplinore për auditimet e njësive ekonomike pa interes publik. |                                                                                       | Licencimi, regjistrimi, AVP                                                                                        | Nuk ka, APOA ka detyrën drejtpërdrejt për licencimin, regjistrimin, auditimin/etikën, arsimin/ AVP-në, inspektimin dhe zbatimin me forcë.                        |

■ I vogël ■ I vogël / I mesëm ■ I mesëm ■ I madh



## Sistemet e mbikëqyrjes publike në vendet e Ballkanit Perëndimor

### 4.1. Ecuria e ngritjes së sistemeve të mbikëqyrjes publike

**Shqipëria** ka përparuar shumë në krijimin e një SMP-je, me mbështetjen e Bankës Botërore dhe me asistencë tjetër teknike. Nuk është për t'u habitur, ngaqë Shqipëria ka përfituar nga programet ndërkombëtare, kryesisht në kuadër të programeve të financuara nga Banka Botërore me fonde shumë të konsiderueshme. Organi i mbikëqyrjes së auditimit (OMA) i Shqipërisë, Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP), ka kryer gjashtë cikle inspektimesh të shoqërive të auditimit të NJEIP-ve dhe po ecën përpara me ciklin e shtatë. Ky Bord ka një metodologji të avancuar inspektimi në pasqyrim të praktikave më të mira ndërkombëtare, të hartuar gjatë programeve të asistencës dhe të përmirësuara më tej mbështetur në kapacitetet e veta dhe përvojën praktike të mbikëqyrjes. Praktika e ngritur për inspektimin përfshin raportimin e gjetjeve tek audituesit me anë të një raporti inspektimi të sigurimit të cilësisë,

miratimin e një plan-veprimi me masa korrigjuese për t'u dhënë zgjidhje mangësive dhe detyrimin për një raport periodik mbi zbatimin e masave korrigjuese të miratuara. Shqipëria është prej kohësh anëtare e IFIAR-it dhe dy vitet e fundit ka qenë shumë aktive në grupet e punës të IFIAR-it dhe në seminarët e inspektimit të IFIAR-it. Sistemet e hetimit dhe sanksionimit janë funksionale dhe efektive. Ndryshimet e fundit të ligjit të auditimit kanë vendosur sanksione të forta, por proporcionale, për të fuqizuar masat shtrënguese. BMP i Shqipërisë përballlet me disa sfida: përmirësimi i cilësisë së auditimit përmes një procesi inspektimi efektiv është një proces i vazhdueshëm, i njëjtë për të gjitha OMA-t në mbarë botën. Mund të bëhet sigurisht më shumë me më shumë burime dhe me kompetencë të mjaftueshme shtrënguese. Si përfundim, Shqipëria është një shembull për t'u ndjekur nga të tjerët, megjithëse ka marrë ndihmë të konsiderueshme nga një projekt i dedikuar vetëm Shqipërisë.

Sistemi i mbikëqyrjes i **Serbisë** është po kështu i përparuar, sërish me mbështetje të asistencës teknike të Bankës Botërore. Serbia ka përfunduar inspektimin

e shoqërive kryesore të auditimit të NJEIP-ve dhe ka bërë ndjekje në vijimësi të gjetjeve të inspektimit me anë të inspektimeve të mëpasshme. Ky vend ka një metodologji inspektimi auditimi me standarde ndërkombëtare, të mbështetur në metodologjinë e inspektimit të përdorur nga rregullatori francez. Sistemi i hetimit dhe sanksioneve është funksional dhe ka ndjekur një numër rastesh. Si edhe Shqipëria, Serbia përballat me sfida për përmirësimin e inspektimeve, marrjen e më shumë burimeve dhe ndoshta rritjen e mundësive dhe niveleve të sanksioneve.

**Mali i Zi** është vend relativisht i përparuar sa i takon ngritjes së SMP-së. Ky vend ka udhëheqje dhe mbështetje të fortë nga qeveria dhe ka emëruar dy inspektorë, me dy të tjerë të parashikuar në buxhet dhe në plan të rekrutohen në periudhën afatshkurtër. Kanë filluar inspektimet e firmave të auditimit, me metodologjinë e inspektimit sipas standardeve ndërkombëtare, të ofruar në kuadër të programit REPARIS për NVM-të. Janë inspektuar një sërë audituesish të NJEIP-ve dhe të njësive ekonomike pa interes publike dhe po zhvillohet procesi i diskutimit të gjetjeve pas inspektimeve. Ky është një fillim i mirë, por ka ende sfida: marrja në punë e punonjësve të duhur është e vështirë dhe procesi i inspektimit është në zhvillim e sipër tani që po bëhet faza e parë e inspektimeve. Me mbështetjen e vazhdueshme të ekspertëve të huaj, programi mund të konsolidohet në periudhën afatshkurtër dhe progresi të vazhdojë.

Në **Bosnjë-Hercegovinë** janë ngritur në të tre juridiksionet përbërëse SMP-të. Në vlerësimin e fundit të përputhshmërisë, BE-ja vuri në dukje se ligji i BE-së kërkon që të caktohet një autoritet kompetent në çdo shtet anëtar. Sfida kryesore për Bosnjë-Hercegovinën është ngritja e një autoriteti unik për mbikëqyrjen e auditimit në të gjithë vendin. Kohët e fundit është zhvilluar një konferencë në kuadër të programit REPARIS për NVM-të për të diskutuar për se si të realizohet kjo. Republika Serbe ka ndërmarrë hapa për të filluar inspektimet e auditimit. Është emëruar një punonjës dhe ka përfunduar një analizë të tregut të auditimit si pararendës për fillimin e një procesi inspektimi. Inspektimet do të përdorin metodologjitë e gatshme ndërkombëtare. Federata e Bosnjë-Hercegovinës ende nuk ka krijuar një program të pavarur inspektimi të audituesve të NJEIP-ve; inspektimet ende i delegohen Odës së Audituesve.

Ngritja e këtij programi është sfida kryesore për OMA-n. Vështirësia e marrjes së burimeve të mjaftueshme është ndoshta pengesa më e madhe. Këshilli për Kontabilitetin dhe Auditimin në Distriktin e Bërçkës i ka ngarkuar një punonjësi detyrën e kontrollit të cilësisë së auditimit, por ende nuk janë ndërmarrë inspektime.

**Kosova** ka filluar fazën e parë të inspektimeve të audituesve të NJEIP-ve, me mbështetje të konsiderueshme nga programi REPARIS për NVM-të. Është ndërmarrë faza e parë e inspektimeve për shoqëritë më të mëdha ndërkombëtare të auditimit dhe ka pasur disa veprimtari pasuese. Por Kosovës ende i mungon ekipi i dedikuar i inspektimit. Marrja e fondeve të mjaftueshme për gjetjen dhe mbajtjen në punë të inspektorëve të pavarur me kualifikimet e duhura është sfida më e rëndësishme për Këshillin e Kosovës për Raportim Financiar.

**Maqedonia e Veriut** nuk ka filluar ende një program inspektimi. Megjithatë është ngritur dhe është funksional Këshilli për Avancimin dhe Mbikëqyrjen e Auditimit (KAMA), inspektimet bëhen vetëm nga organizata profesionale. Marrja në punë e inspektorëve të përshtatshëm dhe fillimi i veprimtarisë së kontrollit të cilësisë së auditimit për së paku audituesit e NJEIP-ve është hapi tjetër i nevojshëm për të ecur drejt përputhshmërisë me kuadrin legjislativ të BE-së.

**Si përfundim**, janë bërë një gamë e gjerë përparimesh për ngritjen e SMP-ve që përputhen me kuadrin legjislativ të BE-së. Udhëheqja dhe mbështetja efektive nga organizatat dhe ekspertët ndërkombëtarë kanë sjellë progres solid në Shqipëri dhe në Serbi, ku OMA-t janë plotësisht funksionale dhe mund të pretendojnë një nivel të lartë përputhshmërie me kërkesat e BE-së. Të dy këto vende ofrojnë shembuj të praktikave të mira për vendet e tjera me SMP më pak të përparuara. Mali i Zi ka bërë progres në ndjekjen e shembullit të tyre. Shtetet e tjera janë ende në fazat e hershme të ngritjes së programeve të inspektimit. Sfida të mëdha vijnë të jenë kufizimet në burime dhe ruajtja e mbështetjes së fortë politike. Në Shtojcën 3 jepen profile të hollësishme të sistemeve të mbikëqyrjes publike në secilin prej vendeve të Ballkanit Perëndimor. Disa nga karakteristikat kryesore jepen në formë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme.



Tabela 6. Karakteristikat për vendet e Ballkanit Perëndimor

| Shqipëria                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Federata e Bosnjë-<br>Hercegovinës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Republika<br>Serbe - Bosnjë-<br>Hercegovina                                                                                                                                                                                                                   | Distrikti i<br>Bërçkës - Bosnjë-<br>Hercegovina                                                                                                                                        | Kosova                                                                                                | Mali i Zi                                                                            | Maqedonia e Veriut                                                                                                             | Serbia                                                                                                                                                                                    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Dikasteri përgjegjës për SMP-në                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                        |                                                                                                       |                                                                                      |                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                           |
| Autoritet i pavarur<br>rregullator <sup>32</sup>                                                                                                                                                                                                                                                                                 | Ministria e Financave                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | Ministria e Financave                                                                                                                                                                                                                                         | Drejtoria e<br>Financave                                                                                                                                                               | Ministria e Financave,<br>Punës dhe Dërgesave                                                         | Ministria e Financave                                                                | Ministria e Financave                                                                                                          | Komisioni i Letrave me<br>Vlerë                                                                                                                                                           |
| Legjislacioni përkatës                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                        |                                                                                                       |                                                                                      |                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                           |
| Ligji Nr. 10 091, datë<br>5.3.2009 "Për auditimin<br>ligjor, organizimin e<br>profesionit të audituesit<br>ligjor dhe të kontabilistit<br>të miratuar", i ndryshuar<br>në prill 2016 me Ligjin Nr.<br>47/2016 dhe në dhjetor<br>2024 me Ligjin Nr. 126/2024.<br>Vendim nr. 786/2016 i<br>Këshillit të Ministrave, i<br>ndryshuar | Vendim i Qeverisë së Federatës<br>së Bosnjë-Hercegovinës,<br>nr. V.1163/2022, datë 28<br>korrik 2022. (Fletorja Zyrtare<br>e Federatës së Bosnjë-<br>Hercegovinës, numri: 61/22).<br>Ligji për Kontabilitetin dhe<br>Auditimin (Fletorja Zyrtare e<br>Bosnjë-Hercegovinës, numri<br>42/04).<br>Ligji për Kontabilitetin dhe<br>Auditimin në Federatën e<br>Bosnjë-Hercegovinës (Fletorja<br>Zyrtare e Federatës BH, numri<br>15/21). | Ligji për<br>Kontabilitetin<br>dhe Auditimin të<br>Republikës Serbe<br>(Fletorja Zyrtare e<br>Republikës Serbe,<br>numri 94/15, 78/20)<br><br>Udhëzim për<br>kryerjen e<br>mbikëqyrjes (Fletorja<br>Zyrtare e Republika<br>Serbe 3/25, date 17<br>janar 2025) | Ligji për<br>Drejtorinë<br>e Financave<br>të Distriktit<br>të Bërçkës<br>të Bosnjë-<br>Hercegovinës<br><br>Ligji për<br>Kontabilitetin<br>dhe Auditimin<br>të Distriktit të<br>Bërçkës | Ligji nr. 06/L-032 për<br>kontabilitet, raportim<br>financiar dhe auditim,<br>në fuqi prej vitit 2019 | Ligji i vitit 2017 për<br>Auditimin (Fletorja<br>Zyrtare e Malit të Zi nr.<br>01/17) | Ligji i Auditimit i<br>Maqedonisë së Veriut<br>(Fletorja Zyrtare<br>e Republikës së<br>Maqedonisë së Veriut<br>nr. 122/21)     | Ligji për Auditimin<br>(Fletorja Zyrtare 73/2019)<br>dhe Ligji për Tregun e<br>Kapitalit (Fletorja Zyrtare<br>129/2021)                                                                   |
| Emërtimi i organit të mbikëqyrjes publike                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                        |                                                                                                       |                                                                                      |                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                           |
| Bordi i Mbikëqyrjes Publike                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Komiteti i Mbikëqyrjes Publike<br>të Auditimit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Këshilli për<br>Kontabilitetin dhe<br>Auditimin në RS                                                                                                                                                                                                         | Këshilli për<br>Kontabilitetin<br>dhe Auditimin<br>në Distriktin e<br>Bërçkës                                                                                                          | Bordi i Mbikëqyrjes<br>Publike të Kosovës, nën<br>mbikëqyrjen e Këshillit<br>për Raportim Financiar   | Këshilli i Auditimit,<br>Departamenti për<br>Mbikëqyrjen e<br>Auditimit              | Këshilli i Maqedonisë<br>së Veriut për<br>Avancimin dhe<br>Mbikëqyrjen e<br>Auditimit (CAOAC)                                  | Komiteti i Mbikëqyrjes<br>Publike të Auditimit                                                                                                                                            |
| Nr. i anëtarëve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                        |                                                                                                       |                                                                                      |                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                           |
| 5                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 5                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | 5                                                                                                                                                                                                                                                             | 7                                                                                                                                                                                      | 5                                                                                                     | 5                                                                                    | 7                                                                                                                              | 7                                                                                                                                                                                         |
| Burimi i financimit                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                                                        |                                                                                                       |                                                                                      |                                                                                                                                |                                                                                                                                                                                           |
| 3% nga tarifat e auditimit<br>të NJEIP-ve, fondet nga<br>kontributet e OPK-ve,<br>grantet e shpërndara për<br>funksionin e kontrollit të<br>cilësive dhe mbikëqyrjes,<br>buxheti i shtetit.                                                                                                                                      | Buxheti i Shtetit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Buxheti i Shtetit                                                                                                                                                                                                                                             | Buxheti i Shtetit                                                                                                                                                                      | Buxheti i Shtetit                                                                                     | Buxheti i Shtetit                                                                    | Buxheti i Shtetit,<br>taksa mbi shoqëritë<br>e regjistruara të<br>auditimit dhe<br>audituesit e autorizuar<br>– persona fizikë | 1) Kontribut specifik nga<br>audituesit për kryerjen e<br>shqyrtimit të cilësive të<br>praktikës së shoqërive<br>të auditimit; 2) Tarifa<br>nga burime të tjera në<br>përputhje me Ligjin |

<sup>32</sup> Anëtarët e Bordit të emëruar nga ministri i financave, duke përfshirë propozimet nga institucionet e arsimit të lartë dhe komisioni parlamentar përgjegjës për ekonominë dhe financat



| Shqipëria                                                                                                                                                                                                                                                    | Federata e Bosnjë-<br>Hercegovinës                                                                                 | Republika<br>Serbe - Bosnjë-<br>Hercegovina                                                                             | Distrikti i<br>Bërrçkës - Bosnjë-<br>Hercegovina                           | Kosova                                             | Mali i Zi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Maqedonia e Veriut                                                                                                                                                                      | Serbia                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Functions delegated to another body                                                                                                                                                                                                                          |                                                                                                                    |                                                                                                                         |                                                                            |                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Inspektimet për njësitë ekonomike pa interes publik i delegohen organizatës profesionale të audituesve ligjorë - IEKA. IEKA-s i është deleguar edhe përkthimi i SNA-ve, kodit të etikës të IESBA-s dhe standardeve ndërkombëtare të angazhimeve të sigurisë. | Inspektimi i shoqërive të auditimit i është deleguar Dhomës së Audituesve të Federatës së Bosnjë-<br>Hercegovinës. | Certifikimi i audituesve kryhet nga shoqata profesionale - Shoqata e Kontabilistëve dhe Audituesve të Republikës Serbe. | Nuk delegohen funksionet mbikëqyrëse të auditimit                          | Nuk delegohen funksionet mbikëqyrëse të auditimit. | Përgjegjësia për zbatimin e programit të arsimit të vazhdueshëm për audituesit ligjorë (të përcaktuar nga Ministria e Financave) i delegohet Institutit të Kontabilistëve të Miratuar. IKM përgatit programin e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (ZHPV); shqyrtohet nga Këshilli i Auditimit me mendim dhe miratohet nga Ministria e Financave. | Inspektimet kryhen nga organizata profesionale, Instituti i Audituesve të Autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, brenda kompetencave të përcaktuara nga Ligji për Auditimin. | Funksionet e deleguara Dhomës së Audituesve të Autorizuar të Serbisë përfshijnë: Provimet e audituesve të autorizuar; zhvillimin e vazhduar profesional; licencimin e audituesve të autorizuar dhe i shoqërive të auditimit; zbatimin e SNA-ve dhe Kodit të Etikës për audituesit. |
| Numri i punonjësve (përfshirë punonjësit profesionistë)                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                    |                                                                                                                         |                                                                            |                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 1 Drejtor Ekzekutiv, 3 Inspektorë të lartë të kontrollit të cilësisë, 1 Specialist i Çështjeve Juridike, 2 specialistë për financën dhe administratën.                                                                                                       | n/a                                                                                                                | 3                                                                                                                       | 1 punonjës i emëruar me përgjegjësi për kontrollin e cilësise së auditimit | Asnjë në datën e raportimit                        | 3 punonjës, përfshirë Drejtorin Ekzekutiv dhe 2 inspektorë. Planifikohen edhe 2 inspektorë të tjerë                                                                                                                                                                                                                                                  | 7 punonjës në shërbimin profesional të Këshillit                                                                                                                                        | n/a                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Numri i audituesve                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                    |                                                                                                                         |                                                                            |                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 71 shoqëri auditimi dhe 143 auditues praktikues individë, 26 auditues të punësuar në shoqëri auditimi                                                                                                                                                        | 85 shoqëri auditimi                                                                                                | 38 shoqëri auditimi                                                                                                     | 21 shoqëri auditimi                                                        | 24 shoqëri auditimi dhe 69 auditues të licencuar   | 31 shoqëri auditimi dhe 108 auditues ligjorë                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | 265 auditues të autorizuar, 29 shoqëri auditimi dhe 14 auditues të autorizuar persona fizikë                                                                                            | 77 shoqëri auditimi                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Numri i auditimeve ligjore                                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                    |                                                                                                                         |                                                                            |                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 3 784                                                                                                                                                                                                                                                        | 2 777                                                                                                              | 1 090                                                                                                                   | n/a                                                                        | 725                                                | afro 550                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | n/a                                                                                                                                                                                     | 5 999                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Numri i shoqërive të auditimit të NJEIP-ve                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                                    |                                                                                                                         |                                                                            |                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 62                                                                                                                                                                                                                                                           | n/a                                                                                                                | 270                                                                                                                     | 21                                                                         | 12-16                                              | 20                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 270                                                                                                                                                                                     | 27                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Numri i auditimeve ligjore të NJEIP-ve                                                                                                                                                                                                                       |                                                                                                                    |                                                                                                                         |                                                                            |                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| 1 006                                                                                                                                                                                                                                                        | 470                                                                                                                | 490                                                                                                                     | n/a                                                                        | 313                                                | n/a                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 200                                                                                                                                                                                     | n/a                                                                                                                                                                                                                                                                                |

I vogël



I vogël / I mesëm



I mesëm



I madh



## Sfida të përbashkëta dhe zgjidhje të sugjeruara në vënien në zbatim të SMP-ve në BE

Shumë organe publike të auditimit europian kanë hasur sfida të ngjashme në ngritjen dhe zbatimin e mbikëqyrjes së auditimit. Disa prej tyre përshkruhen më poshtë, së bashku me zgjidhjet e zbatuara nga OMA-t.

### 5.1. Emërimi i anëtarëve të bordit

Një sfidë e konsiderueshme mund të jetë emërimi i anëtarëve të bordit. Neni 32, pika 3, i Direktivës së BE-së për auditimin thotë:

*“Organi kompetent drejtohen nga persona të cilët nuk e ushtrojnë profesionin e të cilët kanë njohuri në fushat e lidhura me auditimin ligjor.”*

Neni 29, shkronja “a”, thotë:

*“sistemi i sigurimit të cilësisë organizohet në mënyrë që të jetë i pavarur nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të shqyrtuara”.*

Në tërësi, kjo çon në një problem të mundshëm: drejtimi dhe personeli i OMA-s duhet të kenë njohuri në fushat përkatëse të auditimit, gjithë duke qenë të pavarur nga profesioni. Kjo mund të jetë e vështirë për t’u arritur në praktikë. Individët më të ditur në lidhje me auditimin janë ata që kanë punuar si auditues në vend në nivelin më të lartë. Megjithatë, individë të tillë kanë shumë probleme faktike dhe të mundshme lidhur me pavarësinë. Ka të ngjarë të njohin shumë auditues dhe shoqëri auditimi që janë objekt inspektimi, sidomos në vende të vogla. Ka të ngjarë që ata të kenë punuar për një ose më shumë shoqëri auditimi në vend. Mund të kenë pension që lidhet me një shoqëri auditimi.

Pavarësia e plotë mund të vijë me një sasi të kufizuar dijesh. Një jurist ose rregullator mund të ketë përvojë të thellë tregtare, por mund të mos i njohë në thellësi SNA-të. Drejtimi i brendshëm i OMA-ve kërkon shqyrtimin e çështjeve komplekse të auditimit. Të paktën disa anëtarë të Bordit kanë nevojë për

përvojë dhe kompetencë për t'u bërë ballë sfidave nga audituesit me përvojë dhe kompetentë.

IFIAR e njihte këtë problem gjatë hartimit të parimeve bazë për organizatat anëtare. Disa anëtarë propozuan të formulohej një parim i tillë që “të shmangen të gjitha konfliktet e interesit”, por u ra dakord të thuhej se duhen shmangur të gjitha konfliktet me rëndësi materiale, duke pranuar që në mënyrë të pashmangshme do të mbeteshin disa konflikte.

Zgjidhjet në praktikë pothuajse gjithmonë përfshijnë njëfarë ndërthurjeje midis aftësisë dhe pavarësisë. Zgjidhja optimale ka të ngjarë të përfshijë emërimin e një gërshetimi të ekuilibruar audituesish me përvojë që nuk e ushtrojnë profesionin, pas një “periudhe të përshtatshme pushimi” (pa ushtruar profesionin për shembull tre ose pesë vjet) së bashku me një shumicë profesionistësh të aftë, rregullatorë dhe të tjerë me më pak lidhje me audituesit ose shoqëritë e auditimit, siç janë rregullatorët, juristët, nëpunësit civilë etj.

## 5.2. Emërimi (dhe mbajtja) e personelit

Sfida të ngjashme mund të ketë në lidhje edhe me personelin. Në disa tregje mund të jetë shumë e vështirë, në mos e pamundur, të gjejsh inspektorë me aftësi dhe përvojë të mjaftueshme për t'u përballur siç duhet me audituesit e niveleve të larta, duke qenë ndërkohë të pavarur dhe pa konflikte të mundshme interesi. Ky është problem sidomos në tregjet e vogla kombëtare të auditimit, paçka se ekziston edhe në tregjet e mëdha. Për shembull, nevojiten ortakë auditimi ose drejtues të lartë për të inspektuar auditime komplekse dhe për të kundërshtuar gjykimet e auditimit të bëra nga ortakët të lartë të auditimit të shoqërive të rrjeteve ndërkombëtare. Inspektorë të mundshëm të këtij kalibri shpesh punojnë në një ose dy shoqëri të rrjeteve ndërkombëtare në vend dhe si rezultat kanë konflikte të mundshme interesi. Këto konflikte mund të zbuten deri në një farë mase kur inspektori nuk inspekton shoqëritë e veta deri pas një periudhe pushimi, por konflikti mbetet deri në një farë mase, sidomos në vendet e vogla.

Zgjidhjet përfshijnë nivele të shqyrtimit të dosjeve të inspektimit, rezultateve dhe gjetjeve, në mënyrë që në finalizimin e çdo inspektimi të përfshihet më shumë se një punonjës. Ky shqyrtim i kryqëzuar zbatohet edhe në ekipe të vogla inspektimi të auditimit me vetëm 2-3 punonjës. Zgjidhje të tjera përfshijnë administrim me kujdes të programit të inspektimit në mënyrë që personeli të mos ketë nevojë të inspektojë shoqëritë për të cilat ka punuar. Edhe pse është e nevojshme të kihet besim në paprekshmërinë e inspektorëve të lartë, masa të tilla mbrojtëse ndihmojnë për të siguruar një dëshmim më të qartë të pavarësisë.

## 5.3. Nivelet e pagave për punonjësit më të mirë

Një vështirësi për të gjithë është ofrimi i pagave ose paketave të shpërblimit të mjaftueshme për të tërhequr dhe mbajtur personel me përvojë. Ky mund të jetë komponenti unik më i madh i financimit ku inspektimet janë fokusi kryesor i një OMA-je, që mund të jetë edhe e vërtetë. Siç është përmend tashmë, mund të nevojiten inspektorë të barasvlershëm me punonjësit e nivelit të lartë që inspektohen, për të kundërshtuar me efektivitet gjykimet kryesore të auditimit. Punonjës të tillë mund të duan paga tregu, që mund të jenë jashtë mundësive financiare të OMA-s. Krahas kësaj, kur inspektorët janë pjesë e një dikasteri, personeli është objekt i shkallëve të pagave të shërbimit civil të cilat mund të jenë shumë kufizuese.

**Zgjidhjet** lypset të pasqyrojnë kushtet specifike të secilit vend. Krijimi i një pakete të tërë ku paga është vetëm njëri prej elementeve mund të ndihmojë, me një numër të madh ditësh pushim, orar fleksibël dhe të arsyeshëm pune, mund të ndihmojë në përmirësimin e paketës së pagave të nivelit të mesëm, sidomos kur shoqëritë e auditimit kanë orar të gjatë dhe kërkojnë të punohet gjatë fundjavave. Një metodë tjetër është rritja e aftësisë së punonjësve me më pak përvojë me anë të kurseve intensive të formimit. Paketat tërheqëse mund të ndihmojnë edhe për mbajtjen e punonjësve, në qoftë se rikthimi në shoqëritë e auditimit do të sillte ndikim negativ në jetën private, që ia ul vlerën rritjes së pagës.

## 5.4. Inspektimet e vlerësimit

OMA-t mund ta kenë të vështirë të bëjnë një renditje të përgjithshme të shoqërive të auditimit pas inspektimeve, pasi nuk është gjithmonë e lehtë të përcaktohet cilësia e përgjithshme e auditimit brenda një shoqërie. Dhënia e një vlerësimi të vetëm shpesh mund të jetë një thjeshtim i tepruar i gjetjeve të inspektimit. Shkalla deri ku audituesi ndjek SNA-të a standarde të tjera të ngjashme merret si tregues i cilësisë së auditimit, por këto janë standarde të bazuara në parime dhe kërkojnë një nivel të konsiderueshëm gjykimi për auditimin. Zakonisht janë këto gjykime që përcaktojnë cilësinë e auditimit, sidomos në rastin e auditimeve komplekse. Për shembull, SNA 500 kërkon që të merren dëshmi të mjaftueshme auditimi për të mbështetur opinionin e auditimit – por është çështje gjykimi si për audituesin ashtu edhe për inspektorin e auditimit se sa dëshmi janë të mjaftueshme.

Standardet e auditimit mbivendosen dhe disa prej tyre kanë më shumë ndikim në sigurinë dhe justifikimin e opinionit të auditimit se të tjerat. Numri i shkeljeve të standardeve të veçanta të auditimit përdoret shpesh nga OMA-t në Europë për të nxjerrë një vlerësim, si për dosjet e veçanta të auditimit ashtu edhe për vlerësimet globale të shoqërive të auditimit. Një arsye është se ndihmon sa u takon konflikteve të mëpasshme dhe ndjekjen penale të pasojave për cilësinë e dobët të auditimit. Megjithatë, ekziston mundësia që të mund të ndiqen shumica e standardeve të auditimit, por që një gjykim i rëndësishëm dhe i papërshtatshëm auditimi të mund ta zhvlerësojë auditimin dhe automatikisht kjo duhet të marrë vlerësim më të ulët, si në rastet kur lind një problem pavarësie ose kur nuk evidentohet një tepricë e rëndësishme bankare. Inspektori duhet të jetë në gjendje të përdorë përvojën dhe gjykimin e tij për analizuar shkallën dhe ndikimin e një shkeljeje standardi, jo vetëm të gjejë numrin e standardeve me shkelje.

Po kështu, mund të jetë e vështirë të “mbledhësh” notat nga secili vlerësim dosjeje auditimi për të dhënë një vlerësim total për shoqërinë e auditimit, sidomos kur vlerësohet më shumë se një ortak auditimi. Një mesatare e thjeshtë e vlerësimeve të dosjeve mund të

shpërfillë rreziqe të konsiderueshme për shoqëritë e audituara nga një auditues me cilësi të dobët.

**Zgjidhjet** mund të përfshijnë ndjekjen e një qasjeje jo të ngurtë nga OMA të për vlerësimin e inspektimeve të auditimit brenda karakteristikave të veçanta ligjore të vendit. Mënyra më e mirë për të vlerësuar cilësinë e auditimit mund të jetë t'i lihet dorë e lirë inspektorit me përvojë të gjykojë cilësinë e të mos numërojë shkeljet, çka mund t'ia kufizonte inspektorit mundësinë për të përdorur instinktin dhe përvojën. Nota e vlerësimit duhet të diskutohet me përgjegjësin e inspektorit ose me një inspektor tjetër për të konfirmuar gjykimin mbi gjetjet.

## 5.5. Konstatimet nga inspektimet e para

Të gjitha OMA-t e ngritura kanë hasur vështirësi shumë të ngjashme në fazat e para të inspektimeve të auditimit. Në shumë raste, në ciklin e parë të inspektimit të shoqërive të auditimit hasen tre lloje audituesish: ata që kryejnë pak ose aspak punë auditimi, ata që përpiqen të bëjnë auditim të mirë, por nuk ia dalin, dhe ata që bëjnë auditim të arsyeshëm ose me standard të lartë, por kanë nevojë për përmirësim.

**Zgjidhjet** për këto gjetje të ndryshme mund të ndryshojnë nga rasti në rast, por kanë shumë karakteristika të përbashkëta në të gjitha OMA-t.

Audituesit të cilët në thelb e shesin opinione auditimi duke bërë pak ose aspak punë, duan një përgjigje të fortë, siç është heqja e licencës me kalim në procedurë disiplinimi të audituesit të përfshirë. Megjithatë, kjo shpesh mund të jetë e vështirë dhe mbështetet fuqimisht në kompetencat sanksionuese të OMA-s në raste të tilla. Shpesh mund të ndodhë që OMA-ve t'u duhet të përdorin procesin ligjor për heqjen e licencës, ose audituesi bën ankesë në gjykatë.

Audituesit që përpiqen të bëjnë auditim të mirë, por nuk ia dalin, kanë nevojë për një përgjigje më të hollë. Qëllimi kryesor i OMA-ve të ngritura është rritja e cilësisë së auditimit, jo rritja e gjobave ose ndëshkimi i audituesve. Gjetjet e auditimeve shumë

të dobëta në ciklin e parë të inspektimit mund të tregojnë që shoqëritë e auditimit nuk kanë një metodologji të gjithanshme auditimi që përputhet me standardet e auditimit. Shpesh këto ndjekin metoda “ad-hoc” dhe kanë nivele të ulëta formimi dhe dijes për standardet. Në raste të tilla, inspektorët duhet të shpjegojnë se çfarë duhet të bëjë shoqëria e auditimit para inspektimit të ardhshëm për të arritur një standard të pranueshëm. OMA-s mund t’i interesojë t’i vendosë disa kushte audituesit për të mbrojtur klientët, ndërkohë që audituesi të bëjë përmirësimet e nevojshme. Për shembull, mund të kërkohej që një shoqëri tjetër auditimi ose organizatë formimi të shqyrtojë auditimin përpara se të nënshkruhet opinioni. Në qoftë se audituesi nuk arrin të përmirësohet mjaftueshëm para inspektimit të ardhshëm, do të duhej të mendoheshin sanksione më të forta.

Audituesve që duhet të përmirësojnë cilësinë e auditimit duhet t’u jepen informacione për përmirësimet e nevojshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë së auditimit e të mos ndëshkohen audituesit me gjyba a vërejtje.

Audituesit që konsiderohen të aftë të përmirësohen duhet të udhëzohen të mësojnë një metodologji auditimi në përputhje me standardet dhe të marrin formim si ta përdorin për të bërë auditim cilësor. Është mirë të ri-inspektohen me cikël të shkurtër për të vlerësuar suksesin e zbatimit të metodologjisë. OMA mund të mendojë vënien në dispozicion të një metodologjie të tillë, me pak ose aspak kosto, në mënyrë që audituesit më të vegjël të mund të konkurrojnë me rrjetet ndërkombëtare të auditimit të cilave metodologjinë ua ofron rrjeti.

## 5.6. Proces ligjor i ngarkuar

Një vështirësi që haset në ngritjen e një procesi efektiv inspektimi të cilësisë së auditimit është kur OMA përballet me proces ligjor të rëndë. Në një rast ideal, rrjedha normale e inspektimeve nuk duhet të kërkojë kontaktin me gjykatat ose procesin ligjor të vendit. Kur fokusi është te përmirësimi i cilësisë së auditimit, kjo bëhet e mundur përmes dialogut efektiv mes rregullatorit dhe audituesve. Nevoja për të përdorur procese thuajse-ligjore ose procese plotësisht ligjore

duhet të lindë vetëm kur ka mosmarrëveshje të rënda mes OMA-s dhe audituesve. Tekefundit, si audituesit, ashtu edhe enti rregullator kanë qëllimin e përbashkët të përmirësimit të cilësisë së auditimit. Kostot dhe vonesat e një procesi të zgjatur ligjor mund të ndikojnë rëndë në efektivitetin dhe efikasitetin e procesit të inspektimit, ngaqë harxhon burime të vyera që mund të përdoren për përmirësimin e cilësisë së auditimit në praktikë.

Fatkeqësisht, kjo nuk është gjithmonë e mundshme. Një ent rregullator i BE-së përballet me një kuadër ligjor relativisht ekstrem brenda vendit, ku rezultati i çdo inspektimi duhet të çohet në gjykatë civile, pavarësisht rezultatit. Për pasojë, edhe inspektimet me pak ose aspak gjetje mund të zgjasin deri në tre vjet për t’u përfunduar dhe inspektimet me rezultate jashtëzakonisht të dobëta mund të duan gjithashtu tre ose më shumë vjet para se publiku dhe shoqëritë tregtare të mbrohen nga auditimi papranueshëm i keq. Një tregues i kostove të skajshme të një barre të tillë ligjore është se enti rregullator detyrohet të punësojë po aq juristë sa edhe inspektorë auditimi. OMA-t në tregjet e reja e kanë të vështirë të marrin personel të mjaftueshëm inspektimi, e lëre më pastaj të kenë po aq avokatë. Megjithatë ekziston nevoja që OMA të ketë njëfarë kompetence ligjore, sidomos kur nevojiten disa sanksione, e në mënyrë ideale kjo do të zinte një pjesë të vogël të burimeve.

**Zgjidhjet** përfshijnë OMA-t që kërkojnë të bashkëpunojnë me audituesit, gjithë duke ruajtur funksionin e duhur të pavarësisë dhe mbikëqyrjes. Rekomandohet që gjetjet e inspektimeve t’u komunikohen qartë audituesve dhe që inspektorët ta bëjnë të qartë se cilat përmirësime nevojiten dhe brenda cilit afat. Prej audituesit do të duhej të pritej të bjerë dakord me gjetjet dhe me masa e nevojshme për të arritur përmirësimet e nevojshme. Kjo qasje bashkëpunuese, por e vendosur, mund të sjellë përmirësime të cilësisë së auditimit pa shkaktuar konflikt me audituesit. Vetëm në raste më të skajshme të një numri të shumtë gjetjesh të konsiderueshme do të nevojitej një proces ligjor ose thuajse ligjor. Shumë OMA kanë një proces ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përpara se të futen në lojë gjykatat. Rekomandohet që këto praktika të mira të jenë të synuara, për aq sa janë të mundshme brenda kuadrit ligjor të vendit.



## Materialet mbështetëse

### Bashkimi European:

- ✦ Rregullorja (BE) nr. 537/2014 e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 16 prill 2014, për kërkesat e veçanta lidhur me auditimin ligjor të njësive ekonomike me interes publik dhe për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit nr. 2005/909/KE<sup>33</sup>

Ndryshuar me:

- DIREKTIVËN (BE) 2022/2464 TË PARLAMENTIT EUROPIAN DHE TË KËSHILLIT, datë 14 dhjetor 2022
- RREGULLOREN (BE) 2023/2869 TË PARLAMENTIT EUROPIAN DHE TË KËSHILLIT, datë 13 dhjetor 2023

- ✦ Direktiva 2006/43/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 17 maj 2006, për auditimet ligjore të pasqyrave financiare vjetore dhe pasqyrave të konsoliduara, ndryshimin e Direktivave të Këshillit

78/660/KEE dhe 83/349/KEE dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 84/253/KEE<sup>34</sup>

Ndryshuar me:

- Direktivën 2008/30/KE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 11 mars 2008
- Direktivën 2013/34/BE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 26 qershor 2013
- Direktivën 2014/56/BE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 16 prill 2014
- Direktivën (BE) 2022/2464 të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 14 dhjetor 2022

### Komisioni European:

- ✦ Studimi mbi Direktivën për Auditimin (Direktiva 2006/43/KE e ndryshuar me Direktivën 2014/56/BE) dhe Rregulloren për Auditimin (Rregullorja (BE) 537/2014)<sup>35</sup>

<sup>33</sup> Shih <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A02014R0537-20240109>

<sup>34</sup> Shih <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A02006L0043-20240109>

<sup>35</sup> Shih <https://cdn.ceps.eu/wp-content/uploads/2023/02/study-on-the-audit-directive-directive-200643ec-as-EV0120603ENN.pdf>

**FNK:**

- ✦ Informacion për vendet anëtare<sup>36</sup>

**IFIAR:**

- ✦ Adresat e anëtarëve<sup>37</sup>

**Estonia:**

- ✦ Ligji për Veprimtarinë e Audituesit<sup>38</sup>

**Franca:**

- ✦ Raport trevjeçar monitorimi për tregun e auditimit ligjor – qershor 2022<sup>39</sup>

**Buletini “Science Direct” i Kontabilitetit dhe Ekonomisë:**

- ✦ Insights into auditor public oversight boards: Whether, how and why they ‘work’ (Informacion mbi bordet e mbikëqyrjes publike të audituesve: a funksionojnë, si funksionojnë dhe përse funksionojnë)<sup>40</sup>

**Banka Botërore, Qendra për Reformën e Raportimit Financiar:**

- ✦ Public Oversight Systems for Statutory Audit in the EU (Sistemet e mbikëqyrjes publike të auditimit ligjor në BE), 2017
- ✦ Audit Oversight to Enhance Trust and Transparency in Corporate Financial Statements: Challenges in Developing Countries (Mbikëqyrja e auditimit për të rritur besimin dhe transparencën në pasqyrat financiare të shoqërive tregtare: vështirësitë e vendeve në zhvillim), 2019

<sup>36</sup> Shih [www.ifac.org/who-we-are/membership](http://www.ifac.org/who-we-are/membership)


<sup>37</sup> Shih <https://www.ifiar.org/members/member-directory/>

<sup>38</sup> Shih <https://www.riigiteataja.ee/en/eli/504092017006/consolide#54b91ae7-bd5f-4ac3-943e-dd5d55aa69ab>

<sup>39</sup> Shih <https://h2a-france.org/publications/rapport-2022-du-h3c-relatif-au-suivi-du-marche-du-controle-legal-des-comptes/>

<sup>40</sup> Shih <https://www.sciencedirect.com/science/article/abs/pii/S0165410122000209>





# Përmbledhje e pjesëve përkatëse të Direktivës dhe të Rregullores për Auditimin Ligjor

## Krijimi i SMP-së

Rekomandohet që Shtetet Anëtare të organizojnë një SMP efektiv për audituesit ligjorë, shoqëritë e auditimit dhe ofruesit e shërbimit të dhënies sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, dhe të caktojnë një autoritet kompetent (OMA) të cilit t'i ngarkohet detyra për këtë mbikëqyrje.

## Drejtimi i brendshëm

Rekomandohet që OMA të drejtohet nga persona të cilët nuk e ushtrojnë profesionin e të cilët kanë njohuri në fushat e lidhura me auditimin ligjor dhe, sipas rastit, dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë. Këta të zgjidhen sipas një procedure të pavarur dhe transparente.

Mosushtruesit e profesionit përkufizohen si persona që brenda tre viteve të fundit nuk kryejnë auditim ligjor, nuk kanë të drejtë vote në një shoqëri auditimi, nuk janë anëtar i organit administrativ, drejtues ose mbikëqyrës të një shoqërie auditimi ose nuk janë të punësuar ose të lidhur me një shoqëri auditimi.

## Detyrat e autoritetit kompetent

OMA:

- ✦ ka përgjegjësinë finale për mbikëqyrjen:
  - a. e aprovimit dhe regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit;
  - b. e miratimit të standardeve për etikën profesionale, kontrollit të brendshëm të cilësisë së shoqërive të auditimit dhe ofruesve të shërbimit të dhënies së sigurisë;

- c. e arsimit të vazhdueshëm, kontrollit të cilësisë dhe sistemeve hetimore dhe disiplinore.
- ✦ ka të drejtën për të kryer hetime në lidhje me audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit dhe për të marrë masat e duhura.
- ✦ publikon programin vjetor të punës dhe raportet e aktivitetit.
- ✦ pajiset me fonde adekuate. Fondet janë të sigurta dhe të çliruara nga çdo ndikim i parregullt nga ana e audituesve ligjorë a shoqërive të auditimit.

## Delegimi i detyrave

Shtetet Anëtare mund të delegojnë ose t'ua lejojnë autoriteteve kompetente të delegojnë cilëndo prej detyrave që kërkohet të kryhen sipas Direktivës dhe Rregullores të autoriteteve ose organe të tjera të caktuara për të kryer detyra të tilla, me përjashtim të detyrave të lidhura me:

- a. sistemit të kontrollit të cilësisë për audituesit e NJEIP-ve;
- b. hetimeve që rrjedhin nga ky sistem i kontrollit të cilësisë ose nga një referim nga një autoritet tjetër; dhe
- c. sanksioneve dhe masave në lidhje me shqyrtimet e kontrollit të cilësisë të audituesve të NJEIP-ve ose hetimet e auditimeve ligjore të NJEIP-ve.

## Sistemi i kontrollit të cilësisë për audituesit

Inspektimet e rregullta janë një mjet i mirë për të arritur një cilësi të lartë të njëtrajtshme të auditimeve ligjore.

Rekomandohet që kontrolli i cilësisë:

- ✦ të jetë i pavarur nga audituesit dhe shoqëritë e auditimit që kontrollohen dhe t'i nënshtrohet mbikëqyrjes publike;
- ✦ të bëhet drejtpërdrejt nga OMA-ja në lidhje me auditimet e NJEIP-ve;
- ✦ të ketë kontrollorë të cilësisë të cilët të kenë arsimimin e duhur profesional dhe përvojën përkatëse

- ✦ në fushën e auditimit ligjor dhe të raportimit financiar së bashku me formimin specifik për shqyrtimet e kontrollit të cilësisë;
- ✦ të bëjë përzgjedhjen e kontrollorëve në atë mënyrë që të mos ketë konflikt interesi.

## Shpeshtësia e inspektimeve

Shqyrtimi i kontrollit të cilësisë bëhet të paktën çdo tre vjet në lidhje me audituesit e njësive ekonomike me interes publik dhe të paktën çdo gjashtë vjet në rastin e të gjithë audituesve të tjerë ligjorë.

## Kërkesa të tjera në Direktivën dhe Rregulloren për Auditimin

Direktiva për Auditimin vendos edhe kërkesat për mbikëqyrjen publike të auditimit dhe dhënësit e sigurisë në këto fusha:

- ✦ kualifikimet (nenet 3-13);
- ✦ regjistrimi (nenet 15-20);
- ✦ etika profesionale (nenet 21-24);
- ✦ standardet (neni 26);
- ✦ aspekte të procesit të auditimit dhe dhënies së sigurisë (nenet 25, 27, 28);
- ✦ monitorimi, hetimi dhe sanksionimi (nenet 29-30);
- ✦ mbikëqyrja nga autoritetet kompetente (nenet 32-36, 47); dhe
- ✦ rregullimi i audituesve dhe dhënësve të sigurisë të vendeve të treta (nenet 44-46).

Në Direktivën për Auditimin ka edhe disa detyrime për njësitë ekonomike të audituara, në lidhje me:

- ✦ caktimin e audituesve dhe dhënësve të sigurisë (neni 37);
- ✦ shkarkimin e audituesve dhe dhënësve të sigurisë (neni 38); dhe
- ✦ krijimin e një komiteti auditimi (neni 39).

Rregullorja për Auditimin parashikon kërkesat e mëposhtme në lidhje me auditimin ligjor (dhe dhënien

e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë) të NJEIP-ve:

- ✦ kushtet për kryerjen e auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë të NJEIP-ve (nenet 4-15);
- ✦ emërimin e audituesve ligjorë, shoqërive të auditimit dhe dhënësve të sigurisë nga NJEIP-të (nenet 16-19);
- ✦ mbikëqyrjen e aktiviteteve të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit që kryejnë auditimet ligjore të NJEIP-ve (nenet 20-35); dhe
- ✦ bashkëpunimin me autoritetet e vendeve të treta (nenet 36-40).

## Rregullorja për Auditimin (neni 31)

Rregullorja për Auditimin (neni 31) kërkon që OMA-t të bashkëpunojnë në lidhje me shqyrtimet, hetimet dhe inspektimet në vend të kontrollit të cilësisë.

### Neni 31: Bashkëpunimi në lidhje me shqyrtimet e kontrollit të cilësisë, hetimet dhe inspektimet në vend

1. Autoritetet kompetente marrin masa për të siguruar bashkëpunimin e efektshëm të BE-së në lidhje me shqyrtimet e kontrollit të cilësisë.
2. OMA e një Shteti Anëtar mund të kërkojë asistencën e OMA-s së një Shteti Anëtar tjetër në lidhje me shqyrtimet e kontrollit të cilësisë të audituesve ligjorë ose shoqërive të auditimit që i përkasin një rrjeti që kryen veprimtari të konsiderueshme në Shtetin Anëtar të cilit i drejtohet kërkesa.
3. Kur një OMA merr një kërkesë nga OMA e një Shteti Anëtar tjetër për të asistuar në shqyrtimin e kontrollit të cilësisë të një audituesi ligjor ose shoqërie auditimi që i përket një rrjeti që kryen veprimtari të konsiderueshme në atë Shtet Anëtar, i lejon OMA-s që ka bërë kërkesën të asistojë në shqyrtimin e kontrollit të cilësisë.  
  
OMA që bën kërkesën nuk ka të drejtë të shohë informacione që mund të shkelin rregullat e


sigurisë kombëtare apo që cenojnë sovranitetin, sigurinë ose rendin publik të Shtetit Anëtar të cilit i drejtohet kërkesa.

4. Kur një OMA arrin në përfundimin se në territorin e një Shteti Anëtar tjetër po kryhen ose janë kryer aktivitete që bien ndesh me dispozitat e kësaj rregulloreje, ai e njofton në mënyrë sa më specifike për këtë përfundim OMA-n e Shtetit Anëtar tjetër. OMA i Shtetit Anëtar tjetër ndërmerr veprimin e duhur. Ai e informon OMA-n njoftues për rezultatin e këtij veprimi dhe, me sa mundet, për zhvillimet e ndërmjetme me rëndësi.
5. OMA i një Shteti Anëtar mund të kërkojë kryerjen e një hetimi nga OMA i një Shteti Anëtar tjetër në territorin e këtij të fundit.

Ai mund të kërkojë edhe që një pjesë e personelit të tij të lejohet të shoqërojë personelin e OMA-s të atij Shteti Anëtar gjatë kryerjes së hetimit, përfshirë edhe inspektimet në vend.

Hetimi ose inspektimi mbetet gjatë gjithë kohës nën kontrollin e Shtetit Anëtar në territorin e të cilit kryhet.

6. OMA të cilit i drejtohet kërkesa mund të mos pranojë të ndërmarrë veprim për kryerjen e një hetimi siç parashikohet në paragrafin e parë të pikës 5, ose për përmbushjen e një kërkesë që personeli i tij të shoqërohet nga personeli i OMA-s të një Shteti Anëtar tjetër siç parashikohet në paragrafin e dytë të pikës 5, në këto raste:
  - a. kur një hetim ose inspektim i tillë në vend mund të shkelë rregullat e sigurisë kombëtare ose të cenojë sovranitetin, sigurinë ose rendin publik të Shtetit Anëtar të cilit i drejtohet kërkesa;
  - b. kur ka filluar proces gjyqësor në lidhje me të njëjtat veprime dhe kundër të njëjtit person, përpara autoriteteve të Shtetit Anëtar të cilit i drejtohet kërkesa;
  - c. kur ka dalë vendim gjyqësor i formës së prerë në lidhje me të njëjtat veprime dhe të njëjtin person, nga autoritetet e Shtetit Anëtar të cilit i drejtohet kërkesa.
7. Në rastin e një shqyrtimit të kontrollit të cilësisë ose një hetimi me pasoja ndërkufitare, autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare në fjalë mund t'i drejtojnë një kërkesë të përbashkët KOEMA-s për të bashkërenduar shqyrtimin ose hetimin.



## Sistemet e mbikëqyrjes publike në disa Shtete Anëtare të BE-së

### Austria

#### Burimet

Informacioni është nxjerrë nga raporti vjetor i Autoritetit Austriak Mbikëqyrës të Audituesve (AAMA,<sup>41</sup> IFIAR,<sup>42</sup> dhe FNK.<sup>43</sup>

#### Përgjegjësia për legjislacionin

Në Austri, përgjegjësin kryesore për legjislacionin i takon Ministrisë Federale të Financave.

AAMA-ja është krijuar më 27 shtator 2016, si institucion i pavarur i së drejtës publike, dhe ka filluar veprimtarinë zyrtare më 1 tetor 2016. Baza kryesore ligjore është Ligji për mbikëqyrjen e audituesve<sup>44</sup> dhe Rregullorja (BE) nr. 537/2014.

Sipas Ligjit për mbikëqyrjen e audituesve S14 (1), Ministri Federal i Financave ushtron mbikëqyrje mbi AAMA-n për të siguruar që ky autoritet i përmbush detyrat e ngarkuara me ligj, nuk shkel aktet ligjore dhe nënligjore në kryerjen e detyrave dhe nuk tejkalon objektin e detyrave. Sipas nenit 16, pika 1, qeveria federale ka detyrën të shpërblejë dëmin e shkaktuar nga organet dhe punonjësit e AAMA-s dhe nga anëtarët e Komisionit të Kontrollit të Cilësisë.

<sup>41</sup> Shih <https://www.apab.gv.at/ueberuns/zahlenFakten>

<sup>42</sup> Shih <https://www.ifiar.org/?wpdmdl=16674>

<sup>43</sup> Shih <https://www.ifac.org/about-ifac/membership/profile/austria>

<sup>44</sup> Shih <https://www.ris.bka.gv.at/GeltendeFassung.wxe?Abfrage=Bundesnormen&Gesetzesnummer=20009615>

## Vendndodhja e OMA-s

AAMA është nën mbikëqyrjen juridike të Ministrisë Federal të Financave. AAMA e identifikon veten si autoritet administrativ autonom, që nuk merr urdhra, por financohet pjesërisht nga Ministria e Financave, prandaj nuk është plotësisht i pavarur ose autonom.

## Drejtimi i brendshëm i Organit të Mbikëqyrjes së Auditimit

Këshilli mbikëqyrës i AAMA-s përbëhet nga katër anëtarë, që emërohen me mandat pesëvjeçar. Sipas nenit 9, pika 3, të Ligjit për Mbikëqyrjen e Auditorëve, kryetari dhe dy anëtarë të tjerë të keshillit mbikëqyrës emërohen nga Ministri Federal i Financave, ndërsa një anëtar i keshillit mbikëqyrës emërohet nga Ministri Federal i Punës dhe Çështjeve Ekonomike, në të dy rastet pas konsultimit me partnerët socialë.

Komisioni i Kontrollit të Cilësisë i shërben AAMA-s si organ këshillimor dhe ka shtatë anëtarë dhe shtatë zv/anëtarë. Këta emërohen nga keshilli mbikëqyrës i AAMA-s me mandat katërvjeçar, me propozim të Dhomës së Këshilltarëve Fiskalë dhe Audituesve, Federatës së Shoqatave Austriake të Auditimit dhe Shoqatës së Auditimit të Bankave të Kursimeve.

## Sanksionet

Sipas nenit 62, pika 1, të Ligjit për Mbikëqyrjen e Audituesve, AAMA ka të drejtë të vendosë sanksione në rast shkeljeje të dispozitave të Ligjit për Mbikëqyrjen e Audituesve dhe të Rregullores.

AAMA publikon në faqen e saj të gjitha sanksionet e vendosura për shkelje të dispozitave të Ligjit për Mbikëqyrjen e Audituesve dhe të Rregullores, për të cilat janë shteruar të gjitha mjetet juridike ose kanë skaduar afatet përkatëse të ankimimit.

## Delegimi i detyrave

AAMA ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për:

- ✦ licencimin, regjistrimin, inspektimin dhe masat shtrënguese
- ✦ mbikëqyrjen e standardeve të auditimit/etikës
- ✦ AVP-në dhe formimin

Sipas Studimit të BE-së mbi Direktivën për Auditimin dhe Rregulloren për Auditimin,<sup>45</sup> pika 3.1.1, ndarja e kompetencave midis AAMA-s dhe organit profesional në Austri nuk ndjek ndarjen NJEIP/jo-NJEIP. Në vende të kësaj, kjo detyrë kryhet bashkërisht nga AAMA dhe nga organi profesional, nën përgjegjësinë e AAMA-s.

AAMA është përgjegjës për regjistrimin e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit; si dhe për shqyrtimet e kontrollit të cilësisë për të gjitha auditimet e detyrueshme; dhe hetimin dhe disiplinimin e audituesve të NJEIP-ve dhe jo NJEIP-ve.

Të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të cilët kryejnë auditime ligjore në Austri janë objekt i shqyrtimit të cilësisë të paktën një herë në gjashtë vjet. Audituesit e NJEIP-ve janë objekt i shqyrtimit të cilësisë të paktën një herë në tre vjet.

## Burimet dhe financimi

Financimi i AAMA-s parashikohet me Ligjin për mbikëqyrjen e audituesve, në dispozitat për financimin dhe kontributet administrative<sup>46</sup> neni 2. Financimi sigurohet nga Ministria Federale e Financave, Dhoma e Konsulentëve Fiskalë dhe Audituesve, shoqatat bashkëpunuese të auditimit dhe Shoqata e Auditimit të Bankave të Kursimeve, si dhe me të ardhura nga tarifat për inspektimet.

Më 31 dhjetori 2023, AAMA kishte gjithsej 8,7 të punësuar (pa përfshirë këshillin drejtues, ekuivalent punonjës me orar të plotë). Katër punonjës punonin në Grupin A "Inspektime dhe Hetime" dhe tre punonjës në Grupin B "Çështje juridike, ndërkombëtare dhe kontrolli i cilësisë".

<sup>45</sup> Shih <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/1e77fe60-71f5-11ed-9887-01aa75ed71a1/language-en>

<sup>46</sup> Shih <https://www.ris.bka.gv.at/GeltendeFassung.wxe?Abfrage=Bundesnormen&Gesetzesnummer=20009615>

## Tregu i auditimit<sup>47</sup>

Gjatë vitit 2023, 14 shoqëri auditimi kryen 264 auditime të pasqyrave financiare të NJEIP-ve (2022: -3,6%).

## Estonia

### Burimet

Informacioni është marrë në periudhën korrik 2024 - dhjetor 2024 nga FNK,<sup>48</sup> nga Bordi Mbikëqyrës i Auditimit<sup>49</sup> (AJN) (i njohur edhe si Këshilli Mbikëqyrës), nga legjislacioni dhe nga rregullorja e punës.<sup>50</sup>

## Përgjegjësia për legjislacionin

AJN është autoriteti mbikëqyrës i auditimit në Estoni, ngritur nga Ministri i Financave në bazë të Ligjit për Veprimtarinë e Audituesve.<sup>51</sup>

Është nën vartësinë e Këshillit Mbikëqyrës të Veprimtarive të Audituesve<sup>52</sup> (sipas FNK-së). Lidhja duket se të çon në portalin e auditimit dhe regjistrimit me një lidhje për AJN-në.

## Vendndodhja e OMA-s

Për shkak të afërsisë me Ministrinë e Financave dhe Bordin e Audituesve, nuk është e qartë nëse AJN është organ i pavarur. AJN duket se ndodhet veçmas Bordit të Audituesve dhe mund të duket i pavarur nga Bordi i Audituesve. Megjithatë, në situata të ndryshme juridike që kërkojnë personalitet juridik, AJN përdor subjektin juridik të Bordit të Audituesve në bazë të

kompetencës që ia jep ligji. Publikimi i "Accountancy Europe" i qershorit 2022 bën të ditur se Estonia ka një organ të veçantë autonom mbikëqyrës të auditimit.

Ministria e Financave mban përgjegjësinë e fundme për AJN-në, për të siguruar që ky organ, Bordi i Audituesve dhe organizata vendore profesionale e kontabilitetit (Shoqata Estoneze e Audituesve) t'i ushtrojnë veprimtaritë në respektim të interesit publik.

Kompetenca dhe detyrat e Ministrisë së Financave përcaktohen në nenin 123 të Ligjit për Auditimin,<sup>53</sup> më të rëndësishmet prej të cilave janë mbikëqyrja e audituesve të brendshëm, organizimi i mbajtjes së regjistrit dhe mbikëqyrja administrative e Bordit të Audituesve.

AJN është ngritur në bazë të nenit 21 të Ligjit për Veprimtarinë e Audituesve (Kapitulli 9).<sup>54</sup> Rregullorja e punës e këtij organi gjendet në faqen Riigi Teataja.<sup>55</sup>

Sipas këtij ligji (neni 124), roli i AJN-së është ushtrimi i mbikëqyrjes shtetërore (përfshirë dhënien dhe heqjen e licencave të veprimtarive dhe profesioneve; organizimin e provimeve; organizimin e kontrollit të cilësisë; zhvillimin e procedurave disiplinore; hetimin (përfshirë veprimtaritë e Bordit të Audituesve); përfaqësimin e Estonisë në Komisionin Europian në lidhje me mbikëqyrjen e aktiviteteve të auditimit etj.).

## Drejtimi i brendshëm i Organit të Mbikëqyrjes së Auditimit

Mbikëqyrja bëhet nga AJN, që raporton te Ministria e Financave. Ka 5-7 anëtarë, të emëruar me një mandat pesëvjeçar.

Anëtarët dhe kryetari i AJN-së emërohen nga ministri përgjegjës i fushës. Propozimet për përbërjen e AJN-së

<sup>47</sup> Informacion nga Raporti Vjetor i vitit 2023 <https://www.apab.gv.at/ueberuns/zahlenFakten>

<sup>48</sup> Shih <https://www.ifac.org/about-ifac/membership/profile/estonia>

<sup>49</sup> Shih <https://ajn.ee/tekst>

<sup>50</sup> Shih <https://www.riigiteataja.ee/akt/131102017003>

<sup>51</sup> Shih <https://www.riigiteataja.ee/en/eli/504092017006/consolide>

<sup>52</sup> Shih <https://www.auditortegevus.ee/atr/web/>

<sup>53</sup> Shih <https://www.riigiteataja.ee/akt/117112017025#para123>

<sup>54</sup> Shih <https://www.riigiteataja.ee/akt/117112017025#para121>

<sup>55</sup> Shih <https://www.riigiteataja.ee/akt/131102017003>

i jepen ministrit përgjegjës të fushës nga:

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare – për anëtar.
2. Zyra Kombëtare e Auditimit – për anëtar.
3. Ministria e Drejtësisë – për anëtar.

## Delegimi i detyrave

AJN nuk e delegon rolin kryesor mbikëqyrës.

Kryen detyrat e mëposhtme në kuadër të rolit mbikëqyrës: i. dhënia, pezullimi dhe heqja e licencave të auditimit; ii. miratimi i standardeve të auditimit dhe etikës; iii. organizimi i provimeve profesionale të audituesve; iv. kryerja e shqyrtimit të kontrollit të cilësisë dhe procedurave disiplinore; v. vendosja e sanksioneve; dhe vi. mbikëqyrja e veprimtarive që i delegohen Shoqatës Estoneze të Audituesve, si arsimi i vazhdueshëm profesional dhe zhvillimi.

## Burimet dhe financimi

Kostot e AJN-së për organizimin e mbikëqyrjes janë objekt i ligjit. Për përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit me destinacion të përcaktuar për mbikëqyrjen, Ministria e Financave lidh kontratë të veçantë. Interesat e Bordit të Audituesve i përfaqëson edhe Kryetari i AJN-së. Ky është një aspekt që tregon mungesë pavarësie.

Shpenzimet e AJN-së miratohen nga Kryetari duke nënshkruar dokumentin përkatës të shpenzimeve. Ndalohet miratimi i shpenzimeve të cilat nuk lidhen me kryerjen e detyrave që AJN-së ia ngarkon Ligji për Veprimtarinë e Auditimit ose për të cilat nuk ka fonde në buxhet.

## Franca

### Burimet

Informacionet janë marrë nga FNK,<sup>56</sup> IFIAR,<sup>57</sup> dhe nga faqja e H2A.<sup>58</sup>

## Përgjegjësia për legjislacionin

Legjislacioni është në tagrin e Ministrisë së Drejtësisë.

H2A është autoritet publik i pavarur i nivelit të lartë, krijuar me Urdhrin nr. 2023-1142, datë 6 dhjetor 2023, për të zëvendësuar "Haut Conseil du Commissariat aux Comptes (H3C)" (Këshilli i Lartë i Llogarive) ngritur me Ligjin për Sigurinë Financiare më 1 gusht 2003.

## Vendndodhja e OMA-s

H2A është organ i pavarur joqeveritar, përgjegjës për mbikëqyrjen e profesionit të auditimit.

Ligji francez nr. 2017-55, datë 20 janar 2017, përcakton një statut të përgjithshëm për autoritetet publike të pavarura. Dy prej dispozitave të tij sigurojnë pavarësinë e anëtarëve të Bordit H2A.

Standardet e ndjekura nga H2A miratohen zyrtarisht nga Ministri i Drejtësisë dhe publikohen në Fletoren Zyrtare të Francës.

Raporti i "Accountancy Europe" i qershorit 2022 thotë se organi mbikëqyrës i auditimit vepron veçmas dhe në mënyrë autonome.

## Drejtimi i brendshëm i Organit të Mbikëqyrjes së Auditimit

Bordi i H2A përbëhet nga 14 anëtarë të emëruar me dekret për mandate gjashtëvjeçare, siç përcaktohet në nenin L. 820-2 i Kodit Tregtar Francez.

Neni 1.1.8 i rregullores së punës të H2A-së parashikon që ish-anëtarët e Bordit të H2A-së nuk mund të kryejnë asnjë aktivitet për shoqëritë e auditimit me të cilat kanë qenë në kontakt brenda ushtrimit të funksioneve të tyre, për një periudhë prej tre vitesh nga përfundimi i funksioneve të tyre. Kjo dispozitë është e sanksionuar penalisht (neni 432-13 i Kodit Penal Francez). Punonjësit e H2A-së janë objekt i të njëjtave rregulla dhe sanksione.

<sup>56</sup> Shih <https://www.ifac.org/about-ifac/membership/profile/france>

<sup>57</sup> Shih <https://www.ifiar.org/?wpdmdl=16906>

<sup>58</sup> Shih <https://h2a-france.org/>



## Sanksionet

Komisioni i sanksioneve ushtron kompetencat e parashikuara në pikën 7 të nenit L. 820-1 i Kodit Tregtar.

Studimi i BE-së mbi Direktivën për Auditimin dhe Rregulloren për Auditimin<sup>59</sup> thotë se disa vende kanë ndjekur një proces centralizimi pas reformës së auditimit. Në Francë, kompetencat për sanksionet disiplinore kanë kaluar nga organi profesional vendor te organi mbikëqyrës i auditimit (H2A).

## Delegimi i detyrave

Si pjesë e mandatit, H2A i ka deleguar disa veprimtari të "Compagnie Nationale des Commissaires aux Comptes" — organizatës profesionale të kontabilitetit për audituesit ligjorë në Francë. Këtu përfshihen: i. regjistrimi i audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, me përjashtim të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit nga jashtë BE-së; ii. inspektimet e cilësisë për njësitë ekonomike pa interes publik; dhe iii. monitorimi i AVP-së për audituesit ligjorë.

H2A dhe organi rregullator i tregut të letrave me vlerë, "Autorité des Marchés Financiers" (AMF),<sup>60</sup> kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në vitin 2010, ku përcaktohen procedurat që ndjek AMF për të ndihmuar në kryerjen e inspektimeve periodike të audituesve ligjorë të emëruar në shoqëritë nën mbikëqyrjen e AMF-së. Kodi Tregtar parashikon që AMF-ja mund të asistojë në inspektimet periodike të audituesve ligjorë që auditojnë pasqyrat e subjekteve nën mbikëqyrjen e AMF-së.

## Burimet dhe financimi

H2A është financiarisht i pavarur. Sipas neneve L820-10, L820-11 dhe L820-12 të Kodit Tregtar

Francez, financimi i H2A-së përbëhet nga kontributet e detyrueshme të audituesve ligjorë dhe ofruesve të shërbimeve të pavarura të dhënies së sigurisë, të llogaritura mbi tarifën e faturuara subjekteve të audituara gjatë vitit kalendarik të fundit. Bordi miraton buxhetin e H2A-së, me propozim të kryetarit të bordit.

## Tregu i auditimit

Këto shifra janë nxjerrë nga Raporti H3C i Monitorimit të Tregut 2022:

- ✦ Numri i shoqërive të auditimit: 6 411 gjithsej
- ✦ Numri i audituesve individë: 11 448

## Gjermania

### Burimet

Informacionet janë marrë nga FNK,<sup>61</sup> IFIAR,<sup>62</sup> dhe faqja e Organit Gjerman të Mbikëqyrjes së Auditimit (APAS).<sup>63</sup>

## Përgjegjësia për legjislacionin

APAS është themeluar me legjislacion të brendshëm, pra me Ligjin për Reformën e Mbikëqyrjes së Audituesve, ndryshuar me Ligjin për Kontabilistët Publikë të vitit 1961.

## Vendndodhja e OMA-s

Mbikëqyrjen e bën APAS.

Financohet nga buxheti federal dhe nga tarifën e inspektimit. Buxheti federal e miraton parlamenti gjerman.

<sup>59</sup> Shih <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/1e77fe60-71f5-11ed-9887-01aa75ed71a1/language-en>

<sup>60</sup> Shih <https://autorite.qc.ca/en/general-public/>

<sup>61</sup> Shih <https://www.ifac.org/about-ifac/membership/profile/germany>

<sup>62</sup> Shih <https://www.ifiar.org/?wpdmdl=16822>

<sup>63</sup> Shih [https://www.bafa.de/DE/Home/home\\_node.html](https://www.bafa.de/DE/Home/home_node.html)

## Drejtimi i brendshëm i Organit të Mbikëqyrjes së Auditimit

APAS merr vendime përmes kolegjeve vendimmarrëse në lidhje me inspektimet dhe hetimet profesionale, si dhe të gjitha vendimet dytësore që lidhen me to. Dy kolegje kanë nga pesë punonjës secili, një kryetar dhe katër vlerësues. Kryetari i kolegjit është drejtuesi i degës përkatëse. Katër vlerësuesit e kolegjeve nuk janë pjesë e nivelit drejtues të APAS-it dhe emërohen nga kreu i APAS-it, duke mbajtur parasysh njohuritë e specializuara dhe afërsinë me fushën e përgjegjësisë së kolegjit përkatës dhe aktivitetet e vlerësuesit në APAS.

Një bord këshillimor, i formuar në bazë të neneve 2 dhe 3 të Ligjit për Reformën e Mbikëqyrjes së Audituesve, këshillon APAS-in në kryerjen e detyrave dhe mund edhe të japë rekomandime për zhvillimin e përgjithshëm të praktikës mbikëqyrëse. Pesë anëtarët e bordit këshillimor emërohen nga Ministria Federale për Çështjet Ekonomike dhe Veprimin Klimatik, për mandat katërvjeçar.

## Delegimi i detyrave

APAS ia ka deleguar disa nga detyrat e veta organit profesional vendor.

## Burimet dhe financimi

APAS financohet kryesisht me tarifa (~70%, p.sh. për inspektimet) por edhe nga Buxheti Federal (~30%). Buxheti i APAS-it bën pjesë në buxhetin e Zyrës Federale për Çështjet Ekonomike dhe Kontrollin e Eksporteve dhe për këtë arsye, në nivel të fundmë, bën pjesë në Buxhetin Federal të miratuar nga Parlamenti Gjerman.

- Numri i shoqërive të auditimit objekt i inspektimeve: 52 (auditime në vitin 2023)

- Numri i NJEIP-ve: 993 (NJEIP: njësi ekonomike të listuara në bursë, banka jo të listuara në burë dhe shoqëri sigurimi) (më 31.12.2022)
- Personel: 15 gjithsej: Drejtori Ekzekutiv, 2 drejtorë ekzekutivë, 12 punonjës të tjerë (nga të cilët 6 punonjës duhet të kenë përgatitje ligjore dhe të jenë të kualifikuar për të mbajtur postin e gjyqtarit)

## Greqia

### Burimet

Informacionet janë marrë nga FNK,<sup>64</sup> IFIAR,<sup>65</sup> dhe nga ELTE.<sup>66</sup>

## Përgjegjësia për legjislacionin

Ministria e Financave është përgjegjëse për Ligjin 3148/2003, ndryshuar me Ligjin 4449/2017<sup>67</sup> me të cilin është krijuar ELTE-ja.

## Vendndodhja e OMA-s

Sipas IFIAR-it, ELTE është autoriteti i pavarur publik i mbikëqyrjes së profesionit të auditimit në Greqi, objekt i mbikëqyrjes nga Ministria e Financave.

Raporti i "Accountancy Europe" i qershorit 2022 thotë se organi mbikëqyrës i auditimit vepron veçmas dhe në mënyrë autonome.

## Drejtimi i brendshëm i Organit të Mbikëqyrjes së Auditimit

Këshilli i administrimit përbëhet nga shtatë anëtarë, pra nga kryetari, dy nënkryetarë dhe katër anëtarë. Mandati është trevjeçar.

<sup>64</sup> Shih <https://www.ifac.org/about-ifac/membership/profile/greece>

<sup>65</sup> Shih <https://www.ifiar.org/?wpdmdl=16842>

<sup>66</sup> Shih <https://elte.org.gr/organizational-structure/>

<sup>67</sup> Shih [http://www.elte.org.gr/images/files/pdf/Nomos\\_ELTE\\_4449.pdf](http://www.elte.org.gr/images/files/pdf/Nomos_ELTE_4449.pdf)

## Delegimi i detyrave

ELTE-ja ia ka deleguar disa nga detyrat e veta organit profesional vendor. Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese të audituesit ligjor/shoqërisë së auditimit paraqiten pranë Institutit të Kontabilistëve Publikë të Autorizuar të Greqisë, që regjistron tërësinë e dokumenteve mbështetëse të paraqitura dhe i vërteton ELTE-së se të gjitha dokumentet e dorëzuara janë të vlefshme, të sakta dhe të plota ose se përmbajnë ndonjë mangësi. ELTE ka përgjegjësinë e fundme për të marrë vendim mbi licencimin ose jo të një audituesi ligjor/shoqërie auditimi dhe regjistron ata që përmbushin kushtet për licencë të profesionit.

## Burimet dhe financimi

Financimi përfshin një taksë ligjore mbi të gjitha shoqëritë e auditimit, e llogaritur si përqindje fikse e shumës bruto të tarifave bruto të auditimit - kjo përqindje është e përcaktuar me ligj dhe mund të ndryshohet vetëm me një ndryshim në ligj.

- ✦ Buxheti vjetor i ELTE-s miratohet nga Ministria e Financave dhe të gjitha pagesat ndjekin procedurat e zbatueshme për sektorin publik.
- ✦ Sipas informacionit të IFIAR në 2024, 67 shoqëri auditimi i nënshtrohen inspektimit.
- ✦ Ka edhe disa (afro 4) auditues ligjorë të cilët kryejnë periodikisht auditime ligjore si individë.
- ✦ Auditimet me interes publik janë afro: 205.
- ✦ Auditimet e tjera janë afro: 10 000 (auditime ligjore).

## Irlanda

### Burimet

Informacionet janë marrë nga FNK,<sup>68</sup> IFIAR<sup>69</sup> dhe nga faqja e Autoritetit Mbikëqyrës të Auditimit dhe Kontabilitetit të Irlandës (IAASA).<sup>70</sup>

## Përgjegjësia për legjislacionin

Legjislacioni për mbikëqyrjen e auditimit në Irlandë është detyrë e Ministrisë së Sipërmarrjes, Tregtisë dhe Punësimit.

IAASA është ngritur në bazë të dispozitave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare (Auditimin dhe Kontabilitetin) të vitit 2003, zëvendësuar nga Ligji për Shoqëritë Tregtare i vitit 2014 ("Ligji i vitit 2014") ndryshuar në vitin 2018 dhe nga Instrumenti Normativ Nr. 360 i vitit 2017.

## Vendndodhja e OMA-s

IAASA është organ mbikëqyrës autonom dhe i pavarur i auditimit (megjithëse ka 40% financim shtetëror).<sup>71</sup>

## Drejtimi i brendshëm i Organit të Mbikëqyrjes së Auditimit

IAASA drejtohet nga një këshill administrimi prej nëntë anëtarësh, tetë prej të cilëve janë të jashtëm dhe emërohen nga ministri, me propozim të Ministrisë së Sipërmarrjes, Tregtisë dhe Punësimit (2), organet e përcaktuara kontabël (2), Banka Qendrore e Irlandës, Autoriteti i Kontrollit Ligjor të Shoqërive Tregtare, Bursa Irlandeze dhe Drejtorët e Administratës Fiskale.

## Sanksionet dhe masat shtrënguese

IAASA është përgjegjëse drejtpërdrejt për zbatimin me forcë në lidhje me çështjet e auditimit të NJEIP-ve, që kryhet në përputhje me nenin 934 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare të vitit 2014. Të gjitha çështjet e tjera janë detyrë e organeve të njohura kontabël. IAASA ka kompetenca specifike ligjore që i japin mundësi të mbikëqyrë këto aktivitete dhe t'u kërkojë organeve të bëjnë ndryshime në procesin e tyre sipas nevojës. Ky autoritet ka nxjerrë udhëzime të detyrueshme për funksionet hetimore dhe disiplinore të organeve.

<sup>68</sup> Shih <https://www.ifac.org/about-ifac/membership/profile/ireland>

<sup>69</sup> Shih <https://www.ifiar.org/?wpdmdl=16668>

<sup>70</sup> Shih <https://iaasa.ie/>

<sup>71</sup> Harmonizohet me dokumentin e "Accountancy Europe" nga qershori 2022

## Delegimi i detyrave

IAASA ka deleguar disa nga detyrat e veta. Auditimet e njësive ekonomike pa interes publik dhe audituesit e tyre inspektohen nga organet e njohura kontabël.

Regjistrimi dhe licencimi bëhen nga organet e njohura kontabël nën mbikëqyrjen e IAASA-s.

Duhet thënë se organet e njohura kontabël janë një nëngrup i organeve të përcaktuara kontabël, të cilëve u lejohet të japin miratimin që anëtarët të bëhen auditues ligjorë.

## Burimet dhe financimi

Këshilli i IAASA-s përgatit një buxhet vjetor dhe propozimet për taksat përkatëse. Mekanizmi i financimit është përcaktuar në legjislacion dhe buxheti kërkon miratimin e ministrit. Financimi për mbikëqyrjen e organeve të profesionit kontabël vjen nga Thesari (40%) dhe nga organet e përcaktuara kontabël (60%).

Financimi për miratimin e standardeve të auditimit vjen nga Thesari (40%) dhe nga organet e njohura të profesionit kontabël (60%).

Financimi për aktivitetet e inspektimit të auditimit vjen nga shoqëritë e auditimit me interes publik.

IAASA ka përgjegjësinë e fundme për mbikëqyrjen e të gjithë audituesve. Audituesit e NJEIP-ve inspektohen drejtpërdrejt nga IAASA. Në Irlandë ka 7 auditues të NJEIP-ve, që auditojnë afërsisht 575 njësi ekonomike me interes publik.

Inspektimet e drejtpërdrejta kryhen nga Sektori i Cilësisë së Auditimit, që ka në organikë 12 inspektorë.

Audituesit e NJEIP-ve duhet t'i nënshtrohen inspektimit të paktën çdo 3 vjet. Aktualisht, IAASA inspekton të gjitha shoqëritë e auditimit të NJEIP-ve çdo vit.

## Letonia

### Burimet

Informacionet janë marrë nga FNK<sup>72</sup> dhe nga Ministria e Financave e Letonisë<sup>73</sup> – Letonia nuk është anëtare e IFIAR-it.

### Përgjegjësia për legjislacionin

Ligji për shërbimet e auditimit 2004 (i ndryshuar në 2019), neni 26 thotë se organi përgjegjës është Ministria e Financave.

### Vendndodhja e OMA-s

Ministria e Financave<sup>74</sup> është përgjegjëse për rregullimin dhe mbikëqyrjen publike të audituesve nëpërmjet Sektorit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Auditimit të Shoqërive Tregtare, pranë Ministrisë së Financave.

Edhe Banka Qendrore e Letonisë<sup>75</sup> është e përfshirë në sistemin e mbikëqyrjes së veprimtarisë së audituesve të autorizuar për tregun financiar dhe pjesëmarrësit e tij.

Raporti i "Accountancy Europe" i qershorit 2022 thotë se organi mbikëqyrës i auditimit vepron pranë një ministrie.

### Drejtimi i brendshëm i Organit të Mbikëqyrjes së Auditimit

Këshilli i Bankës Qendrore ka ngritur Komitetin Mbikëqyrës për mbikëqyrjen e tregut financiar.

Sanksionet publikohen në faqen e bankës.<sup>76</sup>

<sup>72</sup> Shih <https://www.ifac.org/about-ifac/membership/profile/latvia>

<sup>73</sup> Shih <https://www.fm.gov.lv/en/auditing>

<sup>74</sup> Po aty

<sup>75</sup> Shih <https://www.bank.lv/en/>

<sup>76</sup> Shih <https://uzraudziba.bank.lv/en/market/sanctions/>

## Delegimi i detyrave

Mbikëqyrja e pjesëmarrësve të tregut financiar bëhet nga Banka Qendrore, megjithëse kjo nuk është në kompetencat e deleguara nga Ministria e Financave.

## Burimet dhe financimi

Sektori i Politikave dhe Mbikëqyrjes së Auditimit të Shoqërive Tregtare financohet nga buxheti i shtetit - kjo përputhet me dokumentin e vitit 2022 të "Accountancy Europe", megjithëse nuk përmendet mbikëqyrja dhe financimi i pjesëmarrësve të tregut financiar.

Pjesëmarrësit e tregut financiar të mbikëqyrur nga Banka Qendrore e financojnë për shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut financiar dhe pjesëmarrësve të tij, ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe ofrimin e skemave të shpërndarjes së dëmshpërblimit. Banka Qendrore përcakton numrin e pagesave që duhet të bëjnë pjesëmarrësit e tregut financiar, si dhe procedurat për llogaritjen dhe kryerjen e këtyre pagesave.

## Lituania

### Burimet

Informacionet janë marrë nga FNK,<sup>77</sup> IFIAR,<sup>78</sup> dhe nga faqja e Autoritetit të Auditimit, Kontabilitetit, Vlerësimit të Pasurive dhe Administrimit të Falimentimit (AAPVIM).<sup>79</sup>

## Përgjegjësia për legjislacionin

Ministria e Financave është përgjegjëse për legjislacionin, pra për Ligjin nr. 458, datë 6.5.2015 dhe Ligjin për Auditimin nr. XIII-96 të vitit 2017.

## Vendndodhja e OMA-s

AAAPVIM është OMA në Lituani dhe jep llogari para Ministrisë së Financave. Nuk është organ më vete.

## Drejtimi i brendshëm i Organit të Mbikëqyrjes së Auditimit

- ✦ Komiteti i mbikëqyrjes së auditimit ka 7 anëtarë.
- ✦ Raporti i "Accountancy Europe" i vitit 2022 thotë se organi mbikëqyrës i auditimit vepron pranë një ministrie.

## Sanksionet

Sanksionet i paraqiten për diskutim komitetit të mbikëqyrjes së auditimit. Vendimin përfundimtar për vendosjen e sanksioneve e merr Drejtori i AAPVIM-së, pas konsultimit me komitetin mbikëqyrës të auditimit.

Sanksionet shpallen publikisht në faqen e internetit.<sup>80</sup>

## Delegimi i detyrave

Sipas studimit të BE-së mbi Direktivën dhe Rregulloren për Auditimin,<sup>81</sup> pika 3.1.1 mbi Lituani, ndarja e kompetencave midis AAPVIM-së dhe organit profesional vendor nuk ndjek ndarjen NJEIP/jo-NJEIP. Në vende të kësaj, kjo detyrë kryhet bashkërisht nga AAPVIM-ja dhe nga organi profesional, nën përgjegjësinë e AAPVIM-së.

## Burimet dhe financimi

AAAPVIM-ja financohet plotësisht nga shteti. Koston e funksionimit në lidhje me të gjitha veprimtaritë mbulohen aktualisht me fonde të qeverisë së Republikës së Lituanisë (nëpërmjet Ministrisë së Financave).

<sup>77</sup> Shih <https://www.ifac.org/about-ifac/membership/profile/lithuania>

<sup>78</sup> Shih <https://www.ifiar.org/?wpdmdl=16609>

<sup>79</sup> Shih <https://avnt.lrv.lt/lt/>

<sup>80</sup> Shih <https://avnt.lrv.lt/lt/veiklos-sritys/auditas-1/auditoriu-ir-audito-imoniui-viesoji-prieziura/viesai-skelbiami-nurodymai-ir-poveikio-priemones/>

<sup>81</sup> Shih <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/1e77fe60-71f5-11ed-9887-01aa75ed71a1/language-en>

## Polonia

### Burimet

Informacionet janë marrë nga FNK,<sup>82</sup> IFIAR,<sup>83</sup> nga faqja e Agjencisë Polake për Mbikëqyrjen e Auditimit (PANA),<sup>84</sup> dhe nga informacione të CFRR-së.

### Përgjegjësia për legjislacionin

Përgjegjësin për legjislacionin i takon Ministrisë së Financave.

### Vendndodhja e OMA-s

PANA është ngritur në 2019 në bazë të Ligjit të ndryshuar të 11 majit 2017 për audituesit ligjorë, shoqëritë e auditimit dhe mbikëqyrjen publike. Veprimtaritë e PANA-s i mbikëqyr Ministri i Financave.

Sipas raportit të “Accountancy Europe” të vitit 2022, PANA është organ autonom më vete.

Sipas IFIAR-it, PANA është organ i pavarur i mbikëqyrjes publike dhe përbëhet nga kryetari dhe nga këshilli, si organe vendimmarrëse.

### Drejtimi i brendshëm i Organit të Mbikëqyrjes së Auditimit

Këshilli i PANA-s përbëhet nga 10 anëtarë, me kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e emëruar nga Ministria e Financave, me mandat katërvjeçar.

### Sanksionet

Sipas studimit të BE-së mbi Direktivën dhe Rregulloren për Auditimin, lidhur me sanksionet ka një mbivendosje kompetence mes PANA-s dhe Autoritetit Polak të Mbikëqyrjes Financiare, sepse

të dy autoritetet kanë kompetencën të vendosin sanksione mbi ortakët e një NJEIP-je (nëpërmjet ndalimit të ushtrimit të aktivitetit ose me sanksione financiare). Krahas kësaj, Dhoma Polake e Audituesve Ligjorë mund vendosë mbi anëtarët e saj ndalim të përkohshëm të ushtrimit të funksioneve brenda njësisë ekonomike të audituar.

### Delegimi i detyrave

PANA bën mbikëqyrjen e profesionit të auditimit, ndërsa Dhoma Polake e Audituesve Ligjorë ka detyrën e mbikëqyrjes së audituesve ligjorë. Detyrat kryesore brenda sistemit të mbikëqyrjes i kryen Dhoma Polake e Audituesve Ligjorë, ndërsa PANA bën mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit.

### Burimet dhe financimi

PANA financohet kryesisht me taksën e detyrueshme që u merret shoqërive të auditimit. Shkalla maksimale e tarifës, sipas ligjit, është 4% e të ardhurave të fituara nga auditimet ligjore të kryera në territorin e Polonisë, gjatë një viti kalendarik. Mund të merren fonde shtesë edhe përmes burimeve të tjera, të përcaktuara rreptësisht me ligj.

Sipas botimit të “Accountancy Europe” të vitit 2022, kjo bën pjesë në financimin nga buxheti i shtetit/tarifat nga audituesit/shoqëritë e auditimit, megjithëse me një kusht që thotë se fondet nga buxheti i shtetit jepen vetëm në qoftë se është nevoja.

### Tregu i auditimit

- ✦ 4 950 auditues ligjorë, përfshirë 2 557 auditues ligjorë ushtrues të profesionit (më 31 dhjetor 2023)
- ✦ 1 231 shoqëri auditimi (më 31 dhjetor 2023)
- ✦ 58 shoqëri auditimi të NJEIP-ve (më 31 dhjetor 2022)
- ✦ 1 230 NJEIP (më 31 dhjetor 2022)

<sup>82</sup> Shih <https://www.ifac.org/about-ifac/membership/profile/poland>

<sup>83</sup> Shih <http://www.ifiar.org/?wpdmdl=16811>

<sup>84</sup> Shih <https://pana.gov.pl/>

## Slovenia

### Burimet

Informacionet janë marrë nga FNK,<sup>85</sup> IFIAR<sup>86</sup> dhe nga faqja e Agjencisë së Mbikëqyrjes Publike të Auditimit (APOA).<sup>87</sup>

### Përgjegjësia për legjislacionin

APOA varet nga Ministri i Financave dhe është organ i pavarur, i ngritur në vitin 2008 me Ligjin për Auditimin (ZRev-2).

### Vendndodhja e OMA-s

APOA është person juridik sipas së drejtës publike dhe është organ i pavarur dhe autonom në kryerjen e detyrave të veta. Organet e Agjencisë janë këshilli i ekspertëve dhe drejtori, që emërohen dhe shkarkohen nga Qeveria e Republikës së Sllovenisë, me propozim të ministrit të financave.

Sipas raportit të "Accountancy Europe" të vitit 2022, organi sloven i mbikëqyrjes është organ autonom më vete.

### Drejtimi i brendshëm i Organit të Mbikëqyrjes së Auditimit

Këshilli i Ekspertëve ka nëntë anëtarë.

### Delegimi i detyrave

APOA ka detyrën e drejtpërdrejtë të mbikëqyrjes publike të profesionit të auditimit dhe të rregullimit

të auditimit, si dhe të rregullimit të profesionit të vlerësimit në Slloveni.

APOA është përgjegjës për regjistrimin e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit.

### Burimet dhe financimi

Raporti i "Accountancy Europe" i vitit 2022 thotë se Sllovenia financohet përmes fondeve shtetërore dhe tarifave të vendosura drejtpërdrejt mbi audituesit/shoqëritë e auditimit.

Financimi i detyrave të APOA-s sigurohet nga buxheti i shtetit dhe nga shoqëritë e auditimit për veprimtaritë mbikëqyrëse të APOA-s (afro 60% buxheti i shtetit, 40% shoqëritë e auditimit). Ministria e Financave përgatit buxhetin e APOA-s në bazë të kostove të planifikuara të krahut të punës dhe kostove të shërbimeve/materialeve. Punonjësit e APOA-s janë nëpunës civilë. Shoqëritë e auditimit paguajnë taksë në bazë vjetore në përputhje me tabelën e taksave, 0,9% të të ardhurave të tyre vjetore.

APOA është e ndarë në 2 drejtori, ku njëra është drejtorja e inspektimeve dhe e rregullimit, me një ekip prej pesë inspektorësh që inspektojnë me kohë të plotë. Zëvendësdrejtori është kreu i drejtorisë së inspektimeve dhe rregullimit.

### Tregu i auditimit


- ✦ Numri i shoqërive të auditimit: 46
- ✦ Numri i shoqërive të auditimit të NJEIP-ve: 15
- ✦ Numri i auditimeve të NJEIP-ve: 176 (më 31 dhjetor 2023)
- ✦ Numri i auditimeve të tjera ligjore të pasqyrave financiare të veçanta: 2 200

<sup>85</sup> Shih <https://www.ifac.org/about-ifac/membership/profile/slovenia>

<sup>86</sup> Shih <http://www.ifiar.org/?wpdmdl=16589>

<sup>87</sup> Shih <https://www.anr.si/o-agenciji/predstavitev-agencije/>





# Profilet e sistemeve të mbikëqyrjes publike në vendet e Ballkanit Perëndimor

## Shqipëria

### Legjislacioni dhe kuadri i mbikëqyrjes

Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) u krijua në shtator 2009 me Ligjin nr. 10 091, datë 5.3.2009 (i ndryshuar), me të cilin rregullohet profesioni i auditimit në Shqipëri. Krahas kësaj, Vendimi nr. 786 i Këshillit të Ministrave (VKM), datë 9.11.2016, i ndryshuar, përcakton procedurat për përzgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të bordit dhe përshkruan rregullat organizative dhe funksionale të BMP-së.

Objektivi kryesor i BMP-së është përmirësimi i mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit dhe raportimit financiar, nëpërmjet mbajtjes në ndjekje të gjithë audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit dhe nëpërmjet mbikëqyrjes së organizatës profesionale të audituesve

ligjorë dhe organizatave profesionale të kontabilistët të miratuar. Bordi i Mbikëqyrjes Publike ka për mision rritjen e sigurisë që auditimet ligjore kryhen në një mjedis transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik.

Në vitin 2016 dhe përsëri në vitin 2024 janë bërë shtesa dhe ndryshime të konsiderueshme në legjislacionin e auditimit, për të fuqizuar ndjeshëm kapacitetet e MPB-së në aspektin e burimeve njerëzore dhe financiare, efikasitetit operativ dhe kompetencave të mbikëqyrjes. Këto ndryshime kanë përmirësuar sidomos inspektimet e kontrollit të cilësisë bazuar në rrezik, procedurat hetimore, mekanizmat disiplinore dhe autoritetin e përgjithshëm rregullator. Prej janarit 2025, pas miratimit të kuadrit të delegimit, MPB-ja i ka deleguar IEKA-s detyrën e kryerjes së inspektimeve të kontrollit të cilësisë së audituesve dhe shoqërive të auditimit që u japin shërbime njësive ekonomike pa interes publik (jo-NJEIP).

Ndryshimet dhe shtesat e fundit, të miratuara në Kuvend më 19 dhjetor 2024, kanë fuqizuar dispozitat për pavarësinë e audituesit, mbikëqyrjen e kontrollit të cilësisë, rolin e BMP-së në përcaktimin e standardeve rregullatore, kompetencat për vendosjen e sanksioneve dhe bashkëpunimin ndërinstitucional. Këto përmirësime legjislative fuqizojnë më tej pavarësinë dhe autoritetin e BMP-së, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien përmes mekanizmave të përmirësuar të raportimit.

Nga viti 2018 deri në vitin 2024, është konsoliduar dhe përmirësuar në mënyrë progresive kuadri rregullator për licencimin dhe regjistrimin, inspektimet e kontrollit të cilësisë, masat shtrënguese dhe disiplinore dhe monitorimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Përditësimet e mëtejshme të këtij kuadri do të bëhet në përputhje me ndryshimet e fundit në ligjin për auditimin, për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm në efektivitetin e mbikëqyrjes.

## Drejtimi i brendshëm

BMP përbëhet nga pesë jo ushtrues të profesionit me njohuri eksperti në fushat e lidhura me auditimin ligjor, të emëruar nga Ministri i Financave. Kryetari dhe tre anëtarë emërohen nga Ministri i Financave, përfshirë një person të përzgjedhur nga institucionet e arsimit të lartë, dhe një anëtar propozohet nga komisioni parlamentar përgjegjës për ekonominë dhe financat. Anëtarët e bordit duhet të kenë përvojë profesionale në juridik, kontabilitet dhe auditim dhe emërohen nga Ministri i Financave. Dispozitat e VKM-së rregullojnë procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe rregullat për organizimin dhe funksionimin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Shtesat dhe ndryshimet e fundit të ligjit për auditimin e kanë përcaktuar BMP-në si një autoritet rregullator të pavarur me statusin e personit juridik publik.

## Inspektimet

BMP-ja ka një ekip inspektimi të përbërë nga tre Inspektorë të lartë të kontrollit të cilësisë, me kohë të plotë. Këta inspektorë kanë përvojë të gjerë në

auditim, raportim financiar dhe fusha të lidhura me to, dhe ruajnë pavarësinë nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit. Inspektimet bëhen në mënyrë transparente dhe në mjedis të kontrolluar për t'i shërbyer interesit publik.

Objektivi parësor i inspektimeve është të sigurojë dhe të nxisë përmirësime në cilësinë e auditimit, në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullatore. Shqyrtimet e cilësisë së auditimit vlerësojnë punën, procedurat dhe politikat e audituesve, duke e vënë theksin sidomos te auditimet që kanë të bëjnë me njësitë ekonomike me interes publik (NJEIP).

Shoqëritë e auditimit dhe angazhimet specifike të auditimit përzgjidhen për inspektim përmes një procesi përzgjedhjeje të bazuar në rrezik. Metodologjia e inspektimit përfshin dy komponentë kryesorë: vlerësimi i sistemit të administrimit të cilësisë së një shoqërie auditimi, i hartuar në bazë të Metodikës së Përbashkët për Inspektimin e Auditimit, të publikuar nga Komiteti i Organeve Europiane të Mbikëqyrjes së Auditimit (KOEMA), dhe shqyrtimi i bazuar në rrezik i dosjeve të angazhimeve të veçanta të auditimit. Kjo metodologji inspektimi është hartuar në bashkëpunim me konsulentë të huaj dhe përpunohet vazhdimisht mbështetur në përvojat praktike të fituara gjatë procesit të inspektimit.

## Sanksionet dhe masat disiplinore

BMP-ja është organi kompetent për vendosjen e sanksioneve dhe masave disiplinore ndaj audituesve, megjithëse janë organizatat profesionale që kryejnë proceset hetimore dhe i propozojnë BMP-së masat përkatëse disiplinore. BMP-ja ka ngritur Komisionin e Investigimit dhe Disiplinës, që vepron në bazë të Ligjit për Auditimin dhe Rregullores nr. 4, datë 29.3.2018 "Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore", të ndryshuar.

Sipas nenit 55 të Ligjit për Auditimin, sanksionet që mund të aplikohen ndaj audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit janë këto:

0. vërejtje, nëpërmjet së cilës personit fizik ose personit juridik përgjegjës për shkeljen i kërkohet të ndërpresë shkeljen dhe të mos e përsërisë atë në të ardhmen;

1. vërejtje me shkrim në regjistrin publik, duke përcaktuar personin përgjegjës dhe natyrën e shkeljes;
2. dënim me gjobë në masën nga 0,5% deri në 3% të qarkullimit vjetor të periudhës raportuese paraardhëse;
3. pezullim i përkohshëm nga një deri në tre vjet, që ndalon:
  - a. audituesin ligjor, shoqërinë audituese ose ortakun kryesor të auditimit të kryejë auditim ligjor dhe/ose të nënshkruajë raporte të auditimit ligjor; ose
  - b. audituesin ligjor, shoqërinë audituese ose ortakun kryesor të qëndrueshmërisë të kryejë dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë dhe/ose nënshkrimin e raportit të dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë.
4. pezullim i përkohshëm nga një deri në tre vjet, që ndalon anëtarët e një shoqërie auditimi apo të një organi administrativ ose drejtues të një njësie ekonomike me interes publik të ushtrojnë funksione në shoqëritë audituese ose në njësitë ekonomike me interes publik;
5. heqja e së drejtës për ushtrimin e profesionit, çregjistrimi i audituesit ligjor nga regjistri publik dhe humbja e së drejtës së reregjistrimit.
3. Hetimi dhe sanksionimi: Miraton rregullat për hetimin dhe procedurat disiplinore; Zhvillon hetime shtesë ndaj audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, sipas nevojës; Analizon dhe vendos për çështjet disiplinore brenda kompetencave të tij;
4. Raportimi dhe transparenca: Harton dhe miraton pasqyrat e veta financiare në përputhje me kuadrin përkatës të raportimit financiar; Miraton dhe publikon programet vjetore të punës dhe raportet e veprimtarisë dhe raporton për to para Kuvendit; Shqyrton dhe merr vendime për çështje brenda objektit ligjor; Përzgjedh dhe miraton audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit për pasqyrat e veta financiare;
5. Funksionet rregullatore: Nxjerr akte, që janë rregullat, rregulloret, urdhrat, udhëzimet, manualët apo metodologjitë, për përmbushjen e funksioneve rregullatore dhe mbikëqyrëse; Shpall të detyrueshme standardet profesionale të zbatueshme nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit, të cilat botohen në Fletoren Zyrtare;
6. Bashkëpunimi ndërinstitucional: Miraton aktet rregullatore lidhur me bashkëpunimin e shkëmbimin e informacionit ndërinstitucional brenda dhe jashtë vendit.

## Përgjegjësi të tjera të BMP-së

Krahas inspektimeve dhe masave disiplinore, BMP-ja ka edhe këto kompetenca dhe përgjegjësi:

1. Mbikëqyrja e certifikimit dhe regjistrimit të kryer nga IEKA: Harton rregullat për certifikimin dhe regjistrimin e audituesve; Mbikëqyr zbatimin e procedurave të certifikimit dhe regjistrimit; Vendos për pretendimet e kandidatëve në lidhje me regjistrimin; Miraton formatin e regjistrit publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit;
2. Standardet profesionale të auditimit dhe të etikës: Miraton dhe mbikëqyr kodit etik për audituesit ligjorë; Mbikëqyr procesin e kontrollit të cilësisë dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të zhvilluar nga organi profesional i audituesve ligjorë;

## Delegimi

BMP-ja ka miratuar rregullat për delegimin të IEKA të inspektimeve të audituesve të njësive ekonomike pa interes publik. IEKA zbaton edhe kërkesat e certifikimit, regjistrimit dhe AVP-së së audituesve, nën mbikëqyrjen e BMP-së.

## Financimi

BMP-ja financohet nga: 3 për qind e tarifës së auditimit, të paguar nga audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të angazhuara në auditime në njësive ekonomike me interes publik; fonde të tjera në masën jo më shumë se 10% si kontribut i organizatave profesionale objekt i mbikëqyrjes nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike; shumat që u ngarkohen audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, objekt i masave disiplinore, për të mbuluar shpenzimet e

procedurave disiplinore, të cilat vendosen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike; fonde të rishpërndara nga procesi i provimit profesional; fonde të tjera, nga burime të ligjshme, të pandikuara nga audituesit ligjorë, përfshirë, ndër të tjera, grantet e akorduara në kuadër të sigurimit të cilësisë dhe mbikëqyrjes së profesionit. Ligji për auditimin parashikon edhe financim nga Buxheti i Shtetit, por BMP-ja e ka ruajtur pavarësinë financiare.

## Tregu i auditimit

Në Shqipëri, ka 71 shoqëri auditimi dhe 143 auditues si persona fizikë, të cilët janë objekt inspektimi nga BMP-ja. Në vitin 2024, janë raportuar 3 784 njësi ekonomike të audituara, ku 1 006 janë NJEIP, nga të cilat 87 njësi ekonomike janë institucione financiare (bankë dhe jo bankë). Përgjegjësia mbikëqyrëse për inspektimet e auditimeve të NJEIP-ve i mbetet BMP-së. Mbi 2 778 njësi ekonomike nuk janë NJEIP dhe inspektimet e auditimeve të tyre janë kompetencë e BMP-së.

6 shoqëritë më të mëdha të auditimit, sa u përket të ardhurave, zënë rreth 43% të tregut të auditimit të shoqërive me interes publik, 57% e audituesve janë shoqëri të tjera/persona fizikë, kryesisht shoqëri vendase.

### Sfidat kryesore

- ✦ Përmirësimi i cilësisë së auditimit.
- ✦ Fuqizimi i masave shtrënguese.
- ✦ Rritja e efektivitetit organizativ

## Bosnjë-Hercegovina

Analiza më e fundit e Komisionit Evropian lidhur me përmbushjen<sup>88</sup> e kërkesave legislative të BE-së në fushën e mbikëqyrjes publike të auditimit në Bosnjë dhe Hercegovinë thotë se:

*“Ende nuk ka një autoritet të vetëm në të gjithë vendin për mbikëqyrjen e audituesve ligjorë.” dhe*

*“Bosnjë-Hercegovina ende nuk ka caktuar, në përputhje me kërkesat e Acquis-së së BE-së, një autoritet të vetëm mbikëqyrës me kompetencë në të gjithë vendin, përgjegjës për mbikëqyrjen e audituesve ligjorë.”*

Në tetor 2024, me mbështetjen e programit rajonal REPARIS për NVM-të, ka filluar një dialog mes palëve kryesore të interesit në vend. Qëllimi kryesor ishte shqyrtimi i mundësive për krijimin e një autoriteti të vetëm mbikëqyrës me kompetencë në të gjithë vendin, përgjegjës për mbikëqyrjen e auditimeve dhe audituesve ligjorë, duke mbajtur parasysh strukturën rregullatore dhe institucionale të vendit, në përputhje me kërkesat e Acquis-së së BE-së. Megjithëse pjesëmarrësit pranuan nevojën për përafrim më të mirë me Acquis-në e BE-së, sidomos në nivel vendi, u theksua se, krahas vendimeve politike, duhej të merrnin zgjidhje disa kufizime ligjore dhe aspekte politike.

Megjithëse aktualisht nuk ka një autoritet kompetent të caktuar në nivel shteti, ekzistojnë funksione mbikëqyrëse të auditimit në nivelin e entiteteve. Federata e Bosnjë-Hercegovinës, Republika Serbe dhe Distrikti i Bërçkës kanë kuadrin ligjor dhe institucional secila, në lidhje me kontabilitetin dhe auditimin, përfshirë mbikëqyrjen publike, diku më shumë e diku më pak. Secili prej këtyre entiteteve analizohet më poshtë; megjithatë, ato nuk e përmbushin kërkesën legislative të BE-së për një autoritet kompetent të caktuar me përgjegjësi të fundme për mbikëqyrjen e audituesve dhe shoqërive të auditimit në nivel shteti.

## Federata e Bosnjë-Hercegovinës

### Legjislacioni

Sipas Ligjit për Kontabilitetin dhe Auditimin të Federatës, Ministria e Financave e Federatës ka përgjegjësinë e fundme për mbikëqyrjen publike të auditimit në Federatë. Ndër detyrat e Ministrisë së Financave janë: i. licencimi i shoqërive të auditimit dhe audituesve të autorizuar; ii. mbajtja e regjistrave të shoqërive të licencuara të auditimit dhe audituesve të autorizuar; dhe iii. ndjekja e punës së audituesve, shoqërive të auditimit dhe profesionistëve të kontabilitetit. Ministria e Financave e Federatës cakton

<sup>88</sup> Shih [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/e3045ec9-f2fc-45c8-a97f-58a2d9b9945a\\_en?filename=SWD\\_2023\\_691%20Bosnia%20and%20Herzegovina%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/e3045ec9-f2fc-45c8-a97f-58a2d9b9945a_en?filename=SWD_2023_691%20Bosnia%20and%20Herzegovina%20report.pdf)

“Komitetin e Mbikëqyrjes Publike të Dhomës [së Audituesve], shoqërive të auditimit dhe audituesve të autorizuar të licencuar në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës” si organin mbikëqyrës të auditimit në Federatë. Komiteti i Mbikëqyrjes Publike (KMP) është themeluar me këtë legjislacion dhe rregullore:

1. Vendim i Qeverisë së Federatës së Bosnjë-Hercegovinës, nr. V.1163/2022, datë 28 korrik 2022. (Fletorja Zyrtare e Federatës së Bosnjë-Hercegovinës, numri: 61/22). Ligji për Kontabilitetin dhe Auditimin (Fletorja Zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës, numri 42/04).
2. Neni 66 i Ligjit për Kontabilitetin dhe Auditimin në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës (Fletorja Zyrtare e Federatës BH, numri 15/21).
3. Rregullorja për mënyrën dhe kushtet e dhënies dhe heqjes së licencave për audituesit e autorizuar dhe shoqëritë e auditimit (Fletorja Zyrtare e Federatës së Bosnjë-Hercegovinës, Nr. 28/21),
4. Rregullorja e brendshme e Bordit.

Komiteti i Mbikëqyrjes Publike bën pjesë në Ministrinë e Financave. Ky komitet ka për detyrë miratimin e standardeve të etikës profesionale, kontrollin e brendshëm të cilësisë së punës së auditimit dhe shoqërive të auditimit dhe zbatimin e arsimit të vazhdueshëm, sigurimit të cilësisë dhe disiplinës në sistem; Ai mbikëqyr nga afër edhe punën e Dhomës së Audituesve.

### Drejtimi i brendshëm

Neni 98 i Ligjit për Kontabilitet dhe Auditim përcakton kriteret dhe përbërjen për anëtarët e Komitetit të Mbikëqyrjes Publike. Komiteti përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë. Anëtarët emërohen nga Qeveria me propozim të Ministrit të Financave. Anëtarët emërohen me mandat katërvjeçar, i cili mund të rinovohet vetëm një herë. Anëtarët duhet të kenë pesë vjet përvojë në fushat e kontabilitetit dhe financave dhe të mos jenë ushtrues të profesionit të auditimit për të paktën tre vjet para emërimit. Një anëtar duhet të ketë pesë vjet përvojë në auditim. Detyrat administrative në funksion të Komitetit të Mbikëqyrjes Publike kryhen nga Ministria e Financave.

### Inspektimet

Ministria e Financave dhe KMP-ja hë për hë nuk kryejnë inspektime të pavarura të audituesve të NJEIP-ve, siç e kërkon legjislacioni i BE-së. Ngritja e një programi inspektimi për këtë do të ishte një hap kyç përpara në përmbushje të kërkesave të BE-së. Komiteti mbikëqyr nga afër inspektimet e kryera nga Dhoma e Audituesve.

### Sanksionet

Kur Dhoma e Audituesve konstaton se shoqëria e auditimit objekt i kontrollit nuk i korrigjon mangësitë e konstatuara në një inspektim brenda afatit të caktuar, Dhoma i paraqet Komitetit të Mbikëqyrjes Publike një raport mbi inspektimin së bashku me propozimin për sanksione. Komiteti i Mbikëqyrjes Publike mund t'i propozojë Ministrisë këto sanksione:

1. dhënie urdhri për korrigjim të parregullsive;
2. vendosje sanksionesh shtesë;
3. revokimi me kusht i licencës së auditimit, me justifikim të mjaftueshëm;
4. revokimi i licencës për kryerjen e auditimit, me justifikim të mjaftueshëm.

Kundër vendimit për vendosjen e sanksioneve mund të bëhet ankim administrativ.

### Detyra shtesë

Komiteti i Mbikëqyrjes Publike bashkëpunon me autoritetet kompetente në Republikën Serbe, Distriktin e Bërçkës, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe vendet e treta, sidomos në lidhje me parregullsitë në veprimet e shoqërive të auditimit dhe audituesve të autorizuar.

### Delegimi

Disa detyra mbikëqyrëse i delegohen Dhomës së Audituesve, për shembull disa veprimtari inspektimi. Në 2023 dhe 2024, Dhoma kreu mbikëqyrje të vazhdueshme me anë të inspektimit të raporteve të auditimit dhe me anë të mbikëqyrjes në përputhje

me urdhrat ose raportet e KMP-së. Metodologjia e mbikëqyrjes së kontrollit të cilësisë e Dhomës së Audituesve merr në konsideratë, gjatë përzgjedhjes së shoqërive të auditimit për shqyrtim, faktorët kryesorë të rrezikut. Këta faktorët rreziku janë:

- ✦ Problemet e identifikuara në kontrollet e mëparshme;
- ✦ numri i angazhimeve të auditimit, në veçanti auditimet e NJEIP-ve;
- ✦ numri i audituesve në raport me numrin e angazhimeve të auditimit; dhe
- ✦ koha që ka kaluar nga shqyrtimi i fundit.

## Financimi

Komiteti financohet nga buxheti i Federatës.

## Tregu i auditimit

Në Federatë ka 101 shoqëri auditimi. Mbi 80% e tregut ndahet mes 36 shoqërive të auditimit. Kjo përfshin tri shoqëri të rrjeteve ndërkombëtare, të cilat së bashku zënë 28,5% të tregut, në bazë të ardhurave nga shërbimet e auditimit.

## Republika Serbe

### Legjislacioni

Ligji për Kontabilitetin dhe Auditimin i Republikës Serbe (Fletorja Zyrtare e Republikës Serbe, numri 94/15, 78/20) dhe Udhëzimi për kryerjen e mbikëqyrjes (Fletorja Zyrtare e Republika Serbe 3/25, datë 17 janar 2025) parashikojnë mbikëqyrjen e auditimit në Republikën Serbe. Sipas Ligjit, Ministria e Financave e Republikës Serbe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e audituesve dhe shoqërive të auditimit që bëjnë auditime ligjore, përfshirë edhe detyrën e sigurimit të cilësisë. Ministria e Financave vëren se jo të gjitha dispozitat e Direktivës së BE-së janë transpozuar në Ligjin e Republikës Serbe, por po punohet më tej për ta arritur këtë.

Kërkesat specifike të Rregullores së BE-së për mbikëqyrjen e auditimit në lidhje me audituesit e NJEIP-ve nuk janë transpozuar ende, përfshirë kërkesat shtesë në lidhje me tarifën e auditimit,

ndalimet për ofrimin e shërbimeve jo auditim, angazhimet për shqyrtimin e kontrollit të cilësisë, raportin e auditimit dhe raportin shtesë për komitetin e auditimit, raportet e transparencës dhe emërimin e audituesve ligjorë ose të shoqërive të auditimit.

## Drejtimi i brendshëm

Mbikëqyrja e veprimtarisë së shoqërive të auditimit bëhet nga Këshilli për Kontabilitet dhe Auditim, një organ i emëruar nga Ministri i Financave. Këshilli ka pesë anëtarë, prej të cilëve katër anëtarë mbajnë titullin profesional të audituesit të autorizuar, kanë të paktën pesë vjet përvojë pune në auditim, nuk janë të punësuar në shoqëri auditimi dhe nuk kanë konflikte interesi në kryerjen e mbikëqyrjes publike.

Anëtarët e keshillit i përzgjedh ministri i financave.

## Inspektimet

Ministria e Financave ka filluar ngritjen e një programi për inspektimin e shoqërive të auditimit dhe ka kryer një analizë fillestare të tregut të auditimit dhe audituesve. Pasi të vihet plotësisht në efiçencë, ky program inspektimi do të jetë një hap i rëndësishëm përpara në përmbushje të kërkesave legislative të BE-së. Inspektimet bëhen sipas Udhëzimeve për Kryerjen e Mbikëqyrjes, që përdorin këta faktorë rreziku: sektori në të cilin ushtron aktivitet shoqëria tregtare (institucion financiar dhe ndërmarrje me rëndësi për ekonominë e Republikës Serbe); të ardhurat nga veprimtaria e shfrytëzimit gjithsej të shoqërisë që auditohet; numri i punonjësve; dhe rreziku i reputacionit.

Ministria e Financave ka nisur një program për inspektimin e shoqërive të auditimit, që deri më sot ka kryer analizën e tregut të auditimit dhe audituesve, ka përgatitur një metodologji të re si bazë për kryerjen e mbikëqyrjes dhe ka kryer mbikëqyrje të vazhdueshme, ku përfshihet shqyrtimi i kontratave, raporteve të transparencës dhe dokumenteve të tjera të kërkuara me ligj. Për audituesit dhe shoqëritë e auditimit pa mangësi të konsiderueshme, Ministria e Financave ka lënë rekomandime me afate kohore për korrigjime. Rekomandime të tilla iu dhanë 25 shoqërive të auditimit dhe audituesve. Për shoqëritë e auditimit dhe njësitë ekonomike me gjetje të rëndësishme të zbuluara gjatë mbikëqyrjes së vazhdueshme, Ministria



e Financave do të zhvillojë veprimtari të mëtejshme mbikëqyrëse specifike. Programi ende vijon.

### Përgjegjësi të tjera

Ministria e Financave e Republikës Serbe licencon audituesit dhe lëshon leje për punën e shoqërive të auditimit. Ministria e Financave administron edhe regjistrin e audituesve dhe shoqërive të auditimit.

### Delegimi

Certifikimi i audituesve kryhet nga shoqata profesionale - Shoqata e Kontabilistëve dhe Audituesve të Republikës Serbe.

### Financimi

Financimi i mbikëqyrjes publike vjen nga buxheti i Republikës Serbe.

### Tregu i auditimit

Në Republikën Serbe ka 38 shoqëri auditimi me seli në territorin e saj. 24 janë nga Republika Serbe, 12 nga Federata dhe 2 nga Distrikti i Bërçkës.

## Distrikti i Bërçkës

### Legjislacioni

Drejtorja e Financave e Distriktit të Bërçkës është krijuar në 2007 me Ligjin për Drejtorinë e Financave të Distriktit të Bërçkës të Bosnjë-Hercegovinës. Kjo drejtori ka detyrën e mbikëqyrjes së auditimit në Distriktin e Bërçkës. Sipas Ligjit për Kontabilitetin dhe Auditimin të Distriktit të Bërçkës, Drejtorja e Financave ka ngritur Këshillin për Kontabilitetin dhe Auditimin të Distriktit të Bërçkës. Ky këshill ka për qëllim monitorimin e zbatimit të standardeve të kontabilitetit dhe auditimit në Distrikt.

Ai synon ndër të tjera përmirësimin dhe zhvillimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit; zbatimin

e rregullave ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit si dhe harmonizimin me standardet e përcaktuara nga Komisioni Europian; dhe mbrojtjen e interesit të përgjithshëm dhe individual në kryerjen e detyrave në fushën e auditimit.

### Drejtimi i brendshëm

Këshilli ka 7 anëtarë - një anëtar nga radhët e profesorëve të universitetit, që është profesor i rregullt në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, dy punonjës të Drejtorisë, dy anëtarë nga radhët e punonjësve të Zyrës së Kontrollit të Administratës Publike dhe Institucioneve, dhe dy anëtarë të tjerë që, me përvojën e tyre praktike dhe teorike në fushën përkatëse, mund të kontribuojnë për një punë më efikase të Këshillit.

### Inspektimet

Këshilli për Kontabilitet dhe Auditim duhet të inspektojë punën e shoqërive të autorizuara për auditim me seli në Distriktin e Bërçkës të Bosnjë-Hercegovinës të paktën një herë në pesë vjet. Kjo mbikëqyrje duhet bërë duke punësuar persona juridikë që posedojnë kualifikimet profesionale të nevojshme për të kryer detyra mbikëqyrjeje. Megjithatë, ende nuk janë siguruar burime financiare për zbatimin e mbikëqyrjes dhe, për rrjedhojë, nuk është kryer asnjë mbikëqyrje.

### Përgjegjësi të tjera

Drejtorja e Financave mban regjistrin e audituesve të autorizuar.

### Financimi

Ende nuk janë siguruar fonde për të zbatuar inspektime auditimi ose elemente të tjera të mbikëqyrjes në Distriktin e Bërçkës.

### Tregu i auditimit

Në Distrikt ka 21 shoqëri auditimi të autorizuara.



**Sfidat kryesore**

- ✦ Ngritja e një autoritet unik mbikëqyrjeje me tagër për të gjithë vendin për mbikëqyrjen e audituesve ligjorë.
- ✦ Ngritja e funksioneve të inspektimit të auditimit me burime të mira dhe me kompetenca të përshtatshme sanksionuese për të inspektuar të gjithë audituesit e NJEIP-ve me cikël trevjeçar.
- ✦ Kapërcimi i vështirësive në burimet dhe gatishmërinë e kufizuar të financimit dhe personelit të kualifikuar dhe me përvojë të përshtatshme për të kryer inspektime.

**Kosova****Legjislacioni**

Ligji nr. 06/L-032 “Për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim” hyri në fuqi në vitin 2019 dhe është modeluar sipas Direktivës së BE-së për Auditimin. Ky ligj kërkon krijimin e një sistemi të pavarur të mbikëqyrjes publike për të monitoruar cilësinë e auditimeve të NJEIP-ve. Ligji parashikonte ngritjen e OMA-s, që është Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF). KKRF-ja rregullon profesionin e auditimit dhe kontabilitetit në Kosovë.

KKRF-ja bën pjesë praktikisht në Ministrinë e Financave.

Sipas Ligjit Nr. 06/L-032 “Për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim”, KKRF-ja ka këto detyra:

- ✦ mbikëqyr zbatimin e Ligjit dhe akteve nënligjore të miratuara në përputhje me Ligjin, si dhe ndërmerr veprime për mbikëqyrjen e zbatimit të tij dhe masat disiplinore për zbatimin e parregullt;
- ✦ miraton SNK-të në përputhje me SNK-të e miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe me legjislacionin përkatës të BE-së;
- ✦ miraton, mbikëqyr dhe zbaton standardet e auditimit në përputhje me SNA-të dhe legjislacionin përkatës të BE-së;
- ✦ licencon, mban dhe publikon regjistrin e audituesve, shoqërive të auditimit dhe shoqatave;
- ✦ miraton standardet për etikën profesionale, kontrollin e brendshëm të cilësisë së shoqërive të auditimit;
- ✦ konfirmon certifikatat ndërkombëtare të audituesve dhe kontabilistëve.

Të gjithë audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit janë objekt i mbikëqyrjes publike nga KKRF-së. KKRF-ja ka përgjegjësinë e fundme për kontrollin e cilësisë së auditimit dhe për sistemet hetimore dhe disiplinore administrative. Ai ngre Bordin e Mbikëqyrjes Publike, që funksionon si organ ekzekutiv i KKRF-së. Bordi ka përgjegjësinë për mbikëqyrjen e:

1. Arsimit të vazhdueshëm;
2. Sistemeve të sigurimit të cilësisë; dhe
3. Sistemeve disiplinore administrative dhe hetimore.

Analiza më e fundit e Komisionit European lidhur me përmbushjen e kërkesave legjislative të BE-së në fushën e mbikëqyrjes publike të auditimit në Kosovë gjendet në faqen e KE-së.<sup>89</sup>

**Drejtimi i brendshëm**

Organi i mbikëqyrjes publike drejtohet nga një shumicë personash të cilët nuk e ushtrojnë profesionin e të cilët kanë njohuri në fushat e lidhura me auditimin ligjor. Kandidatët për anëtarë të bordit përzgjidhen sipas një procedure të pavarur dhe transparente, të përcaktuar me akt nënligjor nga KKRF-ja. Bordi i Mbikëqyrjes Publike përbëhet nga 5 anëtarë. Dy anëtarë janë nga KKRF-ja, dy anëtarë janë nga organizatat (shoqatat) e kontabilitetit dhe një anëtar emërohet nga Banka Qendrore e Kosovës (që nuk është anëtar në KKRF). Kreu i Bordit emërohet nga KKRF-ja. Bordi jep llogari para KKRF-së me raportime të rregullta mbi aktivitetet e tij.

<sup>89</sup> Shih [https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10\\_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/c790738e-4cf6-4a43-a8a9-43c1b6f01e10_en?filename=Kosovo%20Report%202024.pdf)

## Inspektimet

Rregullat e KKRF-së kërkojnë sa vijon në lidhje me inspektimet e shoqërive të auditimit dhe audituesve:

Të gjitha inspektimet dhe kontrollet e cilësisë mbështeten me testimet e duhura të dosjeve të auditimit, që duhet të përmbajnë një vlerësim të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe kërkesat për pavarësinë e audituesit, sasinë dhe cilësinë e burimeve të shpenzuara për auditimin, si dhe koston e auditimit. Inspektimet duhet të kenë një raport me përfundime.

Bordi i Mbikëqyrjes Publike mban përgjegjësinë e fundme në lidhje me kontrollin e cilësisë së audituesve dhe shoqërive të auditimit dhe në lidhje me hetimin dhe disiplinën.

- ✦ Për të siguruar që inspektorët të kenë kapacitet të mjaftueshëm dhe ndërthurjen e duhur të arsimit dhe përvojës, Bordi do të punësojë shqyrtues të cilësisë me këto kualifikime: a) të jetë auditues i autorizuar i cili nuk e ka ushtruar profesionin tre vitet e fundit; b) të ketë së paku katër vjet përvojë në auditim në një shoqëri auditimi të licencuar; c) të ketë dëshmuar aftësi për të vlerësuar gjykimet profesionale të bëra nga audituesit; d) të ketë paprekshmëri dhe formim etik të padyshimtë; dhe e) të mos ketë konflikt interesi.
- ✦ Për të siguruar kapacitet të mjaftueshëm kur bëhet fjalë për çështje komplekse, Bordi mund të vendosë që është e nevojshme të angazhojë ekspertë të jashtëm, të cilët mund të përfshijnë auditues ushtrues të profesionit. Në këtë rast, ekspertëve nuk u lejohet të marrin vendime dhe nuk duhet të kenë konflikt interesi me çështjen ose subjektin që po shqyrtohet.

KKRF-ja kohët e fundit ka filluar një program inspektimesh, me mbështetjen e Bankës Botërore. Megjithatë, aktualisht KKRF-ja nuk punëson asnjë ekip të përhershëm inspektorësh. Ngritja e një ekipi të tillë është çelësi i përmbushjes së kërkesave të BE-së. Megjithatë, kufizimet e fondeve dhe burimeve përbëjnë një sfidë për formimin e ekipit. KKRF-ja përdor një procedurë përzgjedhjeje të bazuar në rrezik për inspektimet, me faktorë kyç të rrezikut, përfshirë

strukturën e shoqërisë së auditimit; pjesën që zë në treg audituesi; dhe përqindjen e angazhimeve me NJEIP.

KKRF-ja do të raportojë mbi rezultatet e inspektimeve sapo programi i inspektimit të jetë plotësisht funksional.

## Sanksionet

KKRF-ja ka përgjegjësinë e fundme në lidhje me kontrollin e cilësisë së audituesve dhe shoqërive të auditimit dhe në lidhje me hetimin dhe disiplinën. Një pjesë e kësaj përgjegjësie përfshin zbatimin me forcë. Ky zbatim me forcë bëhet me anë të metodologjisë në fuqi të miratuar nga KKRF-ja.

## Delegimi

Në Kosovë nuk bëhet delegim i inspektimit të audituesve. Organizatat profesionale të kontabilitetit në Kosovë kanë përgjegjësi të kufizuar vetëm për kryerjen e kontroleve të cilësisë së anëtarëve të tyre, por jo për kontrollin e cilësisë së audituesve dhe shoqërive të auditimit (sidomos për shoqëritë e auditimit të angazhuara për kryerjen e auditimit të një NJEIP-je).

## Financimi

KKRF-ja aktualisht financohet 100% nga buxheti i shtetit të Kosovës. Për më tepër, mund të merren fonde përmes tarifave të licencimit.

## Tregu i auditimit

Ka rreth 24 shoqëri auditimi dhe 69 auditues të licencuar që bien në fushëveprimin e KKRF-së/Bordit të Mbikëqyrjes Publike, me rreth 725 auditime të njëjësive ekonomike me interes publik që janë pjesë e fushëveprimit dhe detyrës së Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

### Sfidat kryesore

- ✦ KKRF-ja duhet të vazhdojë të bëjë përpara drejt vendosjes dhe përfundimit të raundit të parë të inspektimeve të auditimit të gjithë audituesve të NJEIP-ve në Kosovë.
- ✦ Për të ecur përpara, pengesa kryesore mbetet gatishmëria e kufizuar e burimeve.

## Mali i Zi

### Legjislacioni

Ligji për Auditimin (Fletorja Zyrtare e Malit të Zi, Nr. 1/17) rregullon auditimin e jashtëm dhe përmban dispozitat për funksionimin e sistemit të mbikëqyrjes publike të auditimit në Malin e Zi. Nenet 34-45 të Ligjit përshkruajnë arkitekturën e sistemit të mbikëqyrjes publike dhe detyrat e tij. Rregullat për mbikëqyrjen publike përbëhen nga një akt për emërimin e anëtarëve të bordit dhe një rregullore për funksionimin e bordit e mbikëqyrjes së auditimit (domethënë Këshilli i Auditimit).

Ministria e Financave ka detyrën e mbikëqyrjes së auditimit; ajo ka krijuar një sistem me dy nivele të Këshillit të Auditimit dhe Degës së Mbikëqyrjes së Auditimit. Sistemi u krijua në vitin 2017 dhe funksionoi në mënyrë efektive përveç një ndërprerjeje të operacioneve midis viteve 2021 dhe 2023. Në përputhje me Ligjin për Auditimin, sistemi përfshin:

- ✦ Këshillin e Auditimit prej pesë anëtarësh, udhëhequr nga një kryetar. Kryetari i këshillit është Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për Harmonizimin Qendror dhe Zhvillimin e Kontrolleve të Brendshme në Ministrinë e Financave, që mbikëqyr ndër të tjera Degën e Mbikëqyrjes së Auditimit.
- ✦ Dega e Mbikëqyrjes së Auditimit është sektor në varësi të Drejtorisë për Harmonizim Qendror të Ministrisë së Financave.

Këshilli i Auditimit ka rol këshillues, për të dhënë orientime se si të përmirësohet praktika e auditimit, duke monitoruar zbatimin e standardeve të auditimit, për të dhënë këshilla për të ndihmuar në

përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar dhe për të dhënë opinione të ndryshme mbi aspekte të mbikëqyrjes së auditimit.

Dega e Mbikëqyrjes së Auditimit është ajo që e vë në shfrytëzim sistemin. Kjo përfshin mbajtjen e regjistrit të shoqërive të auditimit dhe audituesve, sigurimin që përmbushen kërkesat e AVP-së dhe kryerjen e inspektimeve të auditimit.

Sistemi i mbikëqyrjes publike të auditimit është pjesërisht i përafëruar me dispozitat e Direktivës së BE-së për Auditimin 2014/56 BE dhe Rregullores së BE-së për Auditimin. Elementet thelbësore të mbikëqyrjes së auditimit përfshihen në Ligjin për Auditimin, përfshirë përcaktimet e roleve dhe përgjegjësi të Ministrisë së Financave, Këshillit të Auditimit si organ këshillimor dhe Degës së Mbikëqyrjes së Auditimit dhe inspektorëve të kontrollit të cilësisë. Mali i Zi ka një projektligj të ri për auditimin, me të cilin transponon të gjitha dispozitat e BE-së që mbeten për t'u transpozuar. Aktualisht është duke u shqyrtuar nga KE-ja.

Analiza më e fundit e Komisionit Europian lidhur me përmbushjen e kërkesave legjislative të BE-së në fushën e mbikëqyrjes publike të auditimit në Malin e Zi gjendet në faqen e KE-së.<sup>90</sup>

### Drejtimi i brendshëm

Sipas Ligjit për Auditimin, shumica e anëtarëve të Këshillit të Auditimit duhet të jenë persona të cilët gjatë tre viteve të fundit para emërimit:

1. nuk marrin pjesë aktive në kryerjen e auditimit;
2. nuk kanë të drejtë vote si ortakë të një shoqërie auditimi;
3. nuk janë anëtarë të organit administrativ ose drejtues të një shoqërie; ose
4. nuk janë punësuar nga një shoqëri auditimi.

### Inspektimet

Sektori i inspektimit pranë Degës së Mbikëqyrjes së Auditimit ka filluar inspektimet e auditimit, me

metodologjinë e inspektimit të vënë në dispozicion në kuadër të programit REPARIS për NVM-të. Modeli është plotësisht në përputhje me SNA-në dhe përputhet me të gjitha kërkesat e Direktivës së BE-së për Auditimin. Ky sektor ka marrë formim për përdorimin e metodologjisë dhe ka përfunduar raundin e parë të inspektimeve, duke kryer inspektime efektive dhe duke nxjerrë një sërë gjetjesh dhe rekomandimesh përkatëse për përmirësim për shoqëritë e inspektuara të auditimit.

## Sanksionet

Sistemi i sanksioneve në Ligjin për Auditimin përcakton gamën e sanksioneve për mosrespektimin e Ligjit. Ligji kërkon përdorimin e SNA-ve, në mënyrë që sanksionet mund të pasojnë gjetjet e inspektimeve për mosrespektimin e SNA-ve, megjithëse inspektimet duhet të përqendrohen te përmirësimi i cilësisë së auditimit në të ardhmen, jo në ndëshkimin prapaveprues së shoqërive të auditimit. Ministria e Financave mund të vendosë gjoka nga 500 deri në 16 500 euro. Neni 53 i Ligjit për Auditimin parashikon sanksione për një shoqëri auditimi që nuk kërkon dhe nuk merr licencën e audituesit. Neni 54 trajton shkeljet e pavarësisë ose të rregullave, mosrespektimin e sigurimit të detyrueshëm, moskomunikimin e ndryshimeve në Ministrinë e Financave, mosparaqitjen e një raporti transparence ose mosmbajtjen e dokumentacionit të auditimit. Përveç kësaj, Ministria e Financave mund të revokojë licencën e audituesit në raste të rënda të mosrespektimit të rregullave. Duket se gjokat janë të pamjaftueshme për të qortuar në mënyrë efektive shoqëritë e mëdha të auditimit që kryejnë auditime joadekuata të NJEIP-ve, ku kërcënimi me heqjen e licencës së auditimit është sanksioni i vetëm efektiv aktualisht. Ligji nuk parashikon kompetenca hetimore ose sanksione të tjera përveç përmes sistemit të sigurimit të cilësisë dhe sanksioneve pasuese të përshkruara më sipër. Kompetenca të tilla janë kërkesë e legjislacionit të BE-së për auditimin. Mali i Zi duhet të kërkojë të zbatojë të tilla kompetenca dhe funksion operativ.

## Detyra shtesë

Ministria e Financave ngre një program arsimimi të vazhdueshëm profesional për audituesit, që

plotësohet nga Instituti i Kontabilistëve të Miratuar. IKM përgatit programin e AVP-së, ia dërgon për mendim Këshillit të Auditimit dhe më pas ia dërgon për miratim Ministrisë së Financave.

## Delegimi

Aktualisht nuk bëhet delegim i funksioneve të inspektimit në ndonjë organizatë profesionale në Malin e Zi. Përgjegjësia për zbatimin e programit të arsimit të vazhdueshëm për audituesit (të përcaktuar nga Ministria e Financave) i është deleguar Institutit të Kontabilistëve të Miratuar. Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Malit të Zi është përgjegjës për miratimin, përkthimin dhe publikimin e Standardeve të Kontabilitetit SNRF, SNA-ve dhe Standardit të Etikës.

## Financimi

Drejtorja për Mbikëqyrjen e Auditimit është ngritur në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme për Harmonizimin Qendror dhe Zhvillimin e Kontrolleve të Brendshme, me buxhetin vjetor të Ministrisë së Financave. Këshilli i Auditimit financohet me fonde të buxhetit të Malit të Zi.

## Tregu i auditimit

Në Malin e Zi janë licencuar të punojnë 29 shoqëri auditimi.

### Sfidat kryesore

- ✦ Mali i Zi duhet të vazhdojë ta zhvillojë programin e inspektimit të audituesve, duke u mbështetur në praktikat më të mira ndërkombëtare sa i takon metodikës dhe realizimit të inspektimit.
- ✦ Mali i Zi do të përfitonte nga shqyrtimi i fashës dhe vlerës së sanksioneve, për t'u siguruar që këto janë të mjaftueshme që të mos ketë shkelje, përpara marrjes së masës ekstreme të gregjistrimit.

## Maqedonia e Veriut

### Legjislacioni

Neni 6 i Ligjit të Auditimit të Maqedonisë së Veriut (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 122/21) ngre Këshillin për Avancimin dhe Mbikëqyrjen e Auditimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut (CAOAC). CAOAC është organ rregullator i pavarur dhe autonom dhe është OMA për Maqedoninë e Veriut.

Në detyrat e CAOAC-së përfshihet dhënia dhe heqja e licencave për audituesit e certifikuar, shoqëritë e auditimit dhe audituesit me praktikë individuale; mbikëqyrja e Institutit të Audituesve të Autorizuar të Republikës së Maqedonisë në kryerjen e detyrave rregullatore; vendosja e masave ndaj audituesve, audituesve të autorizuar (persona fizikë dhe shoqëri auditimi) sipas Ligjit; ngritja e bashkëpunimit me institucionet brenda vendit dhe jashtë vendit dhe institucionet ndërkombëtare; dhënia udhëzimeve të Regjistrisë të Audituesve të Autorizuar; dhe kryerja e detyrave të tjera të caktuara me Ligj.

Analiza më e fundit e Komisionit Europian lidhur me përmbushjen e kërkesave legjislative të BE-së në fushën e mbikëqyrjes publike të auditimit në Maqedoninë e Veriut gjendet në faqen e KE-së.<sup>91</sup>

### Drejtimi i brendshëm

CAOAC ka shtatë anëtarë, përfshirë kryetarin e Këshillit. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut emëron kryetarin dhe anëtarët e Këshillit. Kryetari i Këshillit propozohet nga Ministri i Financave, ndërsa gjashtë anëtarët e tjerë propozohen nga këto institucione:

- ✦ një përfaqësues i Bankës Kombëtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i punësuar në Departamentin e Mbikëqyrjes,
- ✦ një përfaqësues i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve,

- ✦ një përfaqësues i Komisionit të Letrave me Vlerë,
- ✦ një përfaqësues i subjekteve afariste madhore dhe
- ✦ dy auditues të autorizuar, të propozuar nga Instituti i Audituesve të Autorizuar.

Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të CAOAC është pesëvjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër. Kryetari i CAOAC-së është një punonjës profesional, me rrogë për punën e kryer. Anëtarët e CAOAC-së marrin po ashtu një shpërblim mujor nga fondet e CAOAC-së të përcaktuara në planin financiar vjetor.

### Inspektimet

CAOAC ka kompetencën të kryejë inspektime të sigurimit të cilësisë së auditimit, por, në kohën e këtij raporti, nuk kishte filluar inspektime.

### Sanksionet

CAOAC ka të drejtë të vendosë këto sanksione:

1. konfiskim i përkohshëm i licencës së auditimit; dhe
2. konfiskim i përhershëm i licencës së auditimit.

Sanksioni vendoset nga CAOAC në bazë të një raporti të Institutit të Audituesve të Autorizuar, pas një inspektimi. Sanksioni mund të vendoset për të njëjtën periudhë për të cilën Instituti ka vendosur një masë disiplinore.

### Delegimi

Inspektimet kryhen nga Instituti i Audituesve të Autorizuar, sipas një programi të qartë, brenda kompetencave të përcaktuara nga Ligji për Auditimin. Instituti e bën përzgjedhjen e audituesve bazuar në rrezik, sipas një sërë faktorësh dhe informacionit vjetor të mbledhur nga shoqëritë e auditimit.

<sup>91</sup> Shih [https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/5f0c9185-ce46-46fc-bf44-82318ab47e88\\_en?filename=North%20Macedonia%20Report%202024.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/5f0c9185-ce46-46fc-bf44-82318ab47e88_en?filename=North%20Macedonia%20Report%202024.pdf)

## Financimi

CAOAC financohet nga: Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut; një taksë prej 15% mbi të ardhurat të Institutit të Audituesve të Autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin paraprak; të ardhura nga lëshimi i licencave të auditimit për shoqëritë e auditimit, audituesit e autorizuar (persona fizikë dhe auditues të autorizuar); dhe të ardhura të tjera nga kryerja e detyrave të CAOAC-së.

### Sfidat kryesore

- ✦ Këshilli duhet të fillojë një program inspektimi për audituesit e NJEIP-ve.
- ✦ Këshilli duhet të ndërmarrë në mënyrë aktive edhe role dhe përgjegjësi të tjera, si mbikëqyrja e Institutit.

## Serbia

### Legjislacioni

Ligji për Auditimin i Republikës së Serbisë e cakton Komisionin e Letrave me Vlerë të Republikës së Serbisë si autoritetin kompetent për mbikëqyrjen publike të auditimit. Aktet nënligjore të mëposhtme, të nxjerra në zbatim të Ligjit për Auditimin, u japin mbështetje ligjore inspektimeve të auditimit:

- ✦ *Udhëzimi për kriteret e përzgjedhjes për shoqëritë e auditimit, audituesit e pavarur dhe audituesit e autorizuar të licencuar për shqyrtimet e kontrollit të cilësisë të auditimeve të kryera*<sup>92</sup>
- ✦ *Rregullorja për shqyrtimin e kontrollit të cilësisë të angazhimeve të auditimit dhe për shqyrtimin e kontrollit të cilësisë të shoqërive të auditimit, audituesve të pavarur dhe audituesve të autorizuar të licencuar*<sup>93</sup>

Tarifat për funksionin e mbikëqyrjes publike caktohen sipas Rregullores për tarifat, të miratuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë.<sup>94</sup>

Analiza më e fundit e Komisionit Europian lidhur me përmbushjen e kërkesave legjislative të BE-së në fushën e mbikëqyrjes publike të auditimit në Serbi gjendet në faqen e KE-së.<sup>95</sup>

## Drejtimi i brendshëm

Komisioni i Letrave me Vlerë ka pesë anëtarë, përfshirë kryetarin e komisionit, i cili zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi Kombëtar i Republikës së Serbisë me propozim të Komisionit parlamentar për financat. Komisioni merr vendime në seanca të kryesuara nga kryetari ose nga një anëtar i autorizuar nga kryetari. Puna e personelit specialist administrohet nga sekretari i përgjithshëm i komisionit. Anëtarët e komisionit që marrin vendime në lidhje me zbatimin e këtij ligji duhet të jenë jo ushtrues të profesionit, në përputhje me Ligjin për Auditimin. Komisioni publikon një program vjetor aktiviteteve dhe një raport vjetor mbi aktivitetet e realizuara në faqen në internet; Ai i paraqet raportin vjetor edhe Ministrisë së Financave dhe i raporton Ministrisë për zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara nga Ligji për Auditimin të paktën dy herë në vit.

Ligji për Auditimin ka krijuar në vitin 2013 edhe një komitet të mbikëqyrjes publike të auditimit për të këshilluar Komisionin. Ky komitet ka një kryetar dhe gjashtë anëtarë. Kryetari dhe katër anëtarë emërohen me propozim të Ministrit të Financave. Anëtarët e tjerë emërohen me propozim të Bankës Kombëtare të Serbisë dhe Komisionit të Letrave me Vlerë, ndërsa një anëtar tjetër është përfaqësues i Dhomës së Audituesve të Autorizuar të Serbisë.

<sup>92</sup> Shih <https://www.sec.gov.rs/index.php/en/regulations/legislation/bylaws/293-law-on-audit/7287-guidelines-on-the-selection-criteria-for-audit-firms,-independent-auditors-and-licensed-authorised-auditors-for-the-quality-control-reviews-of-conducted-audits>

<sup>93</sup> Shih <https://www.sec.gov.rs/index.php/en/regulations/legislation/bylaws/293-law-on-audit/7278-regulation-on-quality-control-review-of-audit-engagements-and-quality-control-review-of-audit-firms,-independent-auditors,-and-licensed-authorised-auditors>

<sup>94</sup> Shih <https://www.sec.gov.rs/index.php/en/regulations/legislation/the-rulebook-on-fees>

<sup>95</sup> Shih [https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/3c8c2d7f-bff7-44eb-b868-414730cc5902\\_en?filename=Serbia%20Report%202024.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/3c8c2d7f-bff7-44eb-b868-414730cc5902_en?filename=Serbia%20Report%202024.pdf)



## Inspektimet

Komisioni i Letrave me Vlerë ka tagrin të kryejë inspektime të shoqërive të auditimit dhe audituesve të autorizuar të licencuar me qëllim që të kontrollojë nëse auditimi kryhet sipas SNA-ve. Aktualisht, janë punësuar dy inspektorë për të kryer këto inspektime. Inspektimet duhet të jenë në përpjesëtim me kompleksitetin e punës së kryer nga audituesi. Kontrolli i cilësisë për punën e auditimit duhet të kryhet për të parandaluar çdo konflikt interesi midis personave që kryejnë shqyrtimin e cilësisë së praktikës dhe audituesve dhe sipas një metodologjie të përcaktuar inspektimi. Inspektimet kryhen nëpërmjet:

1) monitorimit të pasqyrave financiare të paraqitura në Komisionin e Letrave me Vlerë nga audituesit; 2) inspektimeve të audituesve; 3) vendosjes së masave korrigjuese dhe sanksioneve në përputhje me Ligjin për Auditimin. Audituesit zgjidhen për inspektim sipas një kampioni të bazuar në rrezik, me cikël 3-vjeçar për audituesit e NJEIP-ve dhe cikël 6-vjeçar për të tjerët.

## Sanksionet

Sanksionet në dispozicion të Komisionit të Letrave me Vlerë për punën e auditimit me cilësi të dobët të konstatuar gjatë inspektimeve mund të përfshijnë: 1) urdhër për eliminimin e parregullsive të konstatuara; 2) tërheqje e vërejtjes publikisht; 3) heqje me kusht e licencës së shoqërisë së auditimit; 4) pezullim i licencës së shoqërisë së auditimit deri në 3 vjet; 5) pezullim deri në tre vjet të kryerjes së funksioneve të auditimit nga individ i në një shoqëri auditimi ose NJEIP; 6) heqje e licencës së auditimit; 7) gjobë.

## Delegimi

Komisioni i Letrave me Vlerë bën mbikëqyrje publike të auditimit në përputhje me Ligjin për Auditimin, duke mbikëqyrur punën e deleguar nga Komisioni të Dhoma e Audituesve të Autorizuar të Serbisë. Krahas Komisionit, edhe Dhomës së Audituesve të Autorizuar i është ngarkuar shqyrtimi i cilësisë për

anëtarët e saj, ku përfshihen të gjithë audituesit dhe shoqëritë e auditimit. Komisioni mbikëqyr këto funksione të Dhomës dhe Ministrisë së Financave: 1) vënia në zbatim e programeve për dhënien, njohjen dhe organizimin e provimeve për fitimin e titullit të audituesit të autorizuar; 2) përcaktimi dhe zbatimi i programit për AVP-në e audituesve të autorizuar të licencuar; 3) lëshimi, rinovimi dhe heqja e licencave të audituesve të autorizuar; 4) lëshimi dhe heqja e licencave të auditimit për shoqëritë e auditimit dhe personat fizikë; 5) vënia në zbatim e SNA-ve; 6) zbatimi i Kodit të Etikës për audituesit; 7) kryerja e procedurave hetimore, disiplinore dhe procedurave të tjera nga Dhoma (në lidhje me audituesit e njësive ekonomike pa interes publik).

## Financimi

Komisioni i Letrave me Vlerë i merr fondet për punën e mbikëqyrjes së auditimit nga: 1) një kontribut specifik për kryerjen e shqyrtimit të cilësisë së praktikës së shoqërive të auditimit; 2) tarifa nga burime të tjera në përputhje me Ligjin për Auditimin. Komisioni merr pëlqimin e Ministrisë së Financave për shumën e kontributit specifik dhe më pas miraton një akt sipas nenit 106 të Ligjit për Auditimin.

## Tregu i auditimit

Aktualisht, 77 shoqëri auditimi janë objekt i mbikëqyrjes/inspektimeve nga Komisioni i Letrave me Vlerë. 27 nga shoqëritë e auditimit lejohen të auditojnë NJEIP.

### Sfidat kryesore

- ✦ Serbia duhet të vazhdojë të përmirësojë cilësinë e auditimit përmes inspektimeve efektive dhe, sipas rastit, përmes masave të fuqizuara të zbatimit me forcë.
- ✦ Serbia duhet të vazhdojë të sigurojë që të ketë burime të nevojshme brenda funksionit të SMP-së.





